



Sisteme për paralajmërim Të hershëm në bashkësi: parime udhëheqëse

Funded by



AUSTRIAN RED CROSS



**Црвен крст на Република Македонија
Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë**



**International Federation
of Red Cross and Red Crescent Societies**

SISTEME PËR PARALAJMËRIM TË HERSHËM NË BASHKËSI

PARIME UDHËHEQËSE

Strategjia 2020 e reflekton vendosmërinë kolektive të Federatës ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe për të vazhduar më tutje me përballjen e sfidave kryesore me të cilat do të ballafaqohet njerëzimi në dekadën e ardhshme.

E informuar për nevojat dhe ndjeshmëritë e bashkësive me të cilat punon, si dhe të drejtat dhe liritë themelore të cilat duhet t'i posedojnë të gjithë, kjo strategji synon t'ju ndihmojë të gjithë atyre njerëzve të cilët nga Kryqi i kuq/Gjysmëhëna e kuqe presin të ndërtojë një jetë më humane, më dinjitoze dhe më të qetë.

Gjatë dhjetë vjetëve të ardhshëm vëmendja kolektive e Federatës ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe do të përqëndrohet në realizimin e këtyre qëllimeve strategjike:

1. Shpëtimi i jetës së njerëzve, mbrojtja e pronës dhe forcimi i aktiviteteve për mëkëmbje nga katastrofat dhe gjendjet e krizës.
2. Sigurimi i jetës së shëndoshë dhe të sigurt.
3. Promovim i përfshirjes sociale dhe kulturës së jodhunës dhe paqes.

Cilado pjesë e këtij doracaku mund të kopjohet, përkthehet në gjuhë të tjera dhe të përshtatet në purputhje me nevojat lokale pa lejen paraprake të Federatës ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, po që se qartazi ceket burimi i originalit. Federata ndërkombëtare shpreh falënderim nëse informohet për përdorimin e këtij doracaku.

Të gjitha fotografitë të cilat përdoren në këtë studim janë të mbrojtura me të drejtën autoreske të Federatës ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, përpos nëse nuk është cekur ndryshe.

.....
© International Federation of Red Cross and Red Crescent Societies,
Geneva, 2012

P.O. Box 372
CH-1211 Geneva 19
Switzerland
Telefon: +41 22 730 4222
e-mail: secretariat@ifrc.org
internetit faqja: <http://www.ifrc.org>

PËRMBAJTJA

Shkurtesa dhe akronime	05
Fjalor i terminologjisë	06
Parathënie	08
Hyrje në sistemet për paralajmërim të hershëm në bashkësi: Parime udhëheqëse	10
1. Prapavija dhe qëllimet	10
2. Fokus grup i publikut: për kë është shkruar doracaku	11
3. Metodologjia	11
4. Organizimi	12
Të kuptuarit e sistemeve për paralajmërim të hershëm	13
1. Definicione dhe koncepte	13
2. Hyrje në katër komponentet kyç të sistemit për paralajmërim të hershëm	15
3. Zbulimi i miteve për paralajmërim të hershëm	18
4. Korniza ndërkombëtare politike dhe juridike për paralajmërim të hershëm	21
5. Korniza institucionale për paralajmërim të hershëm	23
Tema të kryqëzuara – parime udhëheqëse	29
Parimi udhëheqës 1: Integrimi në uljen e rreziqeve nga katastrofat – sistemi për paralajmërim të hershëm nuk është proces më vete ----	29
Parimi udhëheqës 2: Qëllimi është sinergi në çdo nivel: në nivel të bashkësisë, në nivel nacional, rajonal dhe global	31
Parimi udhëheqës 3: Qëllimi është ekzistimi i sistemeve për paralajmërim të hershëm të më shumë rreziqeve	33
Parimi udhëheqës 4: Përfshirja sistemore e ndjeshmërisë	36
Parimi udhëheqës 5: Disenjimi i komponenteve për paralajmërim të hershëm me më shumë funksione	39
Parimi udhëheqës 6: Integrimi më i madh i kornizave kohore	41
Parimi udhëheqës 7: Inkorporimi i sistemeve të ndryshme të diturisë	43
Parimi udhëheqës 8: Marrja parasysh e rreziqeve të përhershme dhe situatave të pasigurisë	46
Parimi udhëheqës 9: Sisteme për paralajmërim të hershëm pa kufij: përfshirje e plotë e situatave të ndjeshme dhe rreziqeve	50
Parimi udhëheqës10: Shfrytëzimi i teknologjisë përkatëse	53
Parimi udhëheqës11: Set rezerv i treguesve, kanaleve komunikative	56
Parimi udhëheqës12: Përfshirja e grupeve me të drejta të privuara dhe të ndjeshme.....	59
Parimi udhëheqës13: Ndërtimi i partneriteteve dhe promovimi i angazhimit individual.....	61

Praktikat në bashkësi: Parime udhëheqëse për komponentët e sistemeve për paralajmërim të hershëm

Njohuri për rreziqet

- Parimi udhëheqës K-1: Edhe pse ushtrimet për njohuritë lidhur me rreziqet mund të mos rezultojnë me paralajmërimin e hershëm, paralajmërimi i përgjithshëm i hershëm duhet doemos të themelohet në njohuritë për rreziqet 70
- Parimi udhëheqës K-2: Duhet pranuar se prioritetet e bashkësisë, nuk do të thotë të jenë edhe prioritetet tuaja 71

Monitorim

- Parimi udhëheqës M-1: Marrësit pasiv të informatave nuk shpëtojnë jeta ... 76
- Parimi udhëheqës M-2: Disa bashkësi duhet të përgatisin sistemet e tyre për paralajmërim të hershëm 78
- Parimi udhëheqës M-3: Aktivitetet publike për monitorim mund ti motivojnë bashkësitë 81
- Parimi udhëheqës M-4: Kur evoluojnë rreziqet, kjo duhet të përcjellet edhe me monitorim 82

Aftësi për përgjigje

- Parimi udhëheqës P-1: Te sistemet për paralajmërim të hershëm sigurojmë përgjigje për paralajmërimet, e jo për katastrofa 84
- Parimi udhëheqës P-2: Synojmë organizimin e aktiviteteve robus si përgjigje .87
- Parimi udhëheqës P-3 Inkorporimi i aktiviteteve si përgjigje katastrofave në planifikimet vjetore për gatishmëri në situata urgjente dhe sigurim i mjeteve përkatëse financiare..... 88
- Parimi udhëheqës P-4 Përsosmëri nëpërmjet ushtrimeve: testim i aktiviteteve për të dhënë përgjigje 89

Shkurtesat dhe akronimet

SPHB	Sistemi për Paralajmërim të Hershëm në Bashkësi	CEWS	Community early warning system
FNSHK	Fondi për Ndhimën e Shpejtë gjatë Katastrofave	DREF	Disaster Relief Emergency Fund
URRK	Ulja e Rreziqeve nga Katastrofat	DRR	Disaster Risk Reduction
SPH	Sistemi për Paralajmërim të Hershëm	EWS	Early Warning System
FNSHKKG JK	Federata Ndërkombëtare e Shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe	IFRC	International Federation of Red Cross and Red Crescent Societies
AAH	Aktivitet për Akumulimin e të Hyrave	IGA	Income generating activity
OJQ	Organizatat joqeveritare	NGO	Non-governmental organization
VNK	Vlerësim i Ndjeshmërisë dhe Kapaciteteve	VCA	Vulnerability and capacity assessment

FJALOR I TERMINOLOGJISË

Katastrofa	Çrregullim serioz i funksionimit të bashkësisë apo shoqërisë, që rezulton me humbje të mëdha në njerëz, materiale, ekonomike ose me pasoja për ambientin jetësor, të cilat e kapërcejnë mundësinë e bashkësisë apo të shoqërisë së përfshirë të përballet me këtë situatë me burimet vetjake.
Ulja e rrezikut nga katastrofa	Koncepti dhe ushtrimet për uljen e rreziqeve nga katastrofat përmes përpjekjeve sistematike për analizimin dhe menaxhimin e faktorëve të zakonshëm të katastrofave, përfshi zvogëlimin e të ekspozuarit rreziqeve, ndjeshmëri e zvogëluar e njerëzve dhe pronës, udhëheqje e përgjegjshme me pasurinë dhe ambienti jetësor dhe përmirësim i gatishmërisë përmes organizimit të ngjarjeve përkatëse për stërvitje.
Rreziku	Dukuri e rrezikshme, materie, aktivitetet njerëzor apo situatë e cila mund të shkaktojë humbje jete, lëndim ose ndikim tjetër për shëndetin, pronën, humbje të mallit, mosfunksionim i shërbimeve, çrregullim i gjendjes sociale dhe ekonomike dhe dëmtim i ambientit jetësor.
Sistemi për parandalim të hershëm	Kapacitetet e përgjithshme të cilat nevojiten për akumulimin dhe diseminimin në kohë. Të sigurohen informata të rëndësishme për parandalim për individë, bashkësi dhe organizata të cilat i janë ekspozuar rrezikut dhe në një periudhë të arsyeshme të përgatiten dhe të ndër marrin aktivitete përkatëse për zvogëlimin e dëmeve apo humbjeve.
Zbutje e situatës	Zvogëlim ose kufizim i ndikimeve të padëshirueshme të rrezikut dhe katastrofave. të lidhura.
Gatishmëri	Dituri dhe kapacitete, të përgatitura nga ana e qeverive, organizatava profesioniste për përgjigje dhe mëkëmbje gjatë katastrofave dhe të bashkësive dhe individëve, në mënyrë efektive të parashohin, të përgjigjen dhe të mëkëmben nga ngjarjet ose situatat e mundshme të rrezikshme të pashmangshme dhe vijuese.

Preventivë	Aktivite për shmangien e ndikimeve të padëshirueshme nga rreziqet e shkaktuara nga lloje të ndryshme të katastrofave.
Ngritja vetëdijes publike	Shkala e diturisë publike për rreziqet nga katastrofat, faktorët që sjellin deri te katastrofat dhe aksionet të cilat mund të ndërmerren, individualisht dhe kolektivisht, që të zvogëlohet ekspozimi dhe ndjeshmëria ndaj rreziqeve.
Rezistenca	Aftësia e sistemit, bashkësisë apo shoqërisë e cila i ekspozohet rrezikut që të merret, t'i absorbojë ndikimet, të adaptohet dhe të mëkëmbet nga efektet e rrezikut me kohë dhe efikasitet, përfshi edhe përmes mbrojtjes dhe përtëritjes së strukturave dhe funksioneve bazë themelore.
Rreziku	Gjasat për të ndodhur ndonjë ngjarje dhe pasojat negative nga e njëjta.
Ndjeshmëria	Karakteristikat dhe rrethanat në një bashkësi të caktuar, sistem apo mjet që i bëjnë t'i nënshtrohen efekteve të dëmshme të rrezikut.

Definicionet e prezentuara më lart janë marë dhe janë përshtatur nga publikimi i Strategjisë ndërkombëtare për uljen e rreziqeve të Kombeve të Bashkuara- Terminologjia për Uljen e rreziqeve nga katastrofat.

PARATHËNIE

Zvogëlimi i humbjeve njerëzore dhe materiale si rezultat i katastrofave, gjatë 30 vjetëve të kaluara rezulton pjesërisht për shkak të sistemeve të përmirësuara për parandalim të hershëm, kurse shumica prej tyre janë rezultat i zhvillimit të teknologjisë së lartë. Progresi shkencor solli progresin revolucionar në sferën e meteorologjisë dhe teknologjisë së komunikacionit të cilat përdoren për paralajmërim të katastrofave.

Mirëpo, Federata Ndërkombëtare e organizatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe bëjnë përpjekje për qasje e cila bazohet në sigurimin e informatave dhe paralajmërimeve të marra nga satelitë të ndryshëm, modelim kompjuterik dhe teknologji të ndryshme të cilat kanë peshë të rëndësishme, të mbërrijnë deri te këto kategori të ndjeshme, me qëllim të marrin përgjigje adekuate. Paralajmërimet e këtilla të hershme, me automatizëm nuk e shmangin rrezikun, dhe të njejtat ndodh që të transformohen në katastrofa.

Aksioni i hershëm dhe i ndërrmarë në kohë, ka domethënie të madhe. Ajo është investim për të ardhmen, dhe është dëshmuar si një mjet efikas për zvogëlimin e pasojave nga katastrofat.

Në botë, bëhen përpjekje për përforcimin e volonterëve me qëllim të mund të ndërmarrin rol aktiv në përcjelljen e rreziqeve të cilat kanë ndikim në jetën dhe mirëqenien e shoqërive. Ndër të tjera, ata mësojnë për rreziqet dhe si të mund të reagojnë ndaj tyre si dhe për sistemet paralajmëruese për rreziqe. Aty ku sistemet për paralajmërim të hershëm janë aktivë, këto sisteme për paralajmërim të shoqërive janë pjesë e programeve qeveritare me qëllim të mbrojtjes të jetës dhe pronës të njerëzve. Aty ku sistemet akoma nuk ekzistojnë, sistemet për paralajmërim të hershëm shërbejnë si katalizator në dialogun për arsyeshmërinë e ekzistimit të tyre, dhe të organizatave nacionale të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, si bartës të rolit ndihmës të qeveritarëve, të cilët luajnë rol në sigurimin e përkrahjes adekuate.

Qasja e bazuar në njerëzit, që ka të bëjë me paralajmërimin e hershëm, promovohet me anë të Kornizës për aksion nga Hjogo, dhe është i orientuar kah qëllimi se pse shoqëritë duhet kuptuar rreziqet që të mund t'ju shmangen atyre. Katastrofat pjesërisht janë të shkaktuara nga rreziqet e jashtme, por ato gjithashtu mund të rezultojnë edhe nga ndjeshmëria e njerëzve: si p.sh. njerëz të cilët kanë qëlluar në vend të gabuar, në kohë të gabuar ose pa përkrahje adekuate dhe mjete që të mund ti përgjigjen paralajmërimeve.

Ekziston konsensus se shoqëritë duhet nëse jo tjetër, të jenë marrës aktiv të informatave, ndërsa disa duhet të angazhohen edhe në monitorim të aktiviteteve me qëllim që në mënyrë të duhur t'i ndërmarrin aktivitetet mbrojtëse. Mirëpo, faktorë të ndryshëm, si p.sh. dija, fuqia, kultura, mjedisi, stili i jetës dhe sjellja, janë determinuese për mënyrën se si njerëzit përgjigjen dhe reagojnë ndaj paralajmërimeve. Përmes angazhimit të njerëzve në zhvillimin e sistemeve

për paralajmërim të hershëm, që në fillim mund të ndikohet në përballjen me shumë nga sfidat ekzistuese.

Ky dokument (parimet themelore të sistemeve për paralajmërim të hershëm në shoqëri), është dokument i gjallë i cili do të thotë fillim i një procesi për mbledhje dhe mbindërtim të dëshmive dhe të dhënave nga kjo sferë. Në dokument janë prezentuar përvoja nga 50 vende të botës, si dhe nga Kryqi i kuq ndërkombëtar dhe Gjysmëhëna e kuqe, përmes përvojave të partnerëve të ndryshëm. Kjo është pika fillestare për mbledhjen e përvojave të shoqërive dhe integrim të tyre në sistemet për paralajmërim të hershëm. Shpresojmë se lexuesit do të japin kontributin e tyre të veçantë në këtë dialog, përmes këmbimit aktiv të shembujve, praktikave dhe mësimëve të tyre.

Bekele Geleta

Sekretar i Përgjithshëm

Federata ndërkombëtare e organizatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe

Hyrje në sistemin për paralajmërim të hershëm në bashkësi: Parimet udhëheqëse

1. Prapavijat dhe qëllimet

Sistemet për paralajmërim të hershëm:parimet udhëheqëse është një nga doracakët të cilat i hartoi Federata ndërkombëtare e organizatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe bashkë me Doracakun për vlerësim dhe ndjeshmëri dhe kapacitete dhe Doracakun për ngritjen e vetëdijes dhe edukimin e publikut. Ai, gjithashtu, i takon grupit të doracakëve, ku bën pjesë edhe Doracaku për përgjigje në rast të katastrofave dhe situatave emergjente, dhe paraqet mjet mekanizëm posaçërisht të dobishëm për çdo praktikant i cili punon në sferën e uljes së rreziqeve nga katastrofat/menaxhim të katastrofave.

Krahasuar me mekanizmat për përgjigje në rast të katastrofave, paralajmërimi i hershëm është një nga metodat shumë të rëndësishme, të cilat kontribuojnë për preventivë nga katastrofat dhe gatishmëri në rast të rreziqeve dhe kanosjeve të çfarëdolloji qoftë. Paralajmërimi i hershëm dukshëm kontribuon në përpjekjet për uljen e rreziqeve nga katastrofat. Çdo shoqatë apo organizatë joqeveritare me përgatitje të mirë, do ta kuptojë dhe promovojë rolin e sistemeve për paralajmërim të hershëm, të cilat mbështeten para së gjithash në kontributin e njerëzve për uljen e rreziqeve.

Politika për gatishmëri në rast të katastrofave e thekson rolin e Federatës ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe dhe të shoqatave nacionale të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe lidhur me përfaqësimin dhe promovimin e diturive për “sisteme për paralajmërim të hershëm të cilat janë vlerësuar, kuptuar dhe sipas të cilave kanë vepruar bashkësitë”, si pjesë e kontributit të tyre për Kornizën për aksion nga Hjogo.

Qëllimi strategjik 1 (“Shpëtim i jetës së njerëzve, mbrojtje të pronës dhe forcim i aktiviteteve për mëkëmbje nga katastrofat dhe gjendje krize”) i Strategjisë 2020 të Federatës ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, potencon rëndësinë e sistemeve për paralajmërim të hershëm, të cilat janë me rëndësi instrumentale për shpëtimin e numrit maksimal të njerëzve si dhe mbrojtje të mjeteve dhe pronës së njerëzve.

Ky doracak ka për qëllim prakticienëve për paralajmërim të hershëm t'ua prezentojë praktikatat e suksesshme në sferën e uljes së rreziqeve nga katastrofat/menaxhimin e katastrofave. Këtu janë prezentuar parimet udhëheqëse, të cilat mund të kontribuojnë në ndërtimin e bazës së fortë për disenjimin apo forcimin e sistemit për paralajmërim të hershëm në cilindo nivel. Ky nuk është ciceron operativ, por strategjik, i cili i hulumton çështjet e vërteta dhe hulumton perspektiva nga më të ndryshmet para se të sillen vendim për atë se a është paralajmërimi i hershëm metoda e vërtetë në kontekstin e dhënë.

Doracaku për aftësimin e aftësuesve për sistemet për paralajmërim të hershëm, shkon komplet me këtë doracak, kurse botimi është realizuar më vitin 2013.

Çdoherë kur zgjedhja për shfrytëzimin e metodës për paralajmërim të hershëm bie në këtë doracak, parimet udhëheqëse do të sigurojnë bazë të mirë që të gjithë prakticienët e motivuar të mund të hulumtojnë në këtë sferë- një pjesë e tyre me siguri janë mirë të informuar me përmbajtjet përmes implementimit të programit për uljen e rreziqeve nga katastrofat.

Përgjithësisht, ky doracak ka për qëllim t'i inspirojë lexuesit të ndërmarrin hapa për realizimin e aktiviteteve për paralajmërim të hershëm, të cilat do të japin kontribut të posaçëm në uljen e përgjithshme të rreziqeve në bashkësitë lokale dhe shpëtimin e jetës dhe pronës së qytetarëve.

2. Fokus grup i publikut: për kë është shkruar doracaku

Ky doracak ka për qëllim ta ngrisë vetëdijen për rëndësinë e sistemeve për paralajmërim të hershëm dhe avancimin e praktikave të mira në nivel lokal në mbarë botën. Doracaku i dedikohet sidomos shoqatave nacionale të Kryqit të kuq/Gjysmëhënës së kuqe (veçmas nga aspekti i rolit të tyre ndihmës në shtet), për të punësuarit dhe vullnetarë e Kryqit të kuq/Gjysmëhënës së kuqe si dhe për partnerët e sektorit joqeveritar dhe prakticienët e niveleve të ndryshme të cilët i përkrahin qeveritë në aspektin e ndërtimit apo forcimit të sistemeve për paralajmërim të hershëm, sidomos në bashkësitë të cilat janë të ekspozuara në rreziqe- në nivel loka, nacional, rajonal dhe global.

3. Metodologjia

Hulumtimi për qëllimet e këtij doracaku është zbatuar në tri sfera dhe të gjitha ato dhanë rezultate të veçanta me prodhime të posaçme pune.

- U realizua hulumtim i gjerësishëm letrar, respektivisht u konsultuan më shumë se 450 dokumente. Tërë bibliografia mund të gjindet në FedNet.
- Të gjitha iniciativat e identifikuar janë të lidhura me projekte për sisteme për paralajmërim të hershëm apo me komponentë të sistemeve për paralajmërim të hershëm.
- Në data bazë janë përfshirë projekte nga faktorë/organizata të ndryshme.
- U realizuan intervista për mbrojtjen e liderëve të projekteve të identifikuar, me qëllim që të kuptohet më mirë fushëveprimi, përvojat dhe ndikimi i të gjitha përpjekjeve.
- Të gjitha teknikat dhe qasjet e ndryshme, të cilat janë shfrytëzuar për iniciativën për vendosjen e sistemeve për paralajmërim të hershëm, janë evidentuar dhe identifikuar mirë dhe paraqesin praktikë të mirë dhe leksione të mësuara.

Në dokument, praktikat e mira janë prezentuar në katrorë të veçantë me ngjyrë të gjelbër, kurse leksionet e mësuara në katrorë me ngjyrë të kuqe.

4. Organizimi

Pjesa tjetër e doracakut është e organizuar në tri pjesë (shih Pasqyrimin 1): të kuptuarit e sistemeve për paralajmërim të hershëm, parime udhëheqëse dhe praktika për paralajmërim të hershëm.

- Në Kapitullin A, Të kuptuarit e sistemeve, diskutohet për definicione, komponentë kyç, mite lidhur me sistemet për paralajmërim të hershëm dhe kornizat ekzistuese politike dhe institucionale.
- Në kapitullin B, Parimet udhëheqëse, janë ilustruar parimet kyç, të cilët duhet të merren parasysh me vëmendje para se të mendohet seriozisht për disenjimin dhe përkrahjen e sistemeve për paralajmërim të hershëm, pavarësisht fokus grupeve të rreziqeve apo nivelit të paraparë për përgjigje.
- Në kapitullin C, Praktika, janë prezentuar katër komponentët kyç të sistemeve për paralajmërim të hershëm, me qëllim të sigurimit të drejtimeve specifike për sistemet e paralajmërimit të hershëm në nivel të bashkësisë dhe të pasqyrohen praktika të mira dhe leksione të mësuara nga mbarë bota.

Si duhet përdorur doracakun

Të gjithë prakticienët, në sferën e uljes së rreziqeve nga katastrofat, të cilët nuk kanë përvojë në sferën e paralajmërimit të hershëm, duhet t'i përmbahen doracakut ashtu siç është hartuar, respektivisht tërë përmbajtjes, me qëllim që të njihen me termat dhe bazat e problematikës.

Lexuesit më me përvojë, mbase do të dëshirojnë ta lexojnë listën e parimeve udhëheqëse (kapitulli B), e më pastaj të kalojnë në praktikat sipas interesit të tyre dhe shembujt e vendeve të ndryshme, në pajtim me komponentët e pasqyruara në kapitullin C.

Të kuptuarit e sistemeve për paralajmërim të hershëm

Kjo pjesë e parimeve udhëheqëse ka për qëllim të pasqyrojë se në çfarë mënyre duhet të kuptohet koncepti i paralajmërimit të hershëm dhe komponentët e sistemit për paralajmërim të hershëm. Kjo më tutje do të paraqesë bazë për hulumtimin e parimeve udhëheqëse dhe shembujve konkret të praktikave në bashkësi. Së pari duhet ta kuptojmë terminologjinë dhe pjesët e saj integral, e më pastaj edhe kornizat ekzistuese politike, juridike dhe institucionale, të cilat kanë pika të përbashkëta me sistemin për paralajmërim të hershëm. Me rëndësi të njëjtë është që të përjashtohen disa mite, të cilat i pengojnë përpjekjet në sferën e sistemit për paralajmërim të hershëm.

1. Definicione dhe koncepte

Me qëllim të përpunimit të plotë të definicionit, lidhur me atë se çka është sistemi për paralajmërim të hershëm në bashkësi, më së miri është që me radhë t'i definojmë termat “sistem për paralajmërim të hershëm”, “hershëm”, “paralajmërim”, “sistem”, “sistem gjithpërfshirës” dhe “bashkësi”.

“Sistemi për paralajmërim të hershëm” paraqet komplet të kapaciteteve, të cilat nevojiten për gjenerimin dhe diseminimin e informatave të rëndësishme për paralajmërim, të cilat i mundësojnë personave, bashkësive dhe organizatave të ekspozuara në rreziqe, në mënyrë adekuate të mund të përgatiten dhe veprojnë dhe në suazë të caktuar kohore ta zvogëlojnë dëmin apo humbjen (përshtatur nga Strategjia për uljen e rreziqeve të Kombeve të Bashkuara 2009 dhe nga organizata të tjera).

“Hershëm” do të thotë para se të shkaktohet rreziku apo kanosja- derisa ende ka kohë të zvogëlohet dëmi apo humbja potenciale, ose të pengohet katastrofa.

“Paralajmërim” është mesazhi (nëpërmjet shfrytëzimit të fjalëve, tingujve ose fotografive), i cila paralajmëron rrezikun e pashmangshëm.

“Sistemi”, nga ana tjetër, paraqet set të renditur dhe të standardizuar elementesh, të cilat vazhdimisht fluktojnë me lëvizje në drejtime të ndryshme.

“Sistem gjithpërfshirës” për paralajmërim paraqet set të plotë komponentësh, që janë të lidhura me ata të cilët duhet ta dëgjojnë dhe përcjellin mesazhin te të tjerët, të cilët i ndjekin dhe i integrojnë informatat për rreziqet nga të cilat janë përgatitur mesazhet.

“Bashkësia”, në këtë doracak paraqet rrjet të interaksioneve sociale, të cilat shpeshherë mund të ekspozohen në më shumë ndikime sociale dhe/ose fizike nga një apo më shumë rreziqe/kanosje, por nuk do të thotë të jenë të lidhura vetëm me vendin (psh. fshat, fqinjësi, rajon e tj.).

Në saje të termave të lartpërmendura, sistemi për paralajmërim të hershëm në bashkësi paraqet përpjekje “të” ose “me”, por jo për bashkësinë, për mbledhjen, kompilimin dhe/ose analizimin e informatave, që mundësojnë diseminim të mesazheve për paralajmërim, të cilat kur janë funksional, mund t'i ndihmojnë shoqërisë për ta zvogëluar dëmin apo humbjen nga ndonjë rrezik, kanosje (ngjarje) apo proces.

Tabela 1 Përfshirja e bashkësisë në sistemin për paralajmërim të hershëm

Elemente kyç	BASHKËSI	
	Sistem i bazuar për paralajmërim të hershëm	Sistem bartës për paralajmërim të hershëm
Orientimi	Me njerëz	Nga njerëzit

Karakteri	Demokratik	I pëlqyeshëm
Qëllimet	Konsultativ	I bazuar në nevojat, participues
Pamja	Bashkësi partneriteti	Bashkësi menaxherësh
Qëndrimet	Bashkësi e organizuar	Bashkësi e përforcuar
Vlerat	Zhvillimi i aftësive të njerëzve	Besim në kapacitetet e njerëzve
Rezultatet/Ndikimi	Inicim i reformave sociale	Ristrukturim i normave sociale
Lojtarët kyç	Sipërmarrës social, punëtorë dhe liderë të bashkësisë	Të gjithë në bashkësi
Metodologjia	E koordinuar me përkrahje teknike	Me vetëmenaxhim
Komponentët aktivë të paralajmërimit të hershëm (nga katër prej tyre)	Të paktën një aktiv (psh. Aftësi për përgjigje)	Të gjithë janë aktiv (sidomos lidhur me përcjelljen e treguesve)

Përshtatja gjenerike e “sistemit për paralajmërim të hershëm në bashkësi”, i njohur më shumë me termin “sistemi për paralajmërim të hershëm i bazuar në bashkësi, mundëson distinkcion të dobishëm midis asaj që bazohet në bashkësi dhe sistemeve të sjellura nga bashkësia. Sistemi për paralajmërim të hershëm mund të bazohet në bashkësi, pa mos u udhëhequr apo i sjellur nga bashkësia. Mirëpo, ndikim më të madh ka kur vetë bashkësia fuqimisht e kupton sistemin për paralajmërim të hershëm. Tabela 1 (e përshtatur nga materialet ndërkombëtare për stërvitje) i prezanton dallimet kryesore ndërmjet sistemit për paralajmërim të hershëm, bazuar në bashkësi, dhe sistemit për paralajmërim të hershëm, i sjellur nga bashkësia.

Distinkcion tjetër i shpeshtë është dallimi ndërmjet sistemeve nacionale për paralajmërim të hershëm dhe sistemeve për paralajmërim të hershëm në bashkësi. Karakteristikat dhe përparësitë kryesore të çdonjërit nga këto sisteme janë pasqyruar në Tabelën 2. Sistem ideal për paralajmërim të hershëm, është ai sistem i cili është i integruar, në të cilin përdoren përparësitë dhe anët e fuqishme të dy llojeve të sistemeve, pa u shkaktuar konfuzion lidhur me sinjalet ose konkurrencë në realizim. Do të ishte më mirë të ekzistojë pushtet lokal, i cili ka mandat të punojë me bashkësitë, me qarkullimin e informacioneve në të dy drejtimet.

Sistemet për paralajmërim të hershëm janë të mira aq sa të munden t'i përçojnë aktivitetet; aksioni është pjesë thelbësore i çdo sistemi për paralajmërim. Nëse është dhënë paralajmërimi, kurse askush nuk ndërmerr veprim lidhur me paralajmërimin e dhënë, atëherë sistemi për paralajmërim nuk është i mirë.

Ashtu siç sistemet për paralajmërim quhen “sisteme për paralajmërim të hershëm”, këto aktivitete mund t'i quajmë “aksion i hershëm”.

Mirëpo, termi “paralajmërim i hershëm, aksion i hershëm” është term i posaçëm, i cili ka të bëjë me ndërmarrjen e aksionit para se të ndodhë katastrofa ose gjendje e jashtëzakonshme shëndetësore, që mundëson shfrytëzimin e plotë të të gjitha informatave të kapshme shkencore për të gjitha suazat kohore (Federata ndërkombëtare e shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, 2008).

Dallimi qëndron aty se Paralajmërimi i hershëm- aksioni i hershëm janë të pranishëm gjatë afateve kohore (shekuj, dekada, vite, muaj, javë, ditë dhe orë) dhe bazohen në konceptin e sistemeve tradicionale për paralajmërim të hershëm me qëllim që të përgatitet strategji përkatëse për udhëheqje me rreziqe nga ndryshimet klimatike.

2. Hyrje në katër komponentet kyç të sistemit për paralajmërim të hershëm

Nëqoftëse i kthehemi definicioneve më lartë të pasqyruara, sistemet për paralajmërim të hershëm kanë katër pjesë të lidhura mes vete: njohjen e rrezikut, përcjelljen, aftësinë për përgjigje dhe komunikimin për paralajmërim. Çdonjëra pjesë duhet të funksionojë në mënyrë efikase me qëllim që sistemi të jetë i sukseshëm:

- **Njohja e rreziqeve** do të thotë të kihet mirëkuptim për rreziqet (rreziqe dhe gjendje të ndjeshme) dhe prioritetet në nivel të caktuar.

Tabela 2 Integrimi i sistemeve nacionale për paralajmërim të hershëm dhe sistemeve për paralajmërim të hershëm në bashkësi

Faktorë kyç	Sistem nacional për paralajmërim të hershëm	Sisteme për paralajmërim të hershëm në bashkësi
Disenj	I paraparë, mbi baza të mandatit ligjor të Qeverisë apo të agjencive të tjera	Disenj fleksibil i bazuar mbi nevojën dhe i përshtatur mbi parimin provë-gabim
Burime njerëzore	Teknik, specialist	Vullnetarë dhe individë të përkohshëm të caktuar nga liderët lokalë
Karakteristika	Paralajmërim i dakorduar formal	Plotësim i paralajmërimit formal
Dokumentim	Ligje, politika, procedura standarde operative, MzR, pasqyrë diagrami i qarkullimit të informatave, etj.	Në mënyrë joformale dhe rrallë herë në formë të dokumentuar
Teknologji	Teknologji e lartë, telefona, VHF, HF radio frekuenca	Nga telefonat deri te format tradicionale
Shkaktarë	Tregues, parashikime,	Detektimi personal lokal i

	teknologji	rrezikut me rastin e marrjes së paralajmërimit jashtë bashkësisë
Proces paralajmërim për	Në faza, në mënyrë sistemore	Ad- hok, por mund të jetë edhe spontanisht mirë e organizuar dhe në mënyrë sistemore.
Mesazhe	Të përgjithshme	Personale
Në kohë të caktuar	Jo rrallëherë së pari arrijnë në bashkësi, e përgatitur t'i shpërndajë në kuadër të sistemeve zyrtare në të gjitha nivelet.	Shpejtë (kur mesazhet përpilohen në nivel lokal) ose kur ekziston lidhëshmëri e mirë në të gjitha nivelet.
Nevoja të përfshira primare	Zvogëlim i humbjeve ekonomike e të tjera	Siguri, zvogëlim i stresit, përkrahje emotive
Kritere evoluimi	Përshkrim i rreziqeve, afat skadimi i siguruar, gjasë për paralajmërim të rrejshëm	Kornizë kohore pas marrjes së paralajmërimit, mesazhe aksionale në paralajmërim

- **Monitorimi** është transmetim logjik i aktivitetit që të ketë qasje se si ndryshojnë rreziqet dhe situatat e ndjeshme me kohë.
- **Kapacitet për përgjigje** do të thotë çdo nivel të ketë mundësi ta zvogëlojë rrezikun pasi të detektohen dhe publikohen trendet- kjo mund të bëhet nëpërmjet aktiviteteve parasezonale për zbutjen e rreziqeve, evakuimin apo fshehjen, varësisht nga periudha e paralajmërimit të dhënë.
- **Paralajmërimi komunikativ** paraqet paketim të informatave nga monitorimi në mesazhe aksionale, që janë lehtë të kuptueshme për ata të cilëve u nevojiten dhe janë të gatshëm t'i degjojnë.

Këto katër pjesë janë pjesërisht të thjeshtëzuara dhe pak a shumë të përshtatura ndryshe nga ato të cilat u publikuan për herë të parë nga Platforma për promovimin e paralajmërimit të hershëm të Strategjisë ndërkombëtare për uljen e rreziqeve të Kombeve të Bashkuara (on lajn qysh nga publikimi në vitin 2006 në kuadër të Programit ndërkombëtar për paralajmërim të hershëm).

Nga pikënisja praktike është e dobishme që grumbullimi primar i të dhënave dhe analizat shkencore (monitorimi dhe parashikimi/prognozimi) të shikohen ndaras nga komponentët e komunikimeve për dhënien e paralajmërimit.

Monitorimi (në vend të monitorimit dhe paralajmërimit¹) paraqet aksion të vazhdueshëm për përcjelljen e treguesve dhe rezultateve të pritura, e

¹ Katër komponentët e para të propozuara nga Strategjia ndërkombëtare për ulje të rreziqeve të Kombeve të Bashkuara janë: njohja e rreziqeve, monitorim dhe paralajmërim, diseminacion/ komunikim dhe kapacitet për përgjigje.

mbështetur në fakte shkencore dhe vlera lokale, dhe informacione të rëndësishme për gjendje të caktuara që pasojnë; komunikimet për paralajmërim i shqyrtojnë këto informata dhe i transformojnë në mesazhe të kuptueshme duke i dërguar deri të bashkësite e rrezikuara.

Meqë nevojiten subjekte me shkathtësi të ndryshme për menaxhimin e këtyre dy detyrave, është e logjikshme të bëhet dallim i qartë midis monitorimit të informatave dhe komunikimit të mesazheve për paralajmërim.

Për të njëjtën arsye është e rëndësishme që të identifikohen individë të cilët posedojnë shkathtësi më të mëdha disiplinore që mundësojnë kapërcimin e dallimeve midis dy komponentëve.

Ndryshimi tjetër nga skema origjinale e Strategjisë ndërkombëtare për uljen e rreziqeve të Kombeve të Bashkuara themelohet në premisën se ndërtimi i kapaciteteve për përgjigje duhet t'i paraprijë paralajmërimit të hershëm në nivel lokal.

Duke marrë parasysh se është e palogjikshme që t'u jepen paralajmërimet bashkësive të cilat nuk janë të përgatitura të veprojnë sipas tyre, më së miri është të ndërmerren masa për ndërtimin e kapaciteteve për gatishmëri para se të fillohet me komunikimet për përparimin e sistemit për paralajmërim të hershëm.

Çdonjëra nga katër komponentët është përpunuar detajisht në pjesët e mëtutjeshme të Doracakut.

3. Zbulim i miteve për paralajmërim të hershëm

Mitet kulturore themelohen në besimin dhe perceptimin e njerëzve anembanë botës- jo vetëm të njerëzve të rëdomtë në bashkësi, por edhe midis personave profesionalë të cilët punojnë në sferën e uljes-menaxhimit të rreziqeve nga katastrofat.

Në këtë pjesë shkurtimisht shqyrtohen mitet, të cilat poqëse nuk kapërcehen, mund të paraqesin pengesë lidhur me efikasitetin e sistemeve për paralajmërim.

Shoqatat nacionale dhe organizatat joqeveritare kanë përgjegjësi të punojnë me subjektet nacionale dhe lokale, përgjegjës për planifikim, me qëllim të kapërcimit ose përjashtimit të këyre miteve nga sistemi.

Mitet më të shpeshta që kanë të bëjnë me sistemin për paralajmërim të hershëm i takojnë dy kategorive të ndara: I. Informata (në kohë, burimi dhe përmbajtja e mesazhit për paralajmërim) II. Përgjigje këtyre paralajmërimeve.

Ato janë pasqyruar në tabelën 3 dhe për çdo mit është dhënë tekst me sqarime se pse është i gabueshëm apo i pabazueshëm. Definitivisht, kolona e fundit

siguron drejtime për aksionet e sistemit për paralajmërim të hershëm të cilat duhet të kontribuojnë që puna të mbetet mit.

Tabela 3 Largimi i miteve të lidhura me paralajmërimin e hershëm

Mit	Pse miti është i pambështetur	Aksion për paralajmërim të hershëm për mohimin e mitit
Informata: korniza kohore, burimi dhe përmbajtja e mesazheve për paralajmërim		
Mit: ndarja e informatave me publikun mund t'i keqësojë punët	Personat zyrtarë ndonjëherë nuk janë të gatshëm të komunikojnë informata deri te publiku përderisa situata nuk qartësohet. Përvojat dhe hulumtimet tregojnë se kur ekziston kanosje e besueshme, do të ishte më mirë që informatat t'ju jepen njerëzve të cilët mund të bëjnë diç lidhur me këtë. Pasojat dhe obligimet ekonomike, politike, juridike dhe morale për mospasiguri të informatave, atëherë kur kanë mundur të jepen, janë shumë të mëdha. Ekziston sfida që të sigurohet se njerëzit duhet të përgatiten të veprojnë në përputhje me informata e siguruar.	Aksion për paralajmërim të hershëm: hapja e qarkullimit të kontinuar të informatave me zhvillimin e ngjarjes- në kuptimin e plotë të fjalës, duke e rirrefyer tregimin për situatën emergjente, me paraqitjen e fakteve të reja- mundëson që udhëzimet e para të ndryshojnë me ndryshimin e situatave. Askush nuk pret që udhëzimet e mbrojtura të mbeten të pandryshueshme, me vetë faktin se edhe situata emergjente asnjëherë nuk mbetet statike. Publiku e përcjell situatën dhe i përshtat aksionet pasi të qartësohen faktet dhe pas ndryshimit të situatës.
Mit: Informatat duhet të jenë sa është e mundur më të qarta	Nëse informatat janë të sakta, janë të vogla gjasat se shumë informata deri te publiku drejtpërdrejtë të ndikojnë në sigurinë e tyre. Frika nga e njohura është më e mirë, sesa frika nga e panjohura. Doza e baraspeshuar e informatave të sakta mundet dukshëm t'i zvogëlojë supozimet. Mesazhet për paralajmërim nuk dërgohen sipas normave për reklama, respektivisht të jenë më të shkurtra se 30 sekonda; ato duhet të jenë të qarta por edhe të plota.	Aksioni për paralajmërim të hershëm: informatat duhet të sigurohen menjëherë pasi të jenë të kapshme. Për ngjarje sidomos të pasigurta, paralajmërimi paraqet dialog i cili ju ndihmon njerëzve që në mënyrë konstruktive të ballafaqohen me pasigurinë. Në shoqëri të lirë e cila është e pasur me informata, njerëzit janë të mësuar me procesimin e informatave. Shpeshherë, njerëzit dyshojnë se dikush po tenton të fshehtë diçka poqëse nuk kanë informata të kapshme.
Mit: Më mirë është të ketë një burim	Subjektet zyrtare konsiderojnë se një zëdhënës (me autorizim teknik) është praktikë e mirë për	Aksion për paralajmërim të hershëm: sikur të ketë madje një subjekt përgjegjës për

	diseminim të informatave për situata emergjente. Krahas kësaj logjike, individë dhe bashkësi do të kërkojnë informata nga burime të ndryshme. Më shumë burime informatash ju mundësojnë njerëzve t'i kryqëzojnë informatat, me qëllim që t'i pohojnë paralajmërimet dhe të sigurohet kredibilitet i informatave.	paralajmërim të hershëm, nevojitet që të ekzistojnë më shumë burime për transemtimin e mesazheve kyç. Zëdhënës të ndryshëm mund t'i transmetojnë mesazhet e njëjta ose të ngjashme.
Mit: Informatat janë të mjaftueshme	Njerëzit të cilët i takojnë kësaj gjenerate absorbojnë shumë informata për çdo ditë, gjë që e kanë të vështirë të vendosin sipas cilave informata të verpojnë. Por, vetë informatat nuk do të sjellin aksion.	Aksioni për paralajmërim të hershëm: përgatitja e të gjitha katër komponentëve për paralajmërim të hershëm. Kapacitet për përgjigje- aksion i hershëm- doemos duhet ti paraprijnë ose të jenë njëkohësisht me informatat.
Përgjigje mesazheve për paralajmërim		
Mit: pas paralajmërimeve të rrejshme, publiku nuk do të reagojë ndaj paralajmërimeve	Hulumtimet tregojnë se efekti i përgjigjes së publikut ,atëherë kur paralajmërimet janë të përgatitura mirë, nuk zvogëlohet kur ato nuk janë të shpeshta, por janë të planifikuara me vëmendje.	Aksioni për paralajmërim të hershëm: paralajmërimet e rrejshme duhet të shikohen si dritare për mundësi: duhet ti mësoni bashkësitë se paralajmërimet e rrejshme paraqiten si rezultat i pasigurisë së pashmangshme (shikoje parimin udhëheqës më poshtë) në vend të rezultatit të praktikës së dobët profesionale.
Mit: Publiku bën panik	Paniku në publik ndodh, por rrallëherë. Njerëzit në përgjithësi angazhohen në mënyrë të përshtatshme racionale, madje edhe atëherë kur janë shumë të frikësuar. Hulumtimet tregojnë se paniku ndodh vetëm atëherë kur ekziston hapësirë e kufizuar fizike, rrugë të papërshtatshme për ikje dhe gjatë ekzistimit të kanosjes së drejtpërdrejtë e të qartë.	Aksion për paralajmërim të hershëm: insistoni për rrugë të evakuimit të cilat janë të shënuara qartazi ,me qëllim që të arrihet deri në strehimoren e caktuar. Rregullisht organizoni stërvitje simultane. Paralajmërimet publike me kohë dhe efektive mund të ndihmojnë dukshëm në zvogëlimin e panikut gjatë situatave emergjente. Liderizmi efektiv gjithashtu e minimizon panikun.
Mit: Aksion urgjent dhe dëgjueshmëri	Njerëzit nuk i përgjigjen paralajmërimeve të para- të paktën jo menjëherë. Është e natyrshme që njerëzit të kërkojnë t'i krahasojnë informatat me fqinjët, miqtë, kolegët dhe mediat. Kërkimet tregojnë se njerëzit nuk i besojnë instrukcioneve për paralajmërim, përpos nëse nuk ekzistojnë udhëzime të qarta në mesazh. Ata do t'i krahasojnë informatat derisa të binden se rreziku është real.	Aksioni për paralajmërim të hershëm: llogariteni këtë anulim në strategjitë komunikuese. Insistoni për mesazhe të përsëritura- “jeni këmbëngulës” sa më shumë ju dëgjojnë, aq më të mëdha janë gjasat se do t'i besojnë dhe do të veprojnë sipas mesazhit.

4. Korniza politike dhe juridike ndërkombëtare për paralajmërim të hershëm

Paralajmërimi i hershëm ka imperativ global politik dhe juridik. Ky është obligim i paraparë me Deklaratën për ambient jetësor nga Rio të vitit 1992 dhe Strategjinë nga Jokohama të vitit 1994 dhe Kornizën për Aksion të Hjogo nga viti 2005. Gjithashtu, kjo në mënyrë implicite është cekur edhe në obligimet për respektimin e të drejtave njerëzore në shumicën e vendeve, si për shembull e drejta për jetë, barazi dhe shëndet. Lidhur me Lëvizjen e Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, paralajmërimi i hershëm potencohet në disa dokumente strategjike kyç.

Parimet 18 dhe 19 të Deklaratës nga Rio kanë të bëjnë me obligimet e shteteve, respektivisht “obligimin për informim”, ku midis tjerash thuhet: Informimi urgjent për çfarëdo “katastrofe apo situatë emergjente, e cila mund të prodhojë efekte të papritura negative për ambientin jetësor” dhe “njoftimi dhe shpërndarja paraprake dhe me kohë e informatave deri te shtetet, që mund jenë potencialisht të goditura nga aktivitete të cilat në mënyrë të konsiderueshme mund të kenë efekte të padëshirueshme tejkufitare për ambientin jetësor”. Shumica e rreziqeve për ambientin jetësor, i takojnë kësaj kategorie dhe për këtë arsye nevojitet paralajmërimi i hershëm ndërmjet shteteve. Ajo që është edhe më e rëndësishme, Parimi 10 i Deklaratës nga Rio, i fton të gjithë qytetarët e interesuar të marrin pjesë në çështjet lidhur me ambientin jetësor dhe i fton individët të sigurojnë “qasje përkatëse në informata të cilat i posedojnë autoritetet në shtet, e të cilat i përkasin ambientit jetësor”.

Strategjia nga Jokohama e vitit 1994 insiston për paralajmërim të hershëm të përmirësuar, teknologji ekonomike të qëndrueshme, madje apelon për formimin e Fondit për Dekadë ndërkombëtare për uljen e rreziqeve nga katastrofat, me të cilin do të financohet “vendosja dhe forcimi i sistemeve për paralajmërim të hershëm në vendet në zhvillim, të cilat i nënshtrohen katastrofave- sidomos ato më pak të zhvilluara, vende të rrethuara me tokë nga të gjitha anët dhe shtete të vogla- ishuj në zhvillim”.

Korniza për Aksion nga Hjogo i vitit 2005, e shton dimensionin humanitar imperativit politik për paralajmërim të hershëm- me të cilin ashpësohet përgjegjësia, jo dhe aq ndërmjet shteteve, sa ndërmjet qeverive nacionale dhe bashkësive të ekspozuara në rrezik. Në përgjithësi, për sistemet për paralajmërim të hershëm thuhet se “bazohen tek njerëzit, ku paralajmërimet bëhen me kohë dhe mund t'i kuptojnë njerëzit e ekspozuar në rreziqe dhe ku merren parasysh karakteristikat demografike, gjinore, kulturore dhe pronësore, të mbarë popullatës, përfshi edhe udhëzimet dhe drejtimit si të veprohet me rastin e paralajmërimit të dhënë dhe ata t'ju sigurojnë mbështetje efektive operacioneve të cilat i zbatojnë menaxhuesit për katastrofa dhe personat tjerë të cilët sjellin vendime. Vëmendja, para së gjithash, është e përqëndruar në komponentin e komunikimit për paralajmërim në suazat e sistemit për paralajmërim të hershëm. Mirëpo, domethënia e vërtetë e “mosluhatshmërisë së njerëzve” në Kornizën për aksion të Hjogo-s të vitit 2005 do të thotë tejkallim i konceptit të bashkësisë si marrës i informatave dhe nënkupton edhe situata ku

bashkësia gjithashtu mund të jetë përgatitës i informatava për paralajmërim të hershëm.

Edhe pse sistemi efektiv për paralajmërim të hershëm kontribuon aktivisht për përmbushjen e të gjitha katër prioriteve nga Korniza për Aksion e Hjogo-s, theksi i paralajmërimit të hershëm vihet në Prioritetin 2: "Identifikimi, vlerësimi dhe përcjellja e rreziqeve nga katastrofat dhe përforcimi i paralajmërimit të fuqishëm". Ky prioritet është orientuar para së gjithash nga komponentët përbërës të sistemit për paralajmërim të hershëm, siç janë njohuritë për rreziqet dhe monitorim dhe nuk i përket komponentit për përgjigje në rast katastrofe. Prioriteti 5 nga Korniza për Aksion të Hjogo:"Përforcim i gatishmërisë gjatë katastrofave për sigurimin e përgjigjes efektive në të gjitha nivelet", është me rëndësi të njëjtë që të sigurohet paralajmërim i hershëm efektiv. Këtu, në suazat e komponentit përgjigje në rast katastrofe, në të vërtetë, ringjallet termi i Federatës ndërkombëtare: paralajmërim i hershëm- aksion i hershëm në nivel të bashkësisë lokale.

Nga ana tjetër, qeveritë nacionale janë përgjegjës për kreimin, mirëmbajtjen dhe përsosjen e sistemit për paralajmërim të hershëm në të gjitha nivelet përkatëse. Sfera prioritare 2 fton për ndërtimin e "kapaciteteve institucionale me qëllim që sigurimi i sistemeve për paralajmërim të hershëm të jetë mirë i integruar në politikat qeveritare dhe proceset e vendimmarrjes dhe sistemet për menaxhim krize në nivel nacional dhe lokal, me ç'rast sistemet duhet rregullisht të vëzhgohen dhe të bëhet vlerësimi i suksesit".

Edhe pse shumë vende kanë sjellur ligj se si jipet paralajmërimi në rast të situatave emergjente, vetëm në numër të vogël rastesh, me ligj ose rregullore të Qeverisë janë të rregulluara funksionet, rolet dhe përgjegjësitë e çdo faktori përgjegjës në procesin e vëzhgimit të diseminimit të paralajmërimeve. Të metat të cilat mund t'i konsultojnë shoqatat nacionale lidhur me avokaturën, janë prezentuar në udhëzimin e Federatës ndërkombëtare "Udhëzime për diplomacinë humanitare, Pjesa 2: Çështje ligjore në menaxhimin e katastrofave dhe situatave emergjente shëndetësore".

Duke marrë parasysh se paralajmërimi i hershëm duhet të paraqesë imperativ për qeveritë nacionale, shoqatat nacionale, përmes rolit të tyre ndihmës për përkrahje autoriteteve në shtet, në fushën e uljes së rreziqeve, paralajmërimin e hershëm e trajtojnë si mekanizëm për mbrojtjen e jetës, shëndetit dhe pronës së njerëzve.

Kjo çështje, gjithashtu, është përkrahur edhe në Strategjinë 2020 të Federatës ndërkombëtare, ku në qëllimin strategjik 1 thuhet:"Sistemet e sigurisë për paralajmërim të hershëm janë me rëndësi instrumentale për shpëtimin e numrit maksimal të njerëzve dhe mbrojtjen e pronës dhe mjeteve të njerëzve. Aksioni 2 nga i njëjti dokument, i quajtur "Udhëheqje e diplomacisë humanitare për pengimin dhe zvogëlimin e ndjeshmërisë në botën globale", nxitë "aksion për zgjidhjen e shkaqeve nga të cilat vuajnë njerëzit dhe për pengimin apo zvogëlimin e situatave të ardhshme të ndjeshme, konflikteve, dhe krizave përmes paralajmërimit të hershëm për situata emergjente.

Më tutje, në Qëllimin kryesor 3.1 të Konferencës ndërkombëtare 28-të të Lëvizjes ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe (Qershor 2003) thuhet se: "... masa për minimizimin e ndikimeve të katastrofave janë... instalimi i sistemeve për paralajmërim të hershëm".

Rrjeti i Kryqit të kuq/Gjysmëhënës së kuqe, ka mundësinë e vetme të kontrobuojë në bashkësi për sigurimin e paralajmërimit të hershëm, nëpërmjet rolit ndihmës të shoqatave nacionale, nëpërmjet rrjetit të vullnetarëve dhe qasjes së tyre deri te bashkësitë tejet të rrezikuara.

Shoqatat nacionale, si ushtrues të rolit ndihmës të autoriteteve në shtet, në planin humanitar gëzojnë partnerirete specifike në të gjitha nivelet, në drejtim të sigurimit të përkrahjes autoriteteve për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të njerëzve. Për disa shoqata nacionale, paralajmërimi i hershëm mund të ketë rol kyç në sigurimin e këtij roli për të siguruar përkrahje.

Të gjitha organizatat joqeveritare, të cilat janë përqëndruar në uljen/menaxhimin e rreziqeve nga katastrofat, duhet të kenë parasysh paralajmërimin e hershëm si një nga elementet shumë të rëndësishëm në punën e tyre.

Praktikë e mirë:

Projektligji për menaxhimin nacional të katastrofave në Etiopi, e dallon dhe theksin e vë në sistemin për paralajmërim të hershëm në nivel bashkësie.

5. Korniza institucionale për paralajmërim të hershëm

Ekzistojnë subjektë të shumtë të kyçur në fushën e paralajmërimit të hershëm dhe qëllimi i këtij doaracaku nuk është t'i cekë ato. Në këtë pjesë, shkurtimisht do ti përmendim subjektet kyç të cilat kanë mandat të qartë në fushën e paralajmërimit të hershëm si dhe komponentët e sistemeve për paralajmërim të hershëm, ku më së shpeshti e japin kontributin e tyre. Kjo pjesë përfundon me theksin mbi rolet e ndryshme në shoqërinë civile në secilin nivel të sistemeve për paralajmërim të hershëm.

Edhe pse, kur flasim për bashkësitë, thuhet se ato janë fundi i zinxhirit për paralajmërim të hershëm, përkundrazi ato duhet të jenë në vend të parë ku informatat fillimisht duhet të arrijnë, me qëllim të ndërmarrjes së aktiviteteve me kohë. Bashkësitë e informuara mirë, i kanë të njohura rreziqet prioritare. Bashkësitë janë ato të cilat të parat duhet të përgjigjen për mbrojtjen vendbanimeve të tyre si dhe personave të hendikepuar.

Shumë bashkësi janë të motivuara dhe në mënyrë të pavarur ndërmarrin aktin e paralajmërimit të hershëm pa pritur t'ju jipet informata apo paralajmërim nga jashtë. Nga ana tjetër, bashkësitë tregojnë gatishmëri për të marrë informata lidhur me përcjelljen e situatës ose informata për paralajmërim dhe pastaj të

organizojnë dhe zbatojnë aktivitete për përgjigje. Shoqatat nacionale dhe vullnetarët, gjithsesi, janë zgjidhja më e mirë për ndërmarrjen e aktiviteteve për gatishmëri dhe përgjigje ndaj katastrofave në bashkësitë të cilët janë të ekspozuara ndaj rreziqeve të ndryshme.

Shoqëria civile, është e përbërë nga komponentë dhe grupacione të ndryshëm, ndër të cilat bëjnë pjesë edhe Lëvizja ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe, organizata joqeveritare ndërkombëtare dhe nacionale, organizata lokale në bashkësi.² Këto janë institucione, mandatet e të cilëve kanë për qëllim t'i mbështesin qeveritë në sigurimin e përkrahjes për mbrojtjen e popullatës në vendet e tyre.

Te sistemet për paralajmërim të hershëm, organizatat të cilat i takojnë sektorit civil paraqesin urë të rëndësishme midis agjencive shkencore teknike apo qeverive nacionale dhe bashkësive, përfshirë në baza vullnetare, në të cilat mbështeten bashkësitë. Ata kanë një përparësi karakteristike me atë që kanë njohuri të mira për bashkësitë dhe kanë kapacitet për interpretimin e informatave lidhur me paralajmërimin e hershëm të cilat sigurohen jashtë bashkësisë. Në mbarë botën sektori civil punon në projekte për paralajmërim të hershëm, kurse shumica prej tyre janë pjesë integrale të programeve për uljen e rreziqeve nga katastrofat.

Autoritete nacionale dhe lokale, ashtu siç u cek më lart, kanë obligim t'i mbrojnë të gjithë banorët nga rreziqet për jetën e tyre dhe shëndetin e njerëzve. Sistemet nacionale për paralajmërim të hershëm janë mjet dedikuar për forma të ndryshme të rreziqeve të cilat mund t'i shfrytëzojnë qeveritë për t'i përmbushur këto obligime. Sistemet nacionale për paralajmërim të hershëm mund të jenë në forma të ndryshme; ata mund të jenë njësi autonome të posaçme ose nëpunës individual të integruar në ministri apo agjenci të ndryshme.

Ligjet nacionale, provinciale dhe lokale duhet të sigurojnë që institucionet qeveritare të kenë mandate të qarta lidhur me sistemet për paralajmërim të hershëm në të gjitha nivelet, të ketë burime të mjaftueshme për kryerjen e obligimeve të tyre dhe të dijnë se duhet ta inkorporojnë mendimin e bashkësisë dhe shoqërisë civile në planifikimin e tyre dhe implementimin e proceseve në të gjitha nivelet.

Institucionet qeveritare duhet të jenë përgjegjës për sigurimin e mesazheve për paralajmërim të hershëm të cilët duhet të arrijnë deri te mbarë popullata e ekspozuar në rrezik dhe të ndërrmarin aktivitete përkatëse dhe në kohë. subjektet të cilat më së shpeshti janë të angazhuar në sferën e paralajmërimin të hershëm janë agjencitë/njësitë nacionale për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofat si dhe të shërbimeve metereologjike, hidrologjike dhe shëndetësore. Sistemet nacionale për paralajmërim të hershëm dhe/ apo këto

²Edhe pse shoqatat nacionale tll Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe janë ndihmës të qeveritarëve, ndërsa Federata ndërkombëtare e shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhës së kuqe është organizatë ndërkombëtare, Lëvizja është e kyçyr në këtë kategorizim sepse shoqëria civile është esenca e mandatit të Lëvizjes.

shërbime shpeshherë kanë përfaqësues në nivel lokal, sidomos në rajonet e ekspozuara në rrezik më të madh.

Ekziston numër gjithnjë e më i madh dhe vazhdimisht i ndryshueshëm i agjencive të specializuara shkencore globale apo rajonale të cilat kanë mandat për përcjelljen e situatave që kanë të bëjnë me ambientin jetësor, shëndetin dhe kushtet sociale dhe/ose sigurimin me kohë të prognozave dhe paralajmërimeve. Shumica e këtyre agjencive teknike janë drejtpërdrejt të lidhura me institucionet kërkimore, trupat dhe organizatat rajonale të Kombeve të Bashkuara. Shumica prej tyre kanë kushte të përshtatura kërkesave dhe nevojave humanitare në botë.

Edhe pse ata janë të angazhuar me fokus grupe të ndryshme publiku gjatë aktiviteteve të ndryshme (sigurjnë edhe ndihmë të vlefshme teknike dhe pajisje për shoqatat nacionale, organizatat joqeveritare, madje edhe për bashkësitë), disa sosh e mbajnë epitetin e shërbyesve për nevojat e bartësve të vendimeve nga vendet e tyre- donatorë, apo të atyre vendeve në të cilat punojnë.

Sidoqoftë, shumica prej tyre sigurojnë informata të dobishme dhe të kapshme teknike, të cilat shpeshherë janë të kapshme edhe në internet, e të cilat duhet të integrohen në sistemet nacionale dhe lokale për paralajmërim të hershëm. Një pjesë e tyre janë pasqyruar në Tabelën 4 dhe kanë të bëjnë me rreziqet kryesore të cilat përcillen.

Tabela 4: Shembuj të agjencive të cilat angazhohen në përcjelljen e informatave për paralajmërim të hershëm në nivel global apo rajonal

Rrezik	Subjekte globale aktive në sferën e përcjelljes së informatave për paralajmërim të hershëm
Stuhi	<ul style="list-style-type: none"> • Organizata botërore meteorologjike Organizata botërore meteorologjike ju siguron vendeve (189 vende/teritore anëtare) informata lidhur me përcjelljen, parashikimin dhe paralajmërimin për rreziqe hidrometeorologjike, si dhe udhëheqjen e qendrave të specializuara regjionale. http://severe.worldweather.org/; www.wmo.int; • Universiteti në Havai www.solar.ifa.hawaii.edu/Tropical/tropical.html • Federata ndërkombëtare e CK/CP, në partneritet me Institutin ndërkombëtar për hulumtinin e klimës dhe shoqërisë http://iridl.ldeo.columbia.edu/maproom/.IFRC/.Forecasts/
Vërshime dhe rrëshqitje e tokës	<ul style="list-style-type: none"> • Dartmouth www.dartmouth.edu/~floods • Ifnet www.internationalfloodnetwork.org/03_f_info.html • Konsorciumi ndërkombëtar për rrëshqitjen e tokës http://icl.dpri.kyoto-u.ac.jp/Landslides%20Alert.html
Thatësira	<ul style="list-style-type: none"> • Shërbimi humanitar për paralajmërim të hershëm www.hewsworld.org/drought/ • Sistemi global për informim dhe paralajmërim të hershëm

	<ul style="list-style-type: none"> www.fao.org/qIEWS/english/index.htm Qendra për hulumtim të rreziqeve në Benfilld http://drought.mssl.ucl.ac.uk/drought.html Sistemi për paralajmërim të hershëm për uri www.fews.net/
Zjarre pyjesh	<ul style="list-style-type: none"> Qendra eksperimentale për parashikime klimatike qendra globale për monitorim të zjarreve www.fire.uni-freiburg.de Internet hartë për zjarret (U.Merilend) http://maps.geog.umd.edu/default.asp
Tërmete, vullkane, cunami	<ul style="list-style-type: none"> Programi amerikan për kërkime gjeologjike dhe vullkane http://earthquake.usgs.gov/eqcenter/recenteqswww/catalogs/caprss1days2.5.xml www.volcano.si.edu/reports/usgs/ Gjeofon www.gfz-potsdam.de/geofon/new/rt.html Komisioni oqeanik ndërqeveritar i UNESCO-s http://ioc3.unesco.org/indotsunami/ Sistemi për paralajmërim nga cunami në Pacifik www.prh.noaa.gov/ptwc/
Epidemi/shëndet	<ul style="list-style-type: none"> Organizata botërore e shëndetësisë www.who.int/csr/outbreak_network/en/
Konflikte	<ul style="list-style-type: none"> Sistemi kontinental për paralajmërim të hershëm i Unionit kontinental afrikan

Gjithashtu rritet numri i qendrave rajonale teknike. Qendra rajonale për paralajmërim të hershëm për Azi dhe Afrikë është shembull interesant për përpjekjet për paralajmërim të hershëm për më shumë rreziqe në të dy kontinentet të cilat shtrihen rreth Oqeanit Indian. Qendra Afrikane për aplikacione meteorologjike për zhvillim, përgatit prodhime sezonale për të cilat kanë nënshkruar marrëveshje me Federatën ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe.

Në kuadër të sistemit të Kombeve të Bashkuara, shumë subjekte japin kontribut aktiv në sferën e paralajmërimit të hershëm; një pjesë e tyre janë pasqyruar në Tabelën 4. shumica prej tyre i përcjellin rreziqet në pajtim me mandatin e tyre specifik.

Organizata botërore e meteorologjisë është orientuar drejt rreziqeve atmosferike (me iniciativë të re, e udhëhequr nga Korniza globale për kushte klimatike), Organizata botërore e shëndetësisë i përcjell rreziqet shëndetësore, kurse Organizata për shëndet dhe bujqësi bashkë me Programin botëror për ushqim i përcjellin rreziqet që i përkasin urisë, dhe përgjithësisht çështjet lidhur me ushqimin dhe sigurinë e tij.

UNESCO gjithashtu kontribon edhe në sferën e paralajmërimit të hershëm në fushën e resurseve të ujit dhe oqeanografisë. Edhe subjekte të tjera kontribujnë në sistemet për paralajmërim të hershëm, si p.sh. Strategjia ndërkombëtare për zvogëlimin e rreziqeve të Kombeve të Bashkuara, Programi zhvillimor i Kombeve të Bashkuara dhe Komisioni i lartë për refugjatë.

Donatorët dhe vendet e zhvilluara të cilët deri më tani kanë bërë investim të konsiderueshëm në sferën e paralajmërimit të hershëm janë Komisioni Evropian për ndihma humanitare, Drejtoria për mbrojtje civile dhe Programi për gatishmëri në rast të katastrofave (DIPECHO), Suedi (MSB). Gjermani (GIZ), Norvegji, Japoni (JICA), Mbretëria e Bashkuar dhe SHBA (USAID).

Në nivel institucional, nevojiten përpjekje të përbashkëta për realizimin e sistemeve efektive për paralajmërim të hershëm midis niveleve të ndryshme ku ndodhin aktivitetet. Në Pasqyrimin 2, mandatet kryesore institucionale në sferën e paralajmërimit të hershëm janë përshkruar për çdo nivel (lokal, nacional, rajonal/global).

Është e rëndësishme të ceket se interesat kryesore të cilat janë në pyetje dhe të cilat duhet të shërbejnë, janë ato të bashkësive të ndryshme të ekspozuara në rreziqe dhe të individëve të cilët jetojnë në to pa marrë parasysh se kush janë. Edhe pse rolet mund të dallohen, në të gjitha nivelet doemos duhet të këmbëhet qëllimi përfundimtar.

Pasqyra 2: Roli i praktikienëve të sistemeve për paralajmërim të hershëm

Nivel lokal (bashkësi, OOCK)	Nivel nacional	Nivel rajonal dhe global
<ul style="list-style-type: none"> • Përforsim i kapaciteteve të bashkësive të ekspozuara ndaj rreziqeve si dhe i vullnetarëve që të mund të analizojnë dhe veprojnë pas marrjes së paralajmërimit. • Përforsimi i kapaciteteve të qeveritarëve lokal për mbrojtje të bashkësive (rol ndihmës i shoqërive nacionale) • kur është adekuate përgatitja dhe përkrahja bashkësive që të zhvillojnë dhe përdorin sistemet për paralajmërim të hershëm, sigurimin e monitorimit lokal të situatave dhe 	<ul style="list-style-type: none"> • Integrim i paralajmërimit të hershëm në programet operative dhe strategjike për zvogëlim të rreziqeve nga katastrofat. • Përkrahje qeverive nacionale për zhvillimin e sistemeve për paralajmërim të hershëm të cilat bazohen te njerëzit dhe të cilat janë të lidhura ngusht me bashkësitë e ekspozuara në rreziqe. • Përfaqësimi i partneritetit me sistemet tjera për paralajmërim të hershëm, përfshirë edhe subjektet globale të cilat sigurojnë përkrahje teknike dhe monitorim të dobishëm 	<ul style="list-style-type: none"> • Kapërcim i të metave dhe vendosje e lidhjeve ndërmjet qendrave të diturisë apo forumeve rajonale dhe përpjekjeve nacionale dhe lokale për paralajmërim të hershëm. • Sigurimi i mesazheve të lehta dhe të dobishme për paralajmërim të hershëm në periudha të ndryshme kohore. • Sigurim i kontrolleve rutinore nga tereni dhe informata kthyesë për prodhime dhe mesazhe lidhur me paralajmërimin e hershëm. • Shkëmbim përvojash midis praktikienëve për këmbimin e praktikave

<p>mesazheve që vijnë nga vendi i ngjarjes.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Konektimi i bashkësive me njohjen e jashtme për paralajmërim të hershëm. • Sigurimi i kontrollit real për përpjekje globale, rajonale dhe nacionale për paralajmërim të hershëm. 	<p>si dhe produkte dedikuar për paralajmërim të hershëm.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Lidhshmëria midis informatave teknike/monitorim i bartësve të vendimeve në nivel nacional. 	<p>të mira dhe leksioneve të mësuara.</p>
---	---	---

Tema të kryqëzuara-parime udhëheqëse

Ky kapitull ka për qëllim lexuesit t'i sigurojë parime të përgjithshme udhëheqëse, të cilat duhet t'i ndihmojnë gjatë zgjedhjes së sistemeve për paralajmërim të hershëm në rajon apo vend në nivele të ndryshme (në nivel nacional ose lokal). Këto janë realizuar nga vargu i praktikave pozitive në sferën e paralajmërimit të hershëm nga mbarë bota. Në këtë dhe në kapitullin vijues, janë paraqitur disa praktika të mira dhe leksione të dobishme, si shembuj nga kontekste dhe vende të ndryshme.

Siç u cek më lartë, shoqatat nacionale mund të japin kontribut të rëndësishëm në shpëtimin e jetës së njerëzve nëpërmjet programimit të paralajmërimit të hershëm. Mirëpo, para se të fillojë puna dhe marrja e roleve në këtë sferë, shoqatat nacionale duhet të kujdesen për atë se i kuptojnë dhe i pranojnë rreziqet të cilat përfshihen në këtë punë. Çështje kyç është a kanë ata kapacitet që vazhdimisht t'i përmbushin të priturat të cilat do t'i shtrojnë. Ato të pritura mund të jenë të natyrës morale, politike dhe juridike.

Parimi udhëheqës 1:

Integrimi në uljen e rreziqeve nga katastrofat- sistemi për paralajmërim të hershëm nuk është proces më vete

Sistemet për paralajmërim të hershëm nuk do të jenë të suksesshëm as të arsyetueshëm si aktivitete të pavarura. Kur të ekzistojë bindja se ka nevojë për sistem për paralajmërim të hershëm, ai duhet të disenjohet në suazat e aktiviteteve më të gjëra për uljen e rreziqeve nga katastrofat.

Formimi i sistemit për paralajmërim të hershëm në cilindo qoftë nivel, pa ekzistimin e lidhshmërisë me aktivitetet për uljen e rreziqeve nga katastrofat, në mënyrë të pashmangshme do të rezultojë në prodhim joefikas dhe jo të qëndrueshëm, i cili nuk do ta japë ndikimin e pritur (do të rezultojë me humbjen e jetës së njerëzve dhe pronës së tyre).

Zhvillimi dhe mirëmbajtja e sistemit për paralajmërim të hershëm në nivel lokal, madje edhe poqëse nuk është i shtrenjtë, megjithatë kërkon investim të kohës dhe burimeve dhe nuk duhet të bëhet pa u shqyrtuar me kujdes të gjitha alternativat, atëherë kur të paraqitet nevoja për këtë ose për shkak të arsyeshmërisë së operacionit. Në cilindo nivel, çdo sistem për paralajmërim të hershëm do të jetë i dobishëm të integrohet në program gjithpërfshirës për uljen e rreziqeve nga katastrofat. Pothuaj në çdo kontekst ka diçka të dobishme që mund të bëhet për forcimin e sistemit ekzistues për paralajmërim të hershëm apo për vendosjen e tij.

Shpeshherë, organizata e cila zhvillon aktivitete për uljen e rreziqeve nga katastrofat, tashmë zbaton shumë aktivitete të cilat janë pjesë përbërëse të sistemit për paralajmërim të hershëm (disa nga këto aktivitete janë pasqyruar në kapitullin C).

Qëllimi është që të krijohet paket aktivitetesh për uljen e rreziqeve nga katastrofat, i cili i përshtatet nevojave të identifikuara nga qeveritë dhe/ose bashkësitë i cili mund të mbahet nëpërmjet angazhimit të subjekteve relevante të mbarë sistemit shtetëror.

Praktikë e mirë:

Nivelet e ndryshme janë të integruara dhe reciprokisht të lidhura në sistemin zyrtar për paralajmërim të hershëm të Nikaraguas, me përkrahjen e institucioneve nacionale dhe komunale, Kryqit të kuq të Nikaraguas, shoqatave nacionale për partneritet (Kryq i Kuq spanjoll, Kryqi i Kuq italian dhe Kryqi i Kuq holandez), organizata joqeveritare, subjekte nga sektori privat dhe anëtarë të bashkësive. E gjithë kjo është rregulluar me Ligjin 337 të vitit 2000 të Nikaraguas, me emrin Ligji për vendosjen e sistemit nacional për preventivë, zbutje dhe përgjigje për katastrofat dhe e implementuar me dekret.

Instituti për studime teritoriale të Nikaraguas është përgjegjës për vëzhgimin e vërshimeve (lumni Eskondido dhe lumin Vava), cunamit (në San Rafael del Sur Managua dhe Korinto-Kinandega) dhe erupcionet vullkanike (në Leon, Kinandega dhe Isla de Ometepe).

Këto sisteme për paralajmërim të hershëm janë në më shumë nivele dhe gjithashtu janë pjesë nga rrjeti rajonal i Amerikës Qendrore për monitorim. Qeveria është përgjegjëse për të gjitha alarmimet, të cilat mund të realizohen në tre nivele dhe bashkësitë janë aktivisht të përfshira në ndërtimin e kapaciteteve për përgjigje (plane evakuuese, përgatitja e hartave dhe orientimeve sinjalizuese), komunikimeve për paralajmërim (marrje informatash, vënia e kodeve dhe aktivizimi i alarmit në nivel bashkësie).

Në këto aktivitete janë përfshirë rreth 80 vullnetarë nga Kryqi i Kuq i Nikaraguas, të cilët punojnë në nivel lokal. Institucionet të cilët marrin pjesë me financim janë komitetet komunale për preventivë dhe zbutje të katastrofave në nivel lokal, COSUDE, ECHO, IDB dhe JICA.

Parime udhëheqëse 2:

Qëllimi është sinergji në çdo nivel: në nivel të bashkësisë si dhe në nivel nacional, rajonal dhe global

Siç u cek më parë, sistemi për paralajmërim të hershëm nuk duhet të jetë i pavarur dhe i izoluar nga programi i përgjithshëm për zvogëlim të rreziqeve nga katastrofat, por përkundrazi duhet të jetë aktiv dhe funksional në çdo nivel. Sinergjia në mes niveleve të ndryshme do të sigurojnë mbrojtje më të mirë të mundshme të jetës së njeriut dhe të të mirave të tyre materiale. Në Tabelën 5 janë pasqyruar rolet e ndryshme për përkrahje të Kryqit të Kuq/ Gjysmëhënës së Kuqe dhe organizatave joqeveritare në sferën e vendosjen së sistemit për paralajmërim të hershëm në bashkësi.

Janë prezentuar shembuj çka mund të pritet nga sistemi tërësisht funksional për paralajmërim të hershëm në çdo nivel- së pari si sistem i pavarur (Kolona 1) , e më pastaj edhe si sistem i plotë i integruar (kolona 2). Qeveritë janë përgjegjëse për mbrojtjen e njerëzve, si p.sh. nëpërmjet krijimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve për paralajmërim të hershëm.³ Nëse krijohen sisteme të këtilla në nivel lokal, çdo qeveri ka përgjegjësi të sigurojë koordinim në nivel nacional për të siguruar mbrojtjen e pronës dhe jetës së njerëzve. Për këtë qëllim, duhet t'ju jepet mandati institucioneve qeveritare, nëpërmjet sjelljes së ligjeve ose politikave të qarta me mjete përkatëse financiare.

³*Për tërmetet, ka më shumë mundësi obligimet financiare ose paralajmërimin e hershëm mos të ketë nevojë ta ndërmarrin qeveritë, por rrjetet e përgjithshme për paralajmërim të përkrahen në nivel lokal.*

Siç përmendëm më lart, shoqatat nacionale kanë rol të veçantë ndihmës dhe ju ndihmojnë qeverive për përmbushjen e kësaj detyre. Organizata joqeveritare për partneritet, gjithashtu, punojnë në funksionalitetin e programeve për përkrahje gjatë zvogëlimit të rreziqeve nga katastrofat dhe përforcimin e kapaciteteve për paralajmërim të hershëm. Në nivel nacional, është e dobishme shoqatat nacionale dhe sektori joqeveritar t'i forcojnë rrejetet për paralajmërim të hershëm për pranim, analizë, interpretim dhe prognozë të bazuara në prodhime të monitoruara globale apo rajonale, siç janë forumet klimatike regjionale.

Praktikë e mirë:

Në Afrikën Perëndimore, në vitin 2007, u apeli i parë për parashikim sezonal (paratë u morën përmes DREF). Federata ndërkombëtare dha pëlqim për 750,000 US \$ për mbrojtje nga vërshimet dhe të reshurat dhe siguroi ndihmë humanitare, trajnim për vullnetarët dhe përgatitjen e planeve për veprim gjatë situatave emergjente. Si rezultat i kësaj, u shpëtuan shumë jetë, koha për përgjigje dukshëm u zvogëlua dhe burimet u përdorën në mënyrë më efektive.

Tabela 5 Përpjekje të izoluara krahas përpjekje të integruara, shembuj të izoluar nëpër nivele

Nivel i sistemit për paralajmërim të hershëm	Përpjekje të izoluara për paralajmërim të hershëm	Përpjekje të integruara në nivele të ndryshme
Në nivel të bashkësisë	Familjet vetë i përcjellin nivelet e lumenjve dhe bëjnë evakuimin për shpëtim deri në një nivel të caktuar, por qeveritarët komunal dhe nacional nuk janë të informuar dhe nuk ndërmarrin kurrfarë masash për të ofruar ndihmë dhe rehabilitim.	Familjet paralajmërohen për stuhi të mundshme disa ditë para ngjarjeve, i krahasojnë informatat e marra me kapacitetet lokale të lumenjve dhe mund ta shpëtojnë jetën dhe pronat e njerëzve. Ekzistojnë plane dhe ata janë të stërvitur se si duhet vepruar në rast të paralajmërimit.
Në nivel nacional	Trupat nacional fillojnë me mbindërtimin e kapaciteteve për paralajmërim të hershëm, por ekzistojnë pak stacione meteorologjike në vend.	Enti nacional meteorologjik është i përkrahur nga shoqatat nacionale dhe sektori joqeveritar, dhe vizitohen rajonet e rrezikuara ku nuk ka stacione meteorologjike, për t'u vlerësuar mënyrat e thjeshta përmes të cilave mund të përcillet situata. Pas analizave të të dhënave, ato arkivohen në nivel nacional dhe integrohen në sistemin për paralajmërim të hershëm.
Në nivel rajonal	Vërshimet përcillen me kujdes në nivel rajonal për paralajmërim të hershëm, por subjektet rajonale nuk i marrin parasysh prognozat më serioze të cilat mund të ndikojnë në kontekstin lokal dhe nuk i bartin paralajmërimet	Rajoni ka dobi nga prognozat rajonale. Përmirësohen mjetet rajonale për veprim në rast vërshimi dhe është inkorporuar internet i bazuar në sistemin për paralajmërim të hershëm, i cili jep paralajmërimet njëkohësisht për të gjitha vendet për ngjarjet që do të

	në kohë deri tek secili vend..	vijojnë.
Në nivel ndërkombëtar/global	Teknologjitë e larta sigurojnë prognozime sezonale impresive me saktësi gjithënjë e më të madhe për thatësira të mudnshme. Vendet e ekspozuara në rrezik mund të mos i marrin në kohë këto informata dhe kjo të rezultojë me ndikim negativ në familjet, bagëtinë dhe të mbjellurat në bashkësitë e ekspozuara ndaj rrezikut.	Prognozat sezonale klimatike janë me kujdes të përshtatura për fokus grupet, dhe organizohen trajnime për gatishmëri. Ka fonde (Fondi për raste emergjente gjatë katastrofave) dhe është e pozicionuar ndihmë humanitare në afërsi të rajoneve të rrezikut ku mund të ndodhë katastrofa.

Praktikë e mirë:

Në Siera Leone dhe Liberi (Projekt për përsosjen e kapaciteteve për menaxhim me katastrofa në Afrikën Perëndimore, 2008-12), edhe pse shërbimet nacionale për paralajmërim të hershëm dhe entet meteorologjike nuk janë të furnizuar me aparaturë për dhënie të paralajmërimiëve, kyçja sistematike e qeveritarëve, përgjegjës për menaxhim në raste krize, në trajnimet për paralajmërim të hershëm në bashkësitë lokale të dy vendeve, mundësoi më mirë të kuptohet aspekti i paralajmërimit të hershëm, i cili bazohet te njerëzit, dhe kontribuoi për harmonizimin e legjislativave nacionale me sistemet nacionale për paralajmërim të hershëm.

Leksione të mësuara:

Krahas progresit që është arritur në sferën e prognozave sezonale, ekziston ende hapësirë për përmirësimin e gjendjes në këtë plan. Çdoherë ekzistojnë mundësi të ndodhin edhe ngjarje, për të cilat gjasat kanë qenë shumë të vogla që të ndodhin. Kryqi i kuq i Mongolisë punon në bashkëpunim të ngushtë me Institutin kërkimor për klimë dhe shoqëri gjatë periudhës kohore dhjetor 2009 – shkurt 2010, por përcjellja e informatave (shembull, një nga pes shanset që dimri të jetë më i ftohtë se zakonisht) nuk kontribuoi të përgatitet apel për marrjen e aktiviteteve preventive.

Në muajin maj, Qeveria shpalli gjendje të jashtëzakonshme, gjatë së cilës ngordhën 8.4 milion krerë kafshë. Shikuar nga retrospektiva, mund të thuhet se, edhe pse prognozat paralajmëronon gjasa të vogla, megjithatë është dashur të ndërmerret aksion i caktuar, duke marrë parasysh ndikimin e dimrave të ftohtë në Mongoli pas thatësirave verore të cilat i shkretuan kullosat, kurse barinj të ngelën pa sanë.

Parimi udhëheqës 3:

Qëllimi është ekzistimi i sistemeve për paralajmërim të hershëm për shumë rreziqe

Sistemi për përalajmërim të hershëm, paraqet sistem nga sistemet, i cili centralizon informata, përgjigje idhe paralajmërim, karshi rreziqeve të cilat paraqesin kanosje të drejtëpërdrejtë në një nivel të caktuar, duke u përqëndruar sidomos në rezistueshmërinë dhe ndjeshmërinë. Kjo nuk do të thotë se subjektet përgjegjëse për paralajmërim të hershëm në nivel qendror, duhet të angazhohen në të gjitha komponentët për të gjitha rreziqet, por ata duhet të kompilojnë, kuptojnë dhe paraqesin ide në nënsistemet, në mënyrë të tillë që të nxisë sinergji dhe kufizojë dyfishimin e panevojshëm të përpjekjeve dhe mjeteve.

Përparësitë e sistemit për paralajmërim të hershëm për rreziqe të ndryshme janë të shumfishta. Përparësia më e rëndësishme është se sistemet për paralajmërim të hershëm për rreziqe të ndryshme, për nga definicioni, zhvillohen në saje të analizës sistemore dhe dhënies përparësi një seti të caktuar rreziqesh dhe kanosjesh, të cilave i ekspozohet vendi ose bashkësia.

Kjo do të thotë se pas shqyrtimit sistemor të rreziqeve, duhet të identifikohen ato më të dëmshmet dhe më të drejtëpërdrejtat. Analiza integrative dhe gjithpërfshirëse, mundëson paradispozicionim të sistemit për paralajmërim të hershëm në bazë më të fortë. Sistemi për paralajmërim të hershëm, i cili është përgjegjës për menaxhimin e më shumë rreziqeve të ndryshme, do të ketë beneficion të posaçëm në këto aspekte:

- Nivele më stabile të aktiviteteve për paralajmërim të hershëm gjatë gjithë vitit: gjatë sezonit të qetë derisa një rrezik i caktuar është latente, respektivisht i heshtur, atëherë me siguri paraqitet nevoja për vëzhgimin e rrezikut tjetër. Kur dy rreziqe janë të heshtura (për shembull vërshime gjatë sezonit të thatë), megjithatë do të paraqitet nevoja për monitorim të ndjeshmërisë (ose rezistencës).
- Efikasitet më i madh i burimeve të kufizuara njerëzore dhe financiare: sistemi i centralizuar për paralajmërim të hershëm në cilindo nivel, e minimizon mirëmbajtjen e sistemit dhe numrin e vullnetarëve/të punësuarëve të nevojshëm. Për shembull, për përcjelljen e treguesve për një rrezik të caktuar, mbase nuk do të ketë nevojë për angazhim të plotë (orar të plotë pune) të një personi.
- Qartësi më e madhe: sistemi i vetëm i autorizimeve, do të rezultojë me konfuzion më të vogël për shfrytëzuesit sa i përket kërkesës së informatave për paralajmërim të hershëm.

Format e rreziqeve janë të ndryshme dhe mund të kenë ndikime të ndryshme në periudha të ndryshme kohore dhe në lokacione të ndryshme gjeografike, por

elementet tjera të më shumë sistemeve për paralajmërim të hershëm, në esencë janë shumë të ngjashme:

- Nevojë dhe proces (jo instrumente) për monitorim.
- Nevojë për paralajmërim në faza (për shembull, faza e gjelbër, e verdhë, dhe e kuqe) dhe procese për caktimin e pragjeve të cilat shkaktojnë aksion.
- Kanale komunikimi, të cilat shfrytëzohen për dhënien e paralajmërimeve.

Më poshtë janë pasqyruar disa shembuj të përpjekjeve për rreziqe të ndryshme në nivele të ndryshme:

Praktikë e mirë:

Në katër vende të rajonit të Azisë-Pacifikut (Indonezi, Filipine, Sri-Lankë dhe Vietnam) Kryqi i kuq amerikan dhe Qendra për gatishmëri gjatë katastrofave e Azisë, organizuan projekt me emrin “Failitirim i integritetit të paralajmërimit për cunami, nëpërmjet përforsimit të sistemeve për paralajmërim nga rreziqe të ndryshme”. Projekti ka për qëllim të formojë forume të reja nacionale dhe t’i përforsojë forumet ekzistuese për paralajmërim të hershëm, ti mnindërtojë kapacitetet e shoqatave nacionale për transformimin e informatave ç[r rreziqe të ndryshme në opzione të ndryshme për përgjigje dhe komunikim të këtyre opsioneve deri të bashkësitë e ekspozuara ndaj rreziqeve. Projekti gjithashtu ka për qëllim ta mbështesë sistemin për mbikëqyrje që të testohet funksionaliteti dhe siguria e sistemeve për paralajmërim të hershëm në bashkëpunim me subjektet përgjegjëse nacionale për paralajmërim të hershëm dhe menaxhim të katastrofave, si dhe organizatat joqeveritare relevante.

Praktika e mirë:

Cunami i vitit 2004 ishte një shtytje për formimin e organizatës së njohur me emrin Sistemi i integruar regjional për paralajmërim të hershëm nga rreziqet e ndryshme. Ky është një sistem i centralizuar dhe shumë i zhvilluar për paralajmërim të hershëm, i cili përdoret nga 26 vende të cilat shtrihen në Oqeanin Indian.

Praktika e mirë:

Në Indonezi, qyteti Semarang (i përkrahur nga Strategjia ndërkombëtare për zvogëlimin e rreziqeve e Kombeve të Bashkuara/ DKLB), ballafaqohet me katastrofa të ndryshme si p.sh. Rritja e nivelit të ujit të detit, dallgët e larta nga plima, problemet me rrëshqitjen dhe probleme urbane. Kjo tregon se paraqitet nevoja për përcjelljen e ndjeshmërisë urbane dinamike dhe rreziqet për zhvillim të mekanizmave për paralajmërim të hershëm nga rreziqet prezente.

Leksione të mësuara:

Franca e mësuar me valën tropikale të të nxehtit, e cila e kaploi vendin në vitin 2003, tashmë ka plan të kombinuar, i cili realizohet në bashkëpunim me Entin meteorologjik të Francës, planin për gatishmëri gjatë katastrofave të Shtabit për menaxhim me kriza si dhe me Njësinë për siguri të Francës, me qëllim të përcillen tetë rreziqet e natyrës përmes përdorimit të sistemit për paralajmërim me ngjyra, me lidhje direkte deri tek mediumet, qeveritarët lokal, ndërmarrjet publike etj.

Parim udhëheqës 4:

Kyçe sistemore e ndjeshmërisë

Rreziku është funksion i përbërë nga dy elemente: mundësia për rrezik dhe ndjeshmëria. Për këtë shkak të vetëm, nëse qëllimi ynë është të zvogëlojmë ndonjë rrezik të caktuar, nuk mund të mendojmë në mënyrë të izoluar për paralajmërim të hershëm nga rreziku dhe paralajmërim të hershëm për ndjeshmëri. Rreziqet dhe ndjeshmëria duhet të zënë vend të rëndësishëm në sistemin për paralajmërim të hershëm. Historikisht, sistemi për paralajmërim të hershëm e orienton vëmendjen në monitorimin dhe paralajmërimin nga rreziqet dhe kanosja e tyre. Lënia anash e aspektit të ndjeshmërisë është dobësia e identifikuar në mbarë botën. Rezistenca njihet si aspekt pozitiv i ndjeshmërisë, prandaj përdorimi i këtij termi sistematikisht mund të zëvendësohet me ndryshimin e kuptimit të tij.

Ashtu siç munden Kryqi i kuq / Gjysmëhëna e kuqe dhe sektori joqeveritar t'i përkrahin qeveritë në aspekt të mirëkuptimit, përcjelljes, përgatitjes së përgjigjes dhe paralajmërimit në rast rreziqesh, ato njëkohësisht mund ta bëjnë të njëjtën gjë në aspekt të sigurimit të përkrahjes për zvogëlimin e ndjeshmërisë së popullatës. Në mënyrë thujtëse të njëjtë zgjidhen indikatorët për përcjelljen e niveleve të ndjeshmërisë, si. p.sh. nivele të të ardhurave ose nivele të varfërisë, të cilat e prezantojnë gjendjen e pronësisë dhe burimet e ndryshme me të cilat disponojnë njerëzit në bashkësitë për rehabilitim nga ndonjë ngjarje e caktuar emergjente.

Rreziqet dhe gjendja e ndjeshmërisë tek njerëzit ndryshon me kalimin e kohës dhe ndikojnë në sfera të ndryshme të familjeve, në mënyra të ndryshme. Rreziqet ndodhin dhe kalojnë- jo të gjitha kanë datë të caktuar fillestare apo përfundimtare, të cilat caktohen lehtë (si p.sh. gjatë thatësirës). Ngjashëm me këtë, gjendja e ndjeshme gjithashtu ndryshon gjatë vitit. Shembull, shumë bashkësi në Afrikë ballafaqohen me “sezone gjatë vitit kur mungon ushqimi”, kur deri te qasja në ushqim ndikon mungesa e prodhimtarisë dhe fuqisë blerëse. Mirëpo, madje edhe në këtë sezonë ka familje të cilat kanë burime të ndryshme të të ardhurave (si p.sh. nga bagëtia), të cilët i bëjnë të rezistueshëm dhe i mundësojnë lehtëzi të mëkëmben nga rreziku i drejtpërdrejtë. Rreziqet dhe situatat e ndryshme duhet bashkërisht të vlerësohen, me qëllim që të përcillen

rreziqet. Familjet të cilat janë më shumë të ekspozuara rreziqeve dhe ballafaqohen me nivelin më të lartë të ndjeshmërisë, në kushte normale duhet të kenë nevojë më të madhe nga paralajmërimi i hershëm. Ashtu siç është me rëndësi që me kohë të paralajmërohet bashkësia e pasur (më pak e ndjeshme e cila gjendet afër ciklonit), njësoj është e rëndësishme të vëzhgohet situata në bashkësitë e varfëra kronike, ku situata dhe burimet janë të këqija madje edhe pa ndonjë rrezik të drejtpërdrejtë të jashtëm. Përfshirja sistemore e ndjeshmërisë mund të kontribuojë që sistemi për paralajmërim të hershëm të aktivizohet madje edhe vetëm si rezultat i ndjeshmërisë, pa prezencën e ndonjë rreziku të drejtpërdrejtë.

Praktikë e mirë:

Aktivitetet e Save the Children nga Britania e Madhe në Rogot të Afrikës, treguan se sistemi për paralajmërim të hershëm siguron informata të pasura për bashkësitë e barinjve, me të cilat ata kanë qasje sistemore për bagëtinë, duke i marrë parasysh rreziqet dhe katastrofat e drejtpërdrejta. Rezultatet treguan se monitorimi i ndjeshmërisë bashkë me përcjelljen e rreziqeve fizike, e përmirëson diturinë për mbrojtje në bashkësitë e ekspozuara në rreziqe.

Praktikë e mirë:

Nga vala e të nxehtit më vitin 2003, Sektori civil, përfshirë edhe Kryqin e Kuq, bashkëpunojnë me seksionin francez për siguri në përgatitjen e planit të ri veror për ballafaqimin me valën e të nxehtit, me të cilin do të mund të përcillet ndjeshmëria dhe do të zbatohen vizita ditore atyreve të cilët janë më të rrezikuar gjatë temperaturave ekstreme. Vizitorët dërgojnë ushqim/pije dhe ju ndihmojnë njerëzve të bëjnë dush, të konsumojnë ushqim etj.

Praktikë e mirë:

Në Ugandë, Agjencia për bashkëpunim dhe zhvillim teknik e udhëheq Projektin për vlerësim të shpejtë të ndjeshmërisë së bashkësive. Ky është projekt për paralajmërim të hershëm, i cili bazohet në sms mesazhet me të cilat përcillen dhe caktohen trendet më kritike në krahinat Amuru dhe Pader. Sistemi mbledh informata vijuese për ndjeshmëri në jetën e përditshme të bashkësive, me ç'rast alarmohen zyrtarët në rajon në qoftë se ekziston ndonjë nevojë emergjente. Treguesit e përcjellur kanë të bëjnë me nivelin e lartë të të reshurave të shiut, dëshmitë për prezencën e pandemisë, dukurisë së sëmundjeve ngjithëse me formë më të vogël te popullata e ndjeshme (fëmijë etj).

Praktikë e mirë:

Politika lidhur me thatësitat në Brazilin Verilindor (shtetin Ceara) kontriboi për kapërcimin e mungesave të ujit, por nuk ishte efektive sa i përket zvogëlimit të ndjeshmërisë afatgjate të popullatës. Megjithatë, përpjekjet në Ceara kontribuan për zbutjen e pasojave nga thatësia, nëpërmjet sigurimit të pronës së bujqëve,

ndërtimit të rezervoareve për ujë dhe ndërtimit të pendave për ruajtjen e nivelit të ujit gjatë sezonit të shiut.

Nga viti 2000, ndikimi i personave të ndjeshëm të përjashtuar rezultoi me mosfunksionimin e sistemeve për paralajmërim të hershëm gjë që më pastaj rezultoi me iniciimin e diskutimeve dhe debateve të shumta shkencore. Përvojat e pasqyruara më poshtë, e hapën rrugën për mësim nga aspekti se sistemet për paralajmërim të hershëm duhet ta kenë parasysh edhe aspektin e ndjeshmërisë, si karakteristikë e sistemit për paralajmërim të hershëm i cili mund të identifikohet me rrezikun.

Leksion i mësuar:

Gjatë verës së vitit 2003, Evropën Perëndimore e kaploi vapë e madhe. Edhe pse vazhdimisht jepeshin paralajmërimet nëpërmjet numrit të madh të kanaleve komunikuese, mungesa e shqyrtimit me kujdes të treguesve të ndjeshmërisë (mosha, izolimi et.) rezultoi me mbi 15.000 të vdekur për më pak se dy javë. Shumica prej tyre ishin pleq, persona të izoluar apo persona të cilët nuk kishin marrë paralajmërim.

Leksion i mësuar:

Krizja e ushqimit në Nigeri më vitin 2004 dhe 2005 ishte e vështirë. Ajo u shkaktua nga ndërprerja e hershme e të reshurave më vitin 2004, që solli dëme të mëdha të kullosave dhe të mbjellurave, çmim të lartë të ushqimit dhe varfëri kronike. Reagimi i vonuar lidhur me paralajmërimin e hershëm në Nigeri tregoi se ushqimi në kohë të krizës është ngushtë e lidhur me varfërinë he gjendjen e shërbimeve publike në shtet- me rreziqet natyrore si faktor i rëndësishëm. Ashtu siç shkroi Eilerts (2006): “sfida më e drejtpërdrejtë qëndron në të pranuarit se nuk mundemi më ti kufizojmë monitorimin dhe analizën kryekëput të “ushqimit të sigurt” dhe krizën që ka të bëjë me ushqimin. Situatat emergjente të formave të ndryshme, në shumë vende të ndryshme, do të jenë shkas për shumë kriza të ardhshme me ushqim apo uri të popullatës. Në të vërtetë, identifikimi që nuk duhet të përcillet do të jetë njëra nga detyrat tona më të rënda”.

Leksion i mësuar:

Në Mongoli ndodhën një varg thatësira intensive në periudhën ndërmjet viteve 1999-2002 dhe sërish në periudhën 2004-2005. Kur më vitin 2009 sërish mbretëroi verë e thatë, në vend u paraqit frika se dimri i fortë sërish do ta zvogëlojë numrin e krerëve të bagëtisë. Zyra rajonale e Kryqit të Kuq i konsultoi të dhënat nga prognozatat rajonale dhe krahas shanseve 20 % për temperatura më të freskëta nga ato mesatare, dimri 2009-2010 rezultoi me rënien e ashpër të papritur të temperaturave në kontinuitet, me të reshura të vazhdueshme të borës. Si rezultat i kësaj ngordhën mijëra krerë kafshë, me ç'rast pronarët e tyre mbetën pa burim ekzistence dhe deri në maj të vitit 2010, 2/3 e këtij rajoni u gjend në gjendje të jashtëzakonshme. Edhe pse Kryqi i Kuq me vëmendje e ndjekte situatën, nuk kishte metodë sistimore për përcjelljen e ndjeshmërisë në suazat e sistemit për paralajmërim të hershëm. Sikur të ekzistonin të paktën

disa tregues për nivelin e rritur të ndjeshmërisë, ndoshta do të mund të sigurohej DREF alokacion dhe do të shpëtonin shumë jetë.

Parimi udhëheqës 5:

Disenjim i komponentëve për paralajmërim të hershëm me më shumë funksione

Duke pasur parasysh se katastrofat nuk janë çdoherë preokupim primar i bashkësive të ekspozuara në rreziqe, arsyeshmëria e sistemeve për paralajmërim të hershëm varet nga komponentët e propozuar të sistemeve të cilat kanë qëllime shumëfish të dedikuara në kuadër të një bashkësie të caktuar. Në botë, subjektet të cilat janë përgjegjës për uljen e rreziqeve nga katastrofat, rregullisht janë të befashuar nga prioritetet e bashkësive të ekspozuara në rreziqe të cilat i përkrahin.

Në vend që theksi të jetë në cunamit e rrezikshëm apo vërshimet periodike të cilat marrin rreth pesë jetë çdo vjet, bashkësitë e ndjeshme në vendet në zhvillim vëmendje më të madhe i kushtojnë ekzistencës së përditshme, sigurimit të ushqimit dhe përmbushjes së nevojave primare dhe socio-kulturore (shpenzimet për shkollë, për mjekim, ujë, pagëzime, ose nevoja tjera) të cilat duhet ti mbulojnë mbi baza mujore. Për këtë arsye është me rëndësi të madhe që përpjekjet të përqëndrohen në sferën e paralajmërimit të hershëm dhe t'i kenë parasysh përparësitë dhe nevojat e bashkësive lokale.

Ka dy teknika të ndryshme që mund të shfrytëzohen për shqyrtimin e çështjeve lidhur me paralajmërimin e hershëm dhe nevojat e përditshme të popullatës: aktivitete për akumulimin e të ardhurave dhe pajisjes me dedikim të madh; vjon pasqyrimi i dy çështjeve të lartpërmendura :

- zhvillimi i aktiviteteve për akumulimin e të ardhurave mund drejtpërdrejtë të lidhet me sistemin për paralajmërim të hershëm. Është e përcaktuar se kur organizohet një aktivitet i caktuar për sigurimin e mjeteve financiare nga ana e vullnetarëve ose anëtarëve të bashkësisë e ekspozuar në rreziqe, ata duhet të kenë mundësi të rezervojnë një pjesë të parave për të financuar aktivitete lidhur me paralajmërimin e hershëm, ndër të tjerash duke e ndarë pjesën më të madhe të mjeteve për t'i kënaqur nevojat lokale në mënyrë të cilën ata e përcaktojnë.
- Cilado pjesë e sistemit për paralajmërim të hershëm, i cili i shtohet procesit në secilin nivel (veçanërisht në nivel të bashkësisë), duhet të plotësojë më shumë se një qëllim. Këtu mund të kyçet aparaturë për komunikim e cila përveç përdorimit për paralajmërim të hershëm do të shfrytëzohet edhe për thirrjen e mbledhjeve, për evakuim ,për nevoja shkollore ose për rituale fetare. Multifunksionalitetit nuk duhet çdoherë të praktikohet. Ndërlidhja e funksioneve për paralajmërim me sistemet që shërbejnë për nevoja shkencore ose nevoja të tjera, mund ta ketë efektin e njejtë.

Praktikë e mirë:

Organizata për bashkëpunim ndërkombëtar e Malavit dhe Kryqi i Kuq organizojnë sistem të përbashkët për paralajmërim të hershëm në bashkësi për mbrojtje nga vërshimet. Krahas sigurimit të mjeteve financiare për nevoja ditore, sigurohen dhe mjete për të matur nivelin e ujit në lumë si dhe mjete për shpenzime telefonike dhe vizita studimore të bashkësive të tjera gjatë rrjedhës së lumit.

Praktikë e mirë:

Në Amerikën Qendrore përdorimi i radio sistemeve incialisht ishte bërë që të jepet paralajmërim për rreziqet nga vërshimet. Sot ato përdoren për funksione komunikative. Radiot shfrytëzohen dhe paraqesin pjesë integruese në bashkësitë. Si rezultat i kësaj ata mirë ruhen dhe janë në dispozicion kur është e nevojshme të jepet paralajmërimi. Edhe atëherë kur paralajmërimi jepet për raste të rralla, aparatura ruhet, sepse paraqet pjesë të përditshmërisë së bashkësisë.

Praktikë e mirë:

Në Mozambik dhe Madagaskar, Zyra humanitare e Komisionit Evropian (ECHO) financoi sistem për paralajmërim të hershëm, i cili është ngushtë i lidhur me strehimoret që mbrojnë nga ciklonet. Kur nuk është sezoni i cikloneve, strehimoret përdoren si kisha ose shkolla dhe njësitë administrative kujdesen për mirëmbajtjen e tyre me qëllim të mund të përdoren gjatë sezonit të cikloneve.

Leksione të mësuara:

Në Hazinfo (Shri Lankë) proekti, me të cilin sigurohet aparaturë (telefona mobil) për paralajmërim të hershëm të bashkësive, u konstatua se aparatura është lënë pas dore dhe është përdorur për qëllime tjera pasi financimi i projektit dhe trajnimi kanë përfunduar. Kjo është si rezultat i asaj se nuk është koncipuar si duhet përdorimi multifunksional i aparaturës; nevojat e bashkësisë është dashur më thellë të analizohen, por për fat të keq këtë nuk e ka lejuar koha.

Parimi udhëheqës 6:

Integrimi i më shumë kornizave kohore

Me qëllim të shfrytëzimit të përparësisë në periudha më të gjata kohore, të cilat janë të kapshme për përgatitjen dhe menaxhimin e sfidave lidhur me

ndryshimet klimatike dhe gjendje të ndjeshme, është e dobishme të inkorporohen korniza të ndryshme kohore për sigurimin e informatave për paralajmërim të hershëm në sistemin për paralajmërim të hershëm.

Që të jetë përgjigja relevante, gjatë shfrytëzimit të informatave relevante me rëndësi është të kuptohet se tërësia e planifikuar e aktiviteteve, e cila planifikohet në nivel lokal para fillimit të ngjarjes ekstreme, mund të jetë e ndryshme nga seti i aksioneve të planifikuara shumë më herët, për shembull kur prognozat sezonale parashohin rrezik të rritur nga vërshimet për sezonin e ardhshëm me të reshura shiu. Kjo ndodh si rezultat i asaj se sa më herët në pikëpamje kohore të jepet prognoza për motin, është aq më e pasigurt dhe përmban dukshëm më pak informata. Pikërisht për këtë, lloje të ndryshme informatash do të jenë të përshtatshme për periudha të ndryshme kohore të parashikimeve dhe prognozave.

Kryqi i kuq/Gjysmëhëna e kuqe ka përgatitur mekanizëm (i quajtur Përgjigje në korniza të ndryshme kohore) i cili ju ndihmon personave përgjegjës që punojnë në fushën e uljes së rreziqeve nga katastrofat (apo më saktë, në fushën e paralajmërimit të hershëm) në nivel nacional apo lokal të kërkojnë përgjigje përkatëse në prag të ndonjë rreziku të caktuar, i cili duhet të ndodhë në afate të ndryshme kohore (minuta, ditë, muaj, sezona, vite). Kjo qasje është sqaruar në shumë detaje në kapitulin vijues.

Si menaxhues i rreziqeve nga katastrofat, duhet ta planifikoni skenarin e mundshëm më të keq. Ciceroni më i thjeshtë është pasqyruar në tabelën 6, ku janë shfaqur skenaret më të këqija të mundshme, dhe ku koha për paralajmërim mundet apo nuk mundet të jetë më herët se ajo. Rreziqet e prezentuara në anën e majtë të tabelës, zakonisht kanë paralajmërim me periudha të shkurtra kohore, sesa rreziqet e prezentuara në anën e djathtë të tabelës. Te tërmetet teknologjia momentale po përmirësohet dhe janë të mundshëm paralajmërim pas paraqitjes së sinjaleve të para për p-valë, me çka sigurohet paralajmërim në kohë reale, apo mundësi për reagim vetëm në periudhë prej disa sekondash; sa më larg që të jetë amvisëria nga zona reale, aq më shumë kohë ka të përgatitet dhe reagojë ndaj situatës emergjente.

Prognoza lidhur me vërshimet, gjithashtu, e përmirëson edhe periudhën e besueshme për paralajmërim, e cila sillet deri shtatë ditë përpara ngjarjes. Edhe pse paralajmërimet për thatësitat janë të kapshme disa javë para fillimit të të njëjtave (kolona e mesme), prognozat sezonale për thatësitat tani sigurojnë mundësi më të mëdha për marrjen e masave përgatitore. Për të gjitha rreziqet apo kanosjet, masat për paralajmërim çdoherë janë me rëndësi esenciale, pa dallim të periudhës kohore të ngjarjes.

Tabela 6: Skenare të gjeneralizuara “më të këqija të mundshme” për caktimin e afateve për paralajmërim të hershëm

Koha reale	Prognozë afatshkurtër	Prognozë afatmesme	Prognozë afatgjatëgjate
sekonda-minuta	orë-ditë	javë-muaj-sezona	vite apo më shumë

tërmete	stuhi	thatësira	ngritja e nivelit detar
kanosje për industrinë	zjarre pyjesh	temperatura ekstreme	degradim i pyjeve
Vorbull pluhuri	ciklone tropike	konflikte	shkretim i tokës
tornado	rrëshqitje e tokës		thatësi
vërshime	vërshime		të reshura ekstreme
	cunami		degradim i tokës
	vullkane		ndotje e ambientit jetësor
	valë të nxehta		
	epidemi		

Praktikë e mirë:

Kërkimet në periudhën nga viti 2000-2004, të zbatuara nga ADPC/USAID kontribuan për vazhdimin e afatit të sistemeve për prognozë dhe parashikim të hershëm gjatë vërshimeve prej 72 orë në 10 ditë. Gjatë periudhës 2006-2009, KEAP Bangladesh, nëpërmjet USAID-it përkrahi program për testim dhe transfer të kësaj teknologjie të autoriteteve të Bangladeshit. Qëllimi kryesor i modelit është përsosje e kapaciteteve për gjenerimin dhe zbatimin e qëndrueshëm të metodave për prognozë afatgjate, me shfrytëzimin e tri skemave për prognozë: prognozë aftgjate (1-10 ditë), afatshkurtër (20-25) dhe prognozë afatgjate (1-6 muaj). Prognoza afatshkurtër (1-10 dite) u tregua si jashtëzakonisht e mirë gjatë prognozës së vërshimeve në vitin 2008.

Praktikë e mirë:

(U fshi- mungon teksti në këtë pjesë) ????

Parime udhëheqëse 7:

Inkorporim i sitemeve të ndryshme të diturisë

Ashtu siç është e rëndësishme shkenca për dërgimin e mesazheve për paralajmërim të hershëm, në këtë drejtim janë të rëndësishme edhe sisteme dhe burime tjera të ndryshme të diturisë, me qëllim të rumbullakimit të plotë të pasqyrës për sistemet për paralajmërim të hershëm.

Pikërisht për këtë, sistemet më të mira për paralajmërim të hershëm duhet t'i shfrytëzojnë të gjitha sistemet e ndryshme të diturisë, me qëllim të maksimalizimit të efekteve nga aktivitetet për paralajmërim të hershëm të popullatës dhe shpëtimin sa të jetë e mundur të më shumë njerëzve.

Në literaturë, lidhur me këtë temë, përgithësisht flitet për tre sisteme diturish: dituri të bartura, dituri të fituara nga përvojat dhe diturit paraprake nga njohuritë empirike. Derisa individë dhe familje, në të vërtetë, i posedojnë dy burimet e para të diturive (shpeshherë të quajtura dituri të natyrshme, lokale ose

folklorike/popullore), dituritë empirike përgjithësisht janë të rezervuara për shkencën.

- **Dituri të bartura**, janë dituritë të cilat barten te individi nëpërmjet cilësdo formë të komunikimit dhe janë regjistruar në gojëdhënat popullore apo kujtimet e njerëzve: përralla, këngë, biseda e tj., thellësisht të rrënjësura në gjeneratat e njerëzve dhe legjitimiteti i këtyre diturive rrallherë mohohet apo debatohet nga ana e bashkësisë.
- **Dituri të fituara nga përvojat**, janë ato dituri të cilat janë fituar nga ekspozimi personal në ndonjë veprim ose përvojë personale, sepse zakonisht nuk diskutohet, kurse shpesh as nuk regjistrohet si dukuri. Ky lloj i diturive shpeshherë mohohet dhe kategorizohet si dituri joshkencore.
- **Dituri empirike**, janë dituri “të krijuara” si rezultat i dëshmimeve të fituara gjatë eksperimenteve shkencore apo përcjelljes së situatave të caktuara.
- Shembuj për rëndësinë e çdonjërit nga këto dituri, janë prezentuar në Tabelën 7.

Traditat gjuhësore shpeshherë janë komponent i rëndësishëm i bartjes së diturive nga njëri te tjetri. Tendenca të kuptohen cilësitë unike të gjuhës, shpeshherë na mundësojnë të vijmë në të dhëna fascinuese për shfrytëzuesit, që mund të japë kontribut të rëndësishëm në forcimin e sistemeve për paralajmërim të hershëm.

Praktikë e mirë:

Një nga hapat më praktikë të Kryqit të kuq të Samoa-s, është ai që mundësoi të kapërcehen barrierat gjuhësore. Pothuajse çdo fshat në Samoa ka terme të ndryshme për veri, jug, lindje apo perëndim, që paraqet problem në interpretimin e informatave për paralajmërim të hershëm. Për kapërcimin e këtij problemi, shoqata nacionale shërben si lidhje ndërmjet bashkësive dhe teknikëve, të cilët ndihmojnë në interpretimin e informatave dhe paralajmërimeve meteorologjike lidhur me situatën meteorologjike. Është vështirë të gjendet shembull më i mirë se si Kryqi i kuq mund t'u ndihmojë bashkësive që në mënyrë më të lirë dhe krejtësisht falas të përgatiten më mirë për t'ju përgjigjur rrezeve.

Praktikë e mirë:

Një nga sfidat më të mëdha të prognozës për lumenjtë në Nepal është komunikimi me mesazhe me bashkësitë e largëta. Shembull për këtë është kënga e cila u shkrua në kuadër të garave për ngritjen e vetëdijes për rreze nga vërshimet. Aksioni u financua nga Organizata Aksioni praktik, e cila

shfrytëzon teknologji përkatëse për kapërcimin e varfërisë në mbarë botën. Kjo organizatë tentoi të sjellë qasje më të ndryshme, ndër të cilat edhe gara poetike, që u dëshmuar si tejet efektive dhe të popullarizuara. Kënga është përkthyer në gjuhën angleze, gjegjësisht në versionin original është kënduar në gjuhën Taru!

Vjershë për ngritjen e vetëdijes për paralajmërim të hershëm

<p>Nëse bie shumë shi në Dang Gjithandej do të përhapen lajmet për këtë</p> <p>“Paralajmërim, Paralajmërim” thotë ekipi Zgjohuni të gjithë Merrni sendet më të nevojshme Shpëtoni jetën Mënjëherë, sapo të merrni lajmin</p> <p>Merrni dokumentet Merrni stolitë Merrni gjithçka ju nevojitet</p> <p>Telefonat bien, dëgjohej tingulli i sirenave Lajmet shpejt përhapen</p> <p>Morëm lajme nga Çipengu</p>	<p>Telefonat bien, dëgjohej tingulli i sirenave Ikni në strehimore, Ikni në strehimore</p> <p>Nihmoni dhe të tjerët që të strehohen Mos i harroni personat e moshuar Mos i harroni gratë shtatzënë</p> <p>Dhe njerëzit që nuk mund të ecin Dhe njerëzit që nuk mund të flasin</p> <p>Në fund, mos e harroni askënd Sidomos personat më të ndjeshëm Shpëtoni të gjithë të cilët kërkojnë ndihmë</p> <p>Telefonat bien, dëgjohej tingulli i sirenave Lajmet shpejt përhapen</p>
---	---

Tabela 7: Shembuj të diturive për sistemin për paralajmërim të hershëm sipas llojeve të ndryshme

Forma e diturisë	Praktikë e mirë	Leksion i mësuar
Të bartura nga gjeneratat e mëparshme, nëpërmjet këngëve apo legjendave, pa pasur nevojë për ndihmë nga teknologjia bashkëkohore	<p>Shembujt në vijim janë nga cunami në Okeanin indian më vitin 2004:</p> <ul style="list-style-type: none"> Tajlandë: Për popullin nga Moken në Ishujt e Surineve, “shtatë valët e mëdha”, është legjendë e cila bartet brez pas brezi: cunamet janë me shkathtësi të enkoduara në legjendën për “balenën”, gjegjësisht për valën e madhe. Legjenda thotë se kur vala në breg papritmas thahet, duhet ikur në lartësi, për t’ju shmangur “shtatë valëve të mëdha”. Indonezi: Banorët e Ishujve të Simelisë shpëtuan nga cunamit në vitin 2004 falë reagimeve pozitive ndaj paralajmërimeve të cilat datojnë qysh para 100 vjetësh, të përmbajtura në një këngë të cilën e këndojnë të gjithë fëmijët lokalë. Indi (Ishujt Andaman dhe Nikobar): Shkencëtarët besojnë se dituritë e vjetra 	<p>Emigrantët e Simelisë dhe Ishujve të Solomonit humbën jetën sepse nuk i kishin të njëjtat njohuri si popullata lokale dhe nuk kishin mundësi t’i marrin të njëjtat mesazhe për paralajmërim si popullata tjetër.</p>

	për lëvizjen e erës, detit dhe zogjve ju kanë ndihmuar këtyre bashkësive tradicionale ta "parandjejnë" cunamin dhe të ikin në pyjet më të larta shumë më herët para se ta godasin valët bregun.	
Përvoja personale	Nepali/Dokumente për aksion praktik me tregues për paralajmërim të: rrëshqitjes së tokës, të reshurave të mëdha të shiut, vërshimeve dhe vullkaneve: <ul style="list-style-type: none"> • Pluhur i rënë në totema • Ushtëtima e arinjve dhe shqetësim të pulat • Dridhje vertikale në vend të dridhjes horizontale të tokës • Zogjtë të cilat i braktisin foletë • Të lehura të vazhdueshme dhe nuhatje në tokë e qenve • Gjarpërinjtë e detit ikin në sipërfaqe të bregut 	Kryqi i kuq i lshujve të Sollomoneve ka njohuri të dokumentuara se rënia e arrave nga drunjtë paraqet paralajmërim të priftërinjtë pagan për rrezik të drejtpërdrejtë nga stuhitë dhe moti i lig.
Përvoja (shkencore) empirike	Xhirimet satelitore gjatë 35 vjetëve të kaluara, paraqesin prognozë pothuaj të sigurt për traektoret e stuhive dhe periudhën e goditjes së tyre në rajonet bregdetare.	Edhe krahas mjeteve të larta teknologjike për paralajmërim të hershëm për cunami në Havai, në vitin 2004 pati mbi 250.000 viktima nga cunami në Oqeanin indian.

Parime udhëheqëse 8:

Marrja parasysh e rreziqeve dhe situatave ekzistuese të pasigurisë

Fatëkeqësisht, të gjitha dituritë më lart të diskutuara, fillojnë të mos funksionojnë si rezultat i presioneve gjithnjë e më të mëdha globale. Së pari, globalizimi dhe zhvillimi global rezultuan me mirëqenie të ndryshueshme pronësore dhe komunikim të zvogëluar ndërmjet gjeneratave, kështu që mund të thuhet se sistemi i transmetimit të mesazheve nga e kaluara tashmë nuk konsiderohet si relevant apo prioritar për gjeneratën e re. Edhe pse teknologjia telekomunikimet mundësojnë qasje deri te burimet e pakufizuara informatash nëpërmjet internetit dhe mediat sociale, këto dituri mundet edhe më shumë t'i largojnë prej nesh dituritë nga e kaluara. Së dyti, nxemja e atmosferës është rezultat i ndryshimeve klimatike dhe ndikimi i kësaj fillon të ndihet te treguesit më lart të caktuar për paralajmërim - disa prej tyre tashmë nuk janë relevant dhe të sigurt. Këto dy elemente kanë rol të konsiderueshëm për sistemet për paralajmërim të hershëm. Sot, madje edhe për synimet shkencore, e kaluara nuk është tregues apo matës i sigurt për situata të ardhshme, bazat për këtë gjeneratë janë të humbura.

Krahas kësaj, ndryshimet klimatike⁴ gjithnjë e më shumë ndikojnë në situatat e ndjeshme të njerëzve dhe rezultojnë me dukurinë e rreziqeve edhe në ato rajone të botës, të cilat më herët nuk kanë qenë lëndë e rreziqeve të këtilla (për shembull, vërshime në krahina, ku sipas traditës mbretërojnë thatësira). Për këtë arsye, mund të konkludohet se gjeografia dhe kalendari i rreziqeve dukshëm evoulojnë. Përveç kësaj, jemi dëshmitarë edhe të një ndryshimi, e ky është paraqitja e rreziqeve si rezultat i rrethanave ekstreme kohore: Krahinat të të cilat mbretëron zakonisht lagështia, janë edhe më të rëndësishme, krahinat ku mbretëron thatësia kronike, ballafaqohen me thatësi edhe më të gjata. Rritja e temperaturave mund ta ndryshojë gjerësinë gjeografike të disa bartësve të sëmundjeve, si për shembull mushkojat apo dëmtuesit tjerë, të cilët mund t'i sulmojnë bashkësitë e përqëndruara në lartësi mbidetare, të cilat më herët konsideroheshin si të sigurt dhe të mbrojtura. Këto trende të reja, paralajmërimin e hershëm e bëjnë edhe më të rëndësishëm gjithashtu edhe në krahina ku paraprakisht nuk konsideroheshin të rrezikshme.

Urbanizimi i shpejtë dhe i paplanifikuar, gjithashtu shkakton rreziqe të reja, ekspozim më të madh dhe ndjeshmëri të rritur. Rritja e numrit të banorëve me shtëpi të vendosura në bregdet apo në luginat e lumenjve, do të thotë më shumë njerëz të ekspozuar në vërshime dhe rreziqe nga deti (uragane, cunami, rritje të nivelit të deteve e tj.). Dendësia e shtuar e popullatës në parajet urbane, gjithashtu ka implikime ndaj ndjeshmërisë, varfërisë dhe përhapjes së rritur të sëmundjeve. Ndryshimet klimatike, gjithashtu e rrisin presionin lidhur me sfidat që kanë të bëjnë me menaxhimin e rreziqeve nga katastrofat në mjediset urbane, sepse rreziqet rurale dhe katastrofat i detyrojnë familjet të kërkojnë punësim apo ndihmë në lagjet urbane. Përqëndrimi më i madh i njerëzve në zonat e ekspozuara në katastrofa (shtimi i popullatës në qytete të mëdha në rajonet sizmike), do të thotë rrezik më i madh dhe disa bashkësi rurale po ndërtohen në lokacione shumë të rrezikshme.

Ndikimi i shumë proceseve të ndryshme (për shembull shtimi i popullatës, zhvillimi i paqëndrueshëm, urbanizimi i shpejtë i paplanifikuar, ndryshimet klimatike, degradimi i ambientit jetësor, ndryshimet lokale në treg dhe në udhëheqje) dukshëm kontribuojnë për rritjen e ndjeshmërisë së njerëzve dhe zvogëlimin e kapacitetit të tyre që t'i përballojnë apo të mëkëmben nga rreziqet dhe kanosjet. Bashkë me numrin gjithnjë e më të madh të rreziqeve, gjithmonë është e pranishme edhe pasiguria. Normat joadekuate të plotësuara me interaksionin kompleks të ndryshimeve klimatike dhe sistemeve kohore, rezultojnë me prognozë të pasigurt të motit, që lë hapësirë për gabime më të mëdha dhe interpretim më të vështirë të paralajmërimeve. Bashkësitë duhet t'i kuptojnë vështirësitë në sigurimin e prognozave të sakaa dhe uljen e rreziqeve nga katastrofat, kurse praktikienëve për menaxhimin e katastrofave ju nevojitet ndihmë teknike për interpretimin dhe veprimin e prognozave të jashtme dhe atyre të cilat shkaktohen si rezultat i monitorimit që zbatohet në bashkësi. Madje,

⁴ Për më shumë detaje për ndryshimet klimatike, mund të informoheni nga raporti i IPCC SREX report (menaxhim i rreziqeve gjatë ngjarjeve dhe katastrofave ekstreme si rezultat i ndryshimeve klimatike-[http:// ipcc-wg2.gov/SREX/](http://ipcc-wg2.gov/SREX/)) dhe raportit rajonal për leksione të mësuara nga SREX i kapshëm në: <http://cdkn.org/2012/04/new-cdkn-reports-willhelp-developing-countriesplan-for-climateextremes/>).

edhe me ndihmë teknike, prakticienëve ju nevojitet set i mekanizmave me të cilat do të kenë mundësi të ballafaqohen me çfarëdolloj befasie.

Dituritë momentale për ndryshimet klimatike tanime sinjalizojne për paralajmërim të hershëm, të cilat inponojnë aksion urgjent. Faktorët të cilët punojnë në sferën e uljes/menaxhimit të rreziqeve nga katastrofat duhet ta inkorporojnë aspektin e ndryshimeve klimatike në sistemin për paralajmërim të hershëm. Për shembull, duhet të sqarohet, të komunikohet dhe të jemi të gatshëm për keqësimin e ballafaqimeve me rreziqe vijuese dhe të reja. Prakticienët duhet ta kuptojnë se si mund të ndryshojë gjeografia e rreziqeve, që të kuptohet situata momentale dhe të parashikohen ndryshime në planin e ballafaqimit me situata emergjente. Tanimë mbi 60 vende kanë zbatuar vlerësimin nacional, në suaza të të cilit shqyrtohen planet nacionale, pergjigja me rastin e katastrofave dhe shqyrtimi i rrethanave të ndryshuara kohore, me qëllim që të bëhen ndryshime në fushën e paralajmërimit të hershëm.

Praktikë e mire:

Seminaret e Qendrës ndërkombëtare për zhvillim të integruar malor për paralajmërim të hershëm në Pakistan, treguan se sistemet për paralajmërim të hershëm pothuasje janë harruar. Në male, sistemet tradicionale për paralajmërim funksionojnë me ndihmë e sinjalizimit nëpërmjet pasqyrave dhe zjarrit, në saje të strategjive të ndryshme të lidhura me aktivitete ushtarake, fetare dhe bujqësore. Një nga përparësitë ishte se shfrytëzimi i mjeteve vizuale (sistemi i pasqyrave dhe zjarrit) dhe audio (xhamive dhe nomadeve) për komunikim i mundësuan sistemit të jetë mjaft fleksibil për t'u përshtatur konteksteve të ndryshme. Zhdukja e nomadëve nga rajoni Çitrall tregon se po ndodhin ndryshime në lidhjet midis viseve malore dhe rrafshinore, midis kulllosave dhe fshatrave, midis gjeneratave të vjetra dhe të reja dhe midis sistemeve tradicionale dhe të reja për paralajmërim të hershëm nga rreziqet natyrore."Sistemi i vjetër ngeli në të kaluarën, kurse i riu nuk funksionon", është konkludimi i pjesëmarrësve në seminar.

Praktikë e mire:

Kryqi i kuq i Australisë dhe Kryqi i kuq i Ishujve të Sollomonit kanë integruar pjesë nga ndryshimet klimatike në doracakun e tyre për preventivë shëndetësore, me qëllim që prakticienët në fushën e veprimtarisë preventive shëndetësore të njihen mirë me lidhshmëritë ndërmjet ndryshimeve klimatike, rreziqeve të shtuara nga katastrofat dhe rritjen e situatave potenciale publike shëndetësore emergjente si rezultat i ndryshimit të skemave që ndodhin lidhur me sëmundjet.

Praktikë e mire:

Përsosja e kapaciteteve për përshtatje ndryshimeve klimatike, e koordinuar nga Instituti për stërvitje dhe kërkime të Kombeve të Bashkuara, është projekt i cili zbatohet në Kenia dhe Mali, dhe i cili e studion ndryshimet klimatike. Në Mali, informatat shkencore për ndryshimet klimatike “përkthehen” me mjete të kuptueshme dhe të kapshme vizuale dhe diseminohe në formë të shfaqjeve dhe muzikes teatrore në gjuhë lokale. Në Malavi ky projekt zbatohet në bashkëpunim me Kryqin e kuq.

Praktike e mirë:

Në Mozambik punohet në forcimin e rezistencës së bashkësive, me theks mbi ndryshimet klimatike. Aktivitetet përbëhen nga caktimi nëpërmjet hartave të ndryshme nga vërshimet në luginën e lumit Zambezi, me ç'rast evolon lidhshmëria me ndryshimet klimatike dhe forcimi i gatishmërisë para se të ndodhë rreziku.

Praktikë e mirë:

Në Çoko të Kolumbias implementohet projekti 18 muajsh për gatishmëri me rastin e katastrofave, dedikuar për 10 bashkësi. Projekti e përfshin edhe dukurinë klimatike “La Nina”, si shkak të teçës reshurave të mëdha në Kolumbia. Në suazat e projektit u instalua pajisje, si për shembull sinjalizim me flamuj, sirena dhe aparaturë për matjen e nivelit të ujit në lokacione të caktuara, me qëllim të krijimit të sistemit për paralajmërim të hershëm, i cili është në përputhje me rregullat dhe rregullativat që mundësojnë integrim në sistemet ekzistuese.

Praktikë e mirë:

Seminari dyditor i organizuar nga Kryqi i kuq i Fixhi në Fuzou, si pjesë e projektit “zvogëlimi i rreziqeve nga katastrofat dhe adaptim i integruar drejtë ndryshimeve klimatike-Kontekst model nacional në bashkësi në Republikën Popullore të Kinës, me mjete financiare të siguruar nga Kryqi i kuq finlandez. Me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të ndryshëm të institucioneve qeveritare midis të cilave nga sfera e bujqësisë, ndryshimeve klimatike dhe menaxhimit të katastrofave si dhe Entin për meteorologji dhe Kryqin e kuq të Kinës, debatohet lidhur me përballjen me ndryshimet klimatike. Shfrytëzimi i modelit të paralajmërimit të hershëm/aksionit të hershëm u shfrytëzua për ushtrimin e skenarit të reshjeve të mëdha të shiut dhe rrëshqitje të tokës. Pjesëmarrësit diskutuan për aksione të cilat mund të ndërmerren në periudha të ndryshme kohore gjatë vitit, para se të ndodhë një ngjarje e caktuar, nëpërmjet shfrytëzimit të informatave të kapshme për situatat klimatike. Pjesëmarrësit zhvilluan diskutime për instalimin e sistemeve, përkrahje profesionale dhe aksione të cilat tashmë janë të kapshme për ballafaqimin me ndryshimet

klimatike si dhe propozime lidhur me punë që mund të bëhen më mirë dhe më ndryshe.

Leksione të mësuara:

Njerëzit të cilët jetojnë në ishujt artificial në provincën Malaita, në Ishujt e Solomoneve, e panë se erërat e ndryshueshme ndikojnë dukshëm në metodat tradicionale për prognozë të motit. Ishujt e Solomoneve kanë të dhëna të kufizuara meteorologjike, ngase pjesa më e madhe e të dhënave janë shkatërruar gjatë trazirave civile në Ishujt e Solomoneve. Me qëllim të kompensimit të kësaj të mete, shfrytëzohet dituria tradicionale, respektivisht dituria e pleqve, me qëllim të bëhet vlerësimi i efekteve nga ndryshimet klimatike në vend.

Kryqi i kuq i Ishujve të Solomoneve ka të dhëna se fiset në perëndim të vendit kanë njohuri të mëdha për bimët, mbjelljen dhe sjelljen dhe aklimatizimin e tyre me erërat. Në të kaluarën, arritja dhe zgjatja e erërave të rrezikshëm ka mundur të parashikohet sipas periudhës së rritjes dhe rënies së disa fruteve të mbështjellura bërthamore të drunjve. Priftërinjtë paganë, të cilët i posedojnë këto njohuri, tani kanë vështirësi të parashohin se kur mund të vijnë këto erëra dhe sa do të zgjasin (Kryqi i kuq i Ishujve Solomone, viti 2008).

Parimi udhëheqës 9:

Sistem për paralajmërim të hershëm pa kufij: përfshirje e plotë e situatava të ndjeshme dhe e rreziqeve

Rreziqet dhe karastrofat nuk njohin kufinj: ato nuk njohin kufizime administrative, kulturore apo linguistike; ato nuk bëjnë dallim ndërmjet zonave apo kampeve kryengritëse për persona të zhvendosur. Praktikienët për uljen/menaxhimin e rreziqeve nga katastrofat, duhet t'i trajtojnë njësoj si rreziqe dhe ta kenë parasysh tërë potencialin dhe gjerësinë e rrezikut pa marrë parasysh kifijtë e parapara dhe të caktuara sociale.

Në rastet kur ka shumë ujë-vërshime, është e dobishme që çështja e paralajmërimit të hershëm të ndërlidhet me zonën lumore dhe zonën konkrete. Zona lumore përfshin tërë zonën e cila furnizohet ose liron derdhjen e ujërave nga një sistem lumor. Baskësite e përqëndruara në rrjedhën e epërme të zonës lumore, shpeshherë së pari te ato ka të reshura shiu, mund të mos jenë të goditura ose të jenë fare pak të goditura me vërshime, sesa bashkësitë e përqëndruara përgjatë lumit.

Për këtë arsye, rol i rëndësishëm i kushtohet sferës së monitorimit dhe alarmimit të fqinjve të vendosur përgjatë lumit. Zhvillimi i raporteve të mira mes bashkësive përgjatë rrjedhës së lumit, në raport me masat për paralajmërim të

hershëm, e forcon mirëkuptimin dhe kontribuon në masë të madhe për shpëtimin e jetës së njerëzve. Qasja për vendosjen e sistemit efikas për paralajmërim të hershëm, është ngushtë e lidhur me menaxhimin e pendave të mëdha dhe shtratit lumor.

Në rast mungese të ujit- thatësisë, bashkësitë e goditura, të cilat janë të larguara nga njëra-tjetra, mund të këmbëjnë strategji se si t'i përgjigjen prognozave sezonale. Është mjaft e dobishme të bashkohen familje të kategorive të ndryshme në zinxhirin e ushqimit- ata të cilët prodhojnë, shesin dhe/ose varësisht nga nevojat e tregut- hulumtime të formave të ndryshme të informatave të kapshme dhe mundësive për përgjigje formave të ndryshme të rreziqeve.

Përpjekjet e këtilla mund të kontribuojnë për mirëkuptim më të gjërë të bashkësive dhe si janë të lidhura aksionet e tyre reciproke me aksionet e faktorëve dhe subjekteve tjerë. Në të dy rastet, rreziqet dhe katastrofat i kapërcejnë kufijtë nacional. Përgjithësisht, është e dobishme të hulumtohen sistemet tejkufitare dhe tejrajonale për paralajmërim të hershëm, përmes përkrahjes dhe lidhjes së marrëveshjeve bilaterale dhe rajonale ndërmjet shteteve, përfshi edhe kreimin e mekanizmave koordinativ për rreziqe tejkufitare, si për shembull vërshime të cilat ndodhin në zonën e njëjtë lumore.

Në kuadër të mekanizmave, mund të parashihet këmbimi i informatave dhe aktiviteteve për përsosje të kapaciteteve.

Praktikë e mirë:

Sistemin për paralajmërim të hershëm të bashkësive nga vërshimet në Çikvava, Malavi, e organizon Organizata Ndihma krishtere, në të cilën janë përfshirë tri bashkësi, të cilët i vëzhgojnë matësit e nivelit të ujit në pikat kyç të lumit Mvanza. Ata këmbëjnë informata përmes telefonave mobil me fshatrat përgjatë lumit. Më pastaj, lajmet te popullata transmetohen me megafon dhe me shpalljen e informatave, të posterëve në lokacione publike të lagjeve, me qëllim të informimit të popullatës.

Praktikë e mirë:

Në vitin 2008, në Somali, 20 organizata të ndryshme (organizata joqeveritare, agjenci/shërbime qeveritare dhe institucione shtetërore) nga rajoni Somali (Etiopi), Yona Borena (Etiopi), dhe Mojale (Kenia), morën pjesë në Punëtorinë me titull: "Paralajmërim i hershëm tejkufitar dhe përgjigje për katastrofat".

Aktivitetet e planifikuara nga të gjithë pjesëmarrësit, midis tjerash, kishin të bëjnë me: harmonizimin e formave të ndryshme monitoruese për paralajmërim të hershëm, inkuadrimin më të madh të bashkësive në sigurimin e të dhënave dhe dhënien e raporteve për paralajmërim të hershëm dhe përmirësimin e aspekteve lidhur me këmbimin e shpërndarjen e informatave për paralajmërim të hershëm.

Praktikë e mirë:

Mekanizmi për paralajmërim të hershëm dhe përgjigje konflikteve për shtatë vende anëtare të nënrajonit të Rogot të Afrikës, është orientuar kryekëput drejt konflikteve tejkufitare të fshatarëve.

Praktikë e mirë:

Pas vërshimeve të mëdha në Zambezi më viti 2001, disa nga subjektet konsideronin se faji për vërshimet e mëdha qëndron te dy pendat e mëdha përgjatë rrjedhës së Lumit Kariba, në kufirin midis Zambies dhe Zimbabves dhe Kahora Basa në provincën Tete të Mozambikut.

Me qëllim të qasjes lidhur me rolin e rrjedhës ndërkombëtare të lumenjve dhe menaxhimin e pendave përgjatë rrjedhës së lumenjve, USAID financoi një projekt, përmes të cilit u ftuan nëpunës të lartë qeveritarë nga Instituti nacional për menaxhimin e katastrofave të Mozambikut, Instituti i ujrave dhe meteorologjisë, kryeredaktorët e Radio Mozambikut dhe Gazetës nacionale, drejtori i Programit botëror për ushqim në vend, Agjencia zhvillimore Jugafrikane dhe Njësi rajonal për alarmim, ishin në një vizitë të përbashkët pendave Kariba dhe Kahora Basa.

Përfaqësuesit e subjekteve të lartpërmendura, u njohtuan me funksionimin e pendave dhe me atë se si përcillen prognozat e motit për nevojën për planifikim të rrjedhjes vjetore të ujit. Ky udhëtim, hapi dialog midis udhëheqësve të pendave dhe autoriteteve përgjegjëse të Mozambikut dhe e ngriti vetëdijen e faktorëve për pasojat nga rrjedhja e ujit në rrjedhën e sipërme të lumit dhe nevojën për bashkëpunim dhe këmbim të informatave tejkufitare.

Praktikë e mirë:

Në Kenia dhe Ugandë, Iniciativa për zgjidhjen e konfliktit ndërkufitar ndërmjet Dodo dhe Turkana (e implementuar në vitin 2005) i inkuadroi bashkësitë e barinjve nga të dy anët e kufirit ndërkombëtar. Konfliktet midis dy vendeve kanë histori të gjatë dhe janë rezultat i thatësirave sezonale, të cilët rezultuan me nevojën e ndarjes së kullosave dhe burimeve të ujit. Qëllimi i projektit ishte nxitja e dialogut midis bashkësive (takime të cilat kishin për qëllim zgjidhjen e konfliktit) dhe angazhimin e dë ty palëve në aktivitete për zbutjen e situatës (rehabilitimi i burimeve të ujit për bagëtinë, nga ana e Ugandës (lokacionin Kamion/Oropoi).

Leksione të mësuara:

Shembull klasik i kompleksitetit të çështjeve tejkufitare, është rasti me një agenci në Malavi, e cila implementonte një projekt për kontrollin e vërshimeve lumore, nëpërmjet mbjelljes së barit në brigjet e lumit. Vetë lumi ishte kufi midis dy shteteve, vetëm njëra pjesë e bregut të lumit ishte e mbjellur me bari, sepse agjencija nuk kishte qasje për punë në bregun tjetër për shkak të konfliktit me autoritetet e anës tjetër. Edhe pse projekti mbase i zvogëloi vërshimet në njërin rajon, ekzistonte brengosje nga rreziku se mund të shkaktojë vërshime në anën tjetër të bregut të lumit. Ky rast, qartazi tregon se ekziston nevoja për bashkëpunim gjithpërfshirës tejkufitar për ballafaqim me rrezikun.

Parimi udhëheqës 10:

Shfrytëzim i teknologjisë përkatëse

Shkenca ka arritur progres të konsiderueshëm, sidomos në monitorimin dhe prognozën e sistemeve për të reshura dhe stuhi, që rezultoi me rezultate të rëndësishme, sidomos në pjesën e shpëtimit të jetës së njerëzve.

Ekziston hapësirë për teknologji të lartë në sistemin për paralajmërim të hershëm; teknologjia duhet shfrytëzuar efektivisht në të gjitha sferat ku mund të sigurohet kontribut i caktuar. Por, megjithatë, paralajmërimet e sofistikuara mbeten të padobishëm, nëse nuk lidhen me aksion efektiv.

Mirëpo, shumë subjekte që punojnë në fushën e paralajmërimit të hershëm, mbështeten në teknologjinë e lartë. Kjo ka të bëjë me faktin se deri më tani është investuar shumë në monitorimin global dhe rajonal të rreziqeve, me shfrytëzimin e sensorëve dirigjues për vëzhgimin e situatës në vend nga qielli si dhe shfrytëzimi i telekomunikimeve dhe internetit për komunikimin e porosive të duhura për rreziqe.

Por, për teknologji nevojitet stërvitje për aftësimin dhe fitimin e diturive për teknologji/fitimin e shkathtësive, instalimin dhe/ose mirëmbajtjen e sistemeve, nevojiten burime njerëzore dhe përgjithësisht nevojiten mjete për mirëmbajtjen e sistemit. Sa më i sofistikuar është teknologjia, aq më të mëdha janë shpenzimet për çdo element veçmas.

Mirëpo, prakticienët për uljen e rreziqeve nga katasatarofat, duhet të insistojnë për teknologji përkatëse (kost-efektiv, robus, rezistues, lehtas i përdorueshëm, me pjesë lehtas të zëvendësueshëm dhe mirëmbajtje të lehtë etj.) në çdo nivel.

Tërë teknologjia e re, përkatëse ose jo, duhet të aplikohet me dozë të fuqishme të vetëdijes dhe ndieshmërisë dhe mbështetje të bashkësisë. Instalimi i hardverit të ri pa komponente të pamjaftueshme të softverit për vlerësimin e situatave në bashkësi, mund të sjellë rezultate të çuditshme kundërproduktive, madje edhe katastrofale. Edhe pse teknologjia inponon burime plotësuese

(stërvitje, mirëmbajtje etj) , ajo gjithashtu siguron mundësi; kurse teknologjitë e reja, siç janë, për shembull, mediat sociale, duhet të shfrytëzohen kur të jetë e mundur kjo, me qëllim të sigurimit të paralajmërimeve me kohë dhe efektive.

Teknologjia te sistemet për paralajmërim te hershëm është kryesisht e lidhur me komunikimet për monitorim dhe paralajmërim, sepse ato komponentë zakonisht shfrytëzojnë hardver apo pajisje për realizimin e qëllimeve të dëshirueshme. Idetë për teknologji përkatëse për çdo komponent dhe nivel të sistemeve për paralajmërim të hershëm, mund të gjenden në Tabelën e mëposhtme 8 dhe ato nevojitet të kontekstualizohen në mënyrë përkatëse.

Praktikë e mirë:

Në Amerikën Qendrore (Meksikë dhe Karaibet), në mënyrë lokale bëhen shkallë dhe matës hidrometrik për të reshura shiu dhe të njëjtat vendosen dhe vëzhgohen nga bashkësia.

Praktikë e mirë:

Më 4 korrik të vitit 2007 alarmi për paralajmërim te hershëm për cunamit u aktivizua një orë në Açe të Indonezisë si paralajmërim për cunami. Më vonë u vërtetua si alarm i rrejshëm. Disa mijëra njerëz ishin në panik, sepse nuk ishin stërvitur se çka duhet bërë në rast të paralajmërimit me alarm dhe njëkohësisht nuk ishin stërvitur që ta njohin sinjalin për pushimin e alarmit. Si pasojë e kësaj, banorët e zemëruar e asgjësuan pajisjen e shtrenjtë.

Leksione të mesuara:

Një ngjarje interesante ndodhi në Mjanmar, ku u dhanë parashikime të sakta satelitore për rrugën nëpër të cilën dotë lëvizë cikloni 4 ditë para se të ndodhë tragjedia, por megjithatë bashkësitë e ekspozuara në rrezik nuk u strehuan me kohë. Shërbimi meteorologjik indian e indentifikoi ciklonin me 27 prill dhe e klasifikoi si shtrëngatë ciklonike më 29 prill, disa ditë para se të lëshohet në tokë më 2 maj.

Prognozat dhe parajmërimet shpallen nga Seksioni për meteorologji dhe hidrologji i Mjanmarit dhe diseminohen përmes TV, gazetave, radios dhe komunikimeve direkte me autoritetet nacioale, mirëpo në të shumtën e rasteve informatat nuk merren me kohë nga bshkësite lokale, sidomos në rajonet e largëta dhe të pazhvilluara bregdetare, të cilët vërshohen si rezultat i ciklonit Nargis.

Krahas kësaj, u konkludua se planet për evakuim gjatë situatave emergjente, ishin jo adekuat ose nuk kanë ekzistuar fare për rajonet e largëta. Kjo katastrofë vuri në pah nevojën për planifikim dhe gatishmëri në bashkësi dhe aktivizimin e planeve për situata emergjente në drejtim të gatishmërisë dhe përgjigjes më të mirë, në koordinim me agjenci të ndryshme në nivel nacional dhe lokal⁵. Teknologjia e lartë dhe parashikimet nuk mjaftojnë.

Tabela 8: Ide për teknologji përkatëse varësisht nga komponenti dhe niveli i paralajmërimit të hershëm

Komponentët e sistemit për paralajmërim të hershëm	Nivel lokal / Bashkësi	Nivel nacional	Nivel rajonal / global
Dituri për rreziqe	Shënimi në hartë i rreziqeve nga ana e anëtarëve të bashkësisë (Procesi i vlerësimit të ndjeshmërisë dhe kapaciteteve	GIS harta të rreziqeve, ku janë shfaqur kanosjet dhe situatat e ndjeshme në vend; rrjeti kompjuterik i cili pranon dhe ndjek sinjale më të mëdha për shtrëngata.	Fotografi satelitore për më shumë se 30 vjet mund të krahasohen për përcjelljen e të dhënave për përgatitjen e hartave për rreziqe dhe situata të ndjeshme.
Minitorim	Matës dore për matjen e sasive të të reshurave dhe niveli të lumenjve, bilborda për paralajmërimin e rritjes së nivelit të lumenjve.		Sistem satelitor për monitorim me shfaqjen e situatës në kohë reale me prozheksione dhe modele klimatike.
Kapacitet për përgjigje	Rrugë evakuimi të shënuara me shenja (ngjyrë fluorescente) dhe strehimore nga ciklonet të disenjuara në mënyrë lokale.	Ciladoqoftë përgjigje në këtë nivel, me siguri do të bazohet në teknologjinë e njëjtë të pasqyruar më poshtë si për mjete komunikuese për paralajmërim.	
	Mjete lokale për komunikim prej	Radio, telefon, televizor	E-mail dhe internet prognoza sezonale

⁵ Golnaraghi, M, 2012: Partneritete institucionale në sistemet për paralajmërim të hershëm nga rreziqe të ndryshme: Përmbledhja e shtatë praktikave të mira nacionale. Heidelberg, Springer- Verlag: Parimi nr.2, faqe 220.

Mjete komunikuese për paralajmërim	goje në gojë, me persona të cilët shkojnë shtëpi më shtëpi, lodra, flamuj, zile, telefona, radio, televizor, megafon, altoparlante nga xhamitë.		
------------------------------------	---	--	--

Parimi udhëheqës 11:

Domosdoshmëri për set rezerv të treguesve dhe kanaleve komunikuese

Ekzistimi i obcionit rezerv është koncept i rëndësishëm për praktikantët të cilët punojnë në uljen/ menaxhimin e rreziqeve nga katastrofat dhe me rëndësi edhe më të madhe është për menaxhuesit të cilët punojnë me ballafaqimin e rreziqeve. Opcioni rezerv, në të vërtetë do të thotë siguri i sistemit apo pajisjes plotësuese apo rezerve, të cilët mund të funksionojnë në rast se dështon pjesë nga sistemi. Në punën për shpëtimin e jetës së njerëzve nuk dëshirojmë të rrezikojmë shumë, caktimi i sistemit rezerv na ndihmon që të kujdesemi për detektimin e sinjaleve, për marrjen e mesazheve dhe veprimin në saje të tyre. Përgjithësisht, opcion i rezerv na mundëson të jemi të thuktë dhe të vëmendshëm dhe të sinjalizojmë se sistemet në segmente të caktuara mund tërësisht të mos funksionojnë për shkaqe të ndryshme.

Një hulumtim i realizuar kohë më parë, me siguri tregoi se për rreziqet të cilat shkaktohen ngadalë, si për shembull te disa vërshime, besimi në paralajmërime rritet vetëm atëherë kur kjo gjë përsëritet disa herë⁶; nëpërmjet sistemit rezerv kujdesemi që mesazhet të përsëriten. Të paktën dy elemente duhet ta përmbajnë opcionin rezerv:

- 1.) Tregues të cilët përcillen
- 2.) Kanale komunikuese të cilat shfrytëzohen për dërgimin e mesazheve për paralajmërim.

Që të dy elementet diskutohen më poshtë më hollësisht.

⁶ Për termetet paralajmërimi i hershëm është në momentin e mesazhit; nuk ka kohë për pritjen e mesazheve rezerve para se të reagohet. Për këtë arsye, presioni është edhe më i madh lidhur me dërgimin me kohë dhe fuqishmërinë e mesazheve për paralajmërim.

Tregues të cilët përcillen

Përgjithësisht, mbizotëron mirëkuptim se nuk ekziston tregues magjik për një rrezik të caktuar (me përjashtim të sensorëve për monitorimin e sistemeve sizmike). Kjo do të thotë se në çdo nivel në sistemin për paralajmërim të hershëm duhet të përcillen kombinimet e situatave, si përshembull sasishtë e të reshurave në rrjedhën e sipërme të lumit dhe nivelet e lumenjëve. Të kuptuarit e trendeve dhe prozhekcioneve do të rezultojë me përcjelljen e tyre të veçantë dhe mënyren në të cilën mund të ndikojnë reciprokisht. Kjo quhet triangulacion.

Mbështetja e aktiviteteve për paralajmërim të hershëm vetëm në një tregues, nuk është praktikë shumë e mirë, përpos kur bëhet fjalë për monitorimin e tërmeteve. Një tregues, të cilin do ta zgjedhë bashkësia për ta përcjellur në nivel lokal, mund të jetë ngusht i lidhur me ndonjë simptomë apo situatë më pak të njohur dhe mund të jetë jo mjaft sensitiv ndaj rrezikut prioritar; zgjedhja e treguesit mund të mos jetë e vërteta. Për shumë arsye, treguesi perfekt i përcjellur në cilin do nivel me teknologji më të lartë, mund të jetë i ndieshëm ndaj gabimit njerëzor apo teknologjik në matjen e datës së caktuar apo në periudhë të caktuar të vitit. Gjithashtu, mund të bazohet në njohuri jo të plota shkencore (për shembull, levizshmerinë e reve).

Situatat lidhur me rreziqet mund të keqësohen për një bashkësi të caktuar, por në të njëjtën kohë familje të caktuara mund të grumbullojnë rezerva personale ose të ndahen rezerva në nivel të bashkësisë, me qëllim që të zvogëlohet ndjeshmëria dhe të rritet rezistueshmëria ndaj kërcënimit të drejtëpërdrejtë. Përcjellja e rreziqeve dhe ndjeshmërisë, është edhe një formë e sigurimit të qasjes rezerve gjatë paralajmërimit të hershëm. Shembull tjetër për sistem rezerv gjatë monitorimit është midis niveleve të ndryshme. Kur forumi klimatik rajonal i përcjellë treguesit global për përgatitjen e mjetit monitorues, si përshembull prognoza sezonale, ai sistematikisht duhet të verifikohet nëpërmjet monitorimit plotësues të situatave lokale. Treguesit lokal shpesh janë më të ndieshëm në ndryshime të vogla në hapësirë dhe kohë, se sa ato të sigurura nga sistemet globale apo rajonale për paralajmërim të hershëm.

Për arsye të lartpërmendura, fuqimisht rekomandohet që të insistohet për tregues të shumëfishtë për çdonjërin rrezik të çdo niveli. Më poshtë janë prezentuar shembuj të caktuar specifik:

Praktikë e mirë:

Krahas diseminimit të mirë të sistemit për paralajmërim në Laos, paralajmërimet zyrtare nuk arrijnë deri në fshatin Çif. Në vend të kësaj, përfaqësues nga fshati, i cili punon në seksionin meteorologjik, ka qasje në sistemin për paralajmërim të hershëm dhe e alarmon fshatin Çif. Njëri nga të punësuarit në Nam Ngum Dam gjithashtu siguron paralajmërim për fshatin dy-tre ditë para hapjes së pendës për lirim të ujit. Nga ana tjetër, bashkësia ka sistem tradicional për detektimin e rreziqeve. Me të përcilet niveli i ujit që të shihet a ekziston rreziku nga vërshimet.

Praktikë e mirë:

Në Kenia dhe Tanzani, Masajët i përcjellin shenjat për thatësi, degradimin e ambientit jetësorë dhe sigurimin e ushqimit nëpërmjet analizimit të gjendjes së bagëtisë. Treguesit lokal janë rendimentet ditore të qumështit, ngjyra dhe cilësia e lëkurës dhe gjendja e kullosave. Masajët asnjëherë nuk shfrytëzojnë vetëm një tregues për sjelljen e konkludimeve, por shfrytëzojnë më shumë tregues.

Kanale komunikuese të cilat shfrytëzohen për paralajmërim

Kur sistemi për paralajmërim të hershëm është i gatshëm për dhënien e paralajmërimit, shërbimi monitorues (shërbimi për uljen/menaxhimin e rreziqeve nga katastrofat, shërbimi meteorologjik, hidrologjik, shërbimi shëndetësor etj) duhet menjëherë të kontaktojë dhe/ose të iniciojë sistem komunikues i studiuar dhe i organizuar mirë, me qëllim të paralajmërohen të gjithë individët e mundshëm të cilët i janë ekspozuar rrezikut. Më shumë faktorë ndikojnë në atë se a do të mbërrijë paralajmërimi në fokus grupin e publikut. Ata mund të jenë nga natyra teknologjike deri në shkujdesje; në tabelën 9 janë shfaqur faktorë të ndryshëm dhe nevoja për ekzistimin e sistemeve alternative.

Tabela 9: Nevoja për sistem rezerv në komunikimin për paralajmërim

Emri i faktorit	Përshkrimi	Shembulli	Nevoja për sistem rezerv
Difekti teknologjik	Sistemi për transferimin e paralajmërimit nuk ka punuar mirë	Rjeti telefonik nuk funksionon për shkak të rrethanave kohore	Përdorni njëkohësisht teknologji të dytë apo të tretë alternative para se të bie rrjeti.
Lidhje jopërkatese fizike	Sistemi apo kanali nuk e transmeton mesazhin deri te të gjitha familjet e ekspozuara në rrezik.	Zëri i alarmit nuk ndëgjohet deri ne pjesën më të larguar nga fshati afër lumit.	Organizoni persona që personalisht të thërrasin ose ta përcjellin mesazhin duke e inkuadruar në të njejtën kohë alarmin.
Lidhje jopërkatese shoqërore	Personat me mobilitet, dëgjueshmëri dhe të pamur të çrregulluar nuk kanë qasje në mesazh.	Personat e moshuar të shurdhër nuk e marrin mesazhin për shkak të mungesës së kontaktit me bashkësinë. Turisti nuk e përcjell radion lokale.	Formoni rrjet fqinjësor (ose komitete fshatare për katastrofa), në të cilat vullnetarët do të kenë detyrë përcjelljen e mesazheve personale në numër të caktuar familjesh.
Mosmarrëveshje	Është marrë paralajmërimi i cili nuk është i logjikshëm për bashkësinë apo individë të ndryshëm.	Janë vënë flamuj për aktivitet vulkanik, por nuk është kuptuar rëndësia. Emigrantët nuk i kanë kuptuar mesazhet në gjuhën lokale.	Krahas flamujve, përgatitni mesazhe në gjuhë të ndryshme për ti kuptuar grupet e rezikuara.
Mospërfillje	Është marë	Bashkësitë nuk i	Përsëritni mesazhet, që

	paralajmërim i cili injorohet, të cilit nuk i besohet për shkaqe të caktuara, që rezulton me mosmarrjen e aksionit.	besojnë mesazheve nga jashtë; gratë marin paralajmërim në shtëpi dhe të njëjtin e kuptojnë, por nuk guxojnë ta braktisin shtëpinë pa leje të burrave.	të kenë jehonë më të madhe: njerëzit besojnë kur i dëgjojnë gjërat disa herë. Ndërtoni besimin.
--	---	---	---

Parimi udhëheqës 12:

Përfshirja e grupeve me të drejta të mohuara dhe të ndjeshme

Ky parim i përket grupeve populluese të cilat janë me hendikep të caktuar fizik, tashmë të cekur më lart (parimi udhëheqës 9). Sistemi për paralajmërim të hershëm çdo herë duhet ti ketë parasysh nevojat dhe karakteristikat e grupeve me të drejta të mohuara, gjatë realizimit të çdo komponenti dhe të çdo niveli.

Termi me të drejta të mohuara është përzgjedhur në vend të termit të ndjeshëm, me qëllim që të mundësohet inkuadrimi i grupit më të madh të njerëzve të ekspozuar në rrezik (të ekspozuar dhe / ose të ndjeshëm në rrezik). Gjatë aktiviteteve për uljen/ menaxhimin e rreziqeve nga katastrofat nuk është e dobishme të izolohet çështja e gjinive, sepse personat me të drejta të mohuara apo personat e marginalizuar nuk janë vetëm gra, fëmijë, të moshuar dhe persona me hendikep. Varësisht nga rreziku, këta mund të jenë persona pa kulm mbi kokë, gjysmanalfabet, persona të cilët gjatë natës punojnë në lumë, të rinj të cilët luajnë afër lumit, prindër vetushqyes (pa marrë parasysh gjininë), ose thjesht persona ekonomikisht të pasiguruar.

Pothuaj çdo bashkësi ka grup njerëzish, të cilët për arsye të qëllimshme apo të paqëllimshme janë të marginalizuar. Këta mund të jenë vizitorë-turistë apo punëtorë sezonal ose emigrantë të përhershëm në bashkësi. Duke marrë parasysh se ata me siguri nuk dëgjojnë radio apo nuk mund ta kuptojnë gjuhën lokale, e as ti kuptojnë mesazhet kulturologjike nga fqinjët, ata bëhen të marginalizuar gjatë rrezikut të drejtpërdrejtë. Prandaj të gjitha këto duhet të merren parasysh gjatë paralajmërimit të hershëm: të identifikohen, inkuadrohen, angazhohen apo të paktën të paralajmërohen.

Në mbarë botën gratë janë të frustruara, sepse sipas shprehisë quhen më të ndjeshme në procesin e uljes së rreziqeve nga katastrofat. E vërteta është se ekspozimi i tyre shoqëror dhe ditor në rreziqe i dallon nga burrat më tepër, se sa aspekti i ndjeshmërisë apo kapacitet e tyre. Gratë mbase janë më shumë të vetëdijshme dhe drejtpërdrejtë përgjegjëse për fëmijët, që i vë në situatë të veçantë karshi shpëtimit të tyre nga shkollat apo nga fushat e sportit. Statusi i tyre social mbase i pengon apo i sjellë në situatë të papëlqyeshme që t'i përgjigjen në mënyrë përkatëse paralajmërimit (për shembull evakuimi me fqinjët), që të mund burrat më mirë të ballafaqohen me ciklonin.

Proceset shoqërore dhe kulturore ndoshta i detyrojnë gratë të jenë të ekspozuara në nivel më të lartë në rreziqe, por kjo nuk do të thotë se ato janë

më të ndjeshme. Nëse e dallojmë këtë, atëherë do të mund të bëjmë analizë më të dobishme dhe fokusim më efikas të grupeve me të drejta të mohuara.

Praktikë e mirë:

Punimi pasdiplomik i një studenti nga Nepali ishte orientuar në kërkimin se si rolet dhe përgjegjësitë e definuara shoqërore ia mohojnë të drejtat e njërës karshi gjinisë tjetër, dhe se si stereotipet gjinore ndikojnë në sistemin për paralajmërim të hershëm. Konstatimet treguan se si rezultat i stereotipeve dhe roleve, obligimeve, shkathtësive dhe kapaciteve, mobilizimit dhe praktikave shoqëro-kulturore gratë ndonjëherë janë më të ndjeshme ndaj vërshimeve se sa burrat. Burrat të cilët e përcjellin nivelin e ujit janë më të ekspozuar në rreziqe natën kur e përcjellin nivelin e ujit të lumit. Gjithashtu, meqë burrat janë më të mobilizuar se gratë, ka gjasa ata të jenë më mirë të informuar dhe mund t'i përcjellin mesazhet në bashkësi.

Praktikë e mirë:

Vietnam : Në kuadër të sistemit për paralajmërim të hershëm të Lumit Mekong ,janë stërvitur anëtarë të bashkësisë, të cilët pas marjes së paralajmërimit për vërshime, personat e hendikepuar dhe fëmijët i dërgojnë në lokacion të sigurt.

Praktikë e mirë:

Qyteti Kejptaun në Afrikën Jugore ka sistem për paralajmërim të hershëm, i cili është i angazhuar për përcjelljen e situatës në Lumin Diep, i cili rrjedh nëpër shumë vendbanime të populluara. Autoritetet zhvillojnë aktivitete intensive për ngritjen e vetëdijes ne opinion për edukimin e popullatës nga viset e rrafshta se si të veprojnë gjatë rritjes së nivelit të ujit të lumit, si të riorientohen ujrat nga lumi i vërshuar dhe si të zvoglohet rreziku për shëndetin e njerëzve nga ujrat e vërshuar. Qyteti punon me Sektorin joqeveritar për sigurimin e “ambientit jetësor të sigurt, të pastërt dhe dinjitoz”, nëpërmjet sigurimit të vendstrehimit, ushqimit dhe sigurisë për personat pa kulm mbi kokë.

Leksione të mësuara:

Të dhënat e vitit 2004 për cunamin që ndodhi në Oqeanin Indian, nga 7 persona të vdekur në Ishullin Simelue (20 minuta largë epiqendrës afër Indonezisë), 5 prej tyre ishin emigrant nga provincat / rajonet fqinje të Indonezisë. Shkak për këtë është se emigrantët në ishull nuk ishin të njoftuar me informatat e nevojshme se si duhet të veprojnë në rast të cunamit.

Parimi udhëheqës 13:

Ndërtim i partneriteteve dhe promovim i angazhimeve individuale

Funksionaliteti i sistemeve për paralajmërim të hershëm në cilindo nivel, është ngusht i lidhur me partneritetet dhe angazhimin e individëve të caktuar. Funksionimi i sistemit në më shumë nivele dhe për më shumë rreziqe, mund të funksionojë mirë vetëm po që se partneritetet dhe obligimet janë të qartësuara mirë dhe poqëse ekzistojnë subjekte të përgjegjshëm për çdo aktivitet.

Përfshirja i të gjitha subjektëve mundëson pjesëmarrje aktive në sistemin për paralajmërim të hershëm. Arsyeja për të cilën duhet të përkrahen partneritetet, është ajo se ata sjellin burime më të mëdha financiare apo materiale. Burimet financiare çdo herë janë të pamjaftueshme, prandaj pothuaj çdoherë ka nevojë për lobim për sigurimin e mjeteve të duhura financiare. Paramendoni vlerën kur një vullnetar lokal i Kryqit të kuq / Gjysmëhënës së kuqe, i cili, fatkeqësisht edhe përkrah fatkeqësisë personale (i kishte humbur fëmijët gjatë lirim të pa paralajmërueshëm të ujit nga penda), flet pozitivisht për nevojën e paralajmërimit të hershëm. Me këtë rast, kjo është sidomos e rëndësishme për të tjerët të cilët mund të përballen me situatë të ngjajshme, të mund të mësojnë nga këto përvoja.

Nevoja për përforsimin e sigurisë dhe mbrojtjes të numrit të madh të njerëzve, gjithësesi mund të forcohet me pjesëmarrjen e kryebashkiakut apo kryetarit rajonal në sistemin për paralajmërim të hershëm. Pjesëmarrja e liderëve të këtyllë është me rëndësi esenciale për suksesin e sistemit lokal për paralajmërim të hershëm. Liderët gjithmonë janë këtu, prandaj duhet bërë çmos ti gjeni dhe ti përfshini në aktivitete. Lista e partnerëve potencial për zbatimin e sistemit për paralajmërim të hershëm është shumë e gjatë dhe dallon në nivele të ndryshme, rreziqe apo në kontekste të ndryshme.

Vendi i mirë ku mund të fillohet me kërkime për vendosjen e partneriteteve për paralajmërim të hershëm është në nivel lokal, gjegjësisht në vetë bashkësinë. Në bashkësitë e ekspozuara në rreziqe, nuk është vështirë të identifikohen vullnetarët dhe liderët të cilët dëshirojnë të kontribuojnë në fushën e paralajmërimit të hershëm. Partneritetet për paralajmërim të hershëm mund të fillojnë me to. Më poshtë janë prezentuar edhe format tjera të partneriteteve.

- **Shkollat dhe të rinjtë:** Duke marrë parasysh lidhshmërinë e ngushtë me bashkësinë, është me rëndësi të bëhet hulumtim kreativ si të shfrytëzohen shkollat dhe grupet e të rinjve që të marrin pjesë në sferën e sigurimit të diturive për rreziqe, përcjelljen e kërcënimeve, ndërtimin e kapaciteteve për përgjigje dhe bartjen e mesazheve për paralajmërim të

hershëm. Për këtë qëllim mund të përgatiten edhe programe përkatëse mësimore. Angazhimi i nxënësve në përcjelljen e nivelit të lumenjve dhe sasisë të të reshurave të shiut mundëson të kontribuojmë për shkencën për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofat, përmes sigurimit të të dhënave ekzistuese, të cilat do të shërbejnë për nevojat e bashkësive si dhe nevojat e shkencës (Shërbimi nacional meteorologjik, Shërbimet informative dhe Organizata botërore e meteorologjisë).

Praktikë e mirë:

Në Ishujt e Kajmaneve, Komiteti nacional për uragane është partneritet publi-privat, përgjegjëse për uljen e rreziqeve nga uraganet dhe kujdeset për zbatimin e aktivitete për gatishmëri, përgjigje dhe mëkëmbje. Suksesi i punës së Komitetit ka të bëjë para së gjithash me vullnetarët e respektuar dhe integrimi i tyre në sistem, përpjekjet e vazhdueshme për përsosje, nëpërmjet mësimit nga përvojat e kaluara (revidimi vjetor i planit), punë në kuadër të kornizës nacionale për uljen e rreziqeve nga katastrofat dhe zvogëlimin e humbjeve gjatë uraganeve sezonale.

Praktikë e mirë:

Klubet rinore të Gjysmëhënës së kuqe egjiptiane, janë gjërësisht të përhapura anë e mbanë vendit, në të gjitha rajonet. Ekzistojnë gjithsej 26 klube, me të paktën 20 degë në fshatra dhe rajone më të vogla. Rrjeti rinor ka ndikim jashtëzakonisht të madh në fushën e përcjelljes së mesazheve për paralajmërim të hershëm.

Praktikë e mirë:

Në zonën malore të Nuvara Elija në Sri-Lankë, një grup studentësh të shkencave natyrore, siguronin përkrahje në fushën e mbrojtjes së bashkësive lokale nga rrëshqitja e tokës dhe vërshimet. Si rezultat i dëmeve të mëdha në vitin 2008, studentët morën detyrë që reciprokisht dy herë në ditë t'i ndjekin të reshurat e shiut, duke shfrytëzuar matës të lirë. Gjatë festave shkollore (të cilat në masë të madhe përputhen me sezonin e të reshurave), nxënësit të cilët jetojnë në afërsi të shkollës morën detyrë ta përcjellin situatën. Nëse të reshurat i tejkalojnë 76 cm në periudhë prej 24 orësh, atëherë ata i informojnë prindërt e tyre dhe autoritetet. Mënjëherë informohet zyra rajonale, me qëllim që të verifikohen rezultatat so Shërbimin meteorologjik, i cili jep paralajmërime përkatëse përmes radios dhe televizorit. Ky program tani reprizohet në tërë rajonin dhe janë hartuar plane për zgjerimin e mëtejshëm të programit. Do të bëhen prezentime nga ana e nxënësve në takimet mujore, në rajonet në të cilat do të marrin pjesë përfaqësues të sektorit civil dhe autoritete lokale.

Leksione të mësuara:

Sistemi për paralajmërim të hershëm në Nepal (i organizuar nëpërmjet aksionot praktik, përmban komponentë të fuqishme për ngritjen e vetëdijes, i plotësuar me kontributin në formë të monitorimit nga ana e shkollave). Por, problemi u paraqit kur u konstatua se shkollat nuk punojnë gjatë sezonit të cikloneve, atëherë kur monitorimi është më i rëndësishëm.

- **Sektori privat:** Sektori privat, madje edhe në nivel bashkësie, kurse përfundimisht në nivel më të lartë, disponon burime, të cilat mundën në masë të konsiderueshme të kontribuojnë për forcimin e sistemit për paralajmërim të hershëm. Mesazhet për paralajmërim, do të kenë benefit të drejtpërdrejtë përmes sigurimit të prodhimeve të tyre, kurse nga ana tjetër kontributi i tyre do mundësojë shfaqjen e përgjegjësisë komporative shoqërore. Kontributi i sërishëm në bashkësi, nëpërmjet dhurimit të pajisjes komunikuese dhe ndërtimit të strehimoreve, tregon përkatësinë ndaj bashkësisë lokale. Subjektet nga radhët e sektorit privat, të cilët më së shpeshti janë të përfshirë në sistemin për paralajmërim të hershëm, janë nga sfera e telekomunikimeve (diseminimin e mesazheve për paralajmërim) dhe sektorit servis (si për shembull hotelet të cilat kanë objekte relativisht më të mëdha dhe më të sigurt për sigurimin e strehimeve)- në vazhdim janë prezentuar disa shembuj:

Praktikë e mirë:

Në mars të vitit 2007, LIRNA, Azi, me burime dhe përkrahje të Sarvodaja dhe Qendrës për menaxhimin e katastrofave, zbatuan me sukses një pilot-studim për "Sistemin për paralajmërim nga rreziqet" në 32 fshatra në Sri-Lankë. Qëllimi i projektit ishte që të bëhet evaluimi i qëndrueshmërisë së pesë aparateve teknologjike, të instaluara që t'i përcjellin situatat në fshatra të caktuara, me qëllim që të sigurohet përkrahje në kuadër të sistemit nacional për paralajmërim të katastrofave në Sri-Lankë dhe vendet e afërta. Në relacion të kapaciteteve organizative, pilot-projekti tregoi se telefonat mobil dhe fiks, më së miri funksionojnë për shkak se për të njëjtat nuk nevojitet ndonjë stërvitje e veçantë., Së këtëjmi, mund të konkludohet se projekti kontribuoi që përpjekjet të zhvendosen në nivel të ri, respektivisht të promovohet bashkëpunimi i mëtutjeshëm me Dijalog Telekom të Sri-Lankës

Praktikë e mirë:

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në kuadër të aktiviteteve ptë autoriteteve lokale për planifikim gjatë situatave emergjente, ka bashkësi ku industria kimike lokale siguron burime për familjet fqinje për zvogëlimin e rreziqeve të cilat barten nëpërmjet ajrit. Autoritetet federative dhe lokale, sollën ligje për planifikim

emergjent dhe informimin e bashkësive me rreziqet e drejtpërdrejta nga kimikaliet dhe materiet toksike. Kjo krijoi kornizë për formimin e Komiteteve lokale për planifikim gjatë situatave emergjente dhe në disa bashkësi aktivitetet e këtyre komiteteve rezultuan me investime në industrinë kimike, për sigurimin e zgjidjeve mbrojtëse për objektet dhe familjet që gjenden në afërsi të drejtpërdrejtë të fabrikave. Për industrinë, gjithashtu është më lirë të paguaj shpenzime preventive, sesa procese të shtrenjta gjyqësore pas paraqitjes së problemeve shëndetësore te popullata.

Praktikë e mirë:

Në Indonezi, zinxhiri i hoteleve me pesë yje në Bali, nënshkroi MzR formal me organizatën komunale të Kryqit të kuq Bali dhe Bashkësinë Musa Dua, me qëllim të kontribuojë në implementimin e aktiviteteve për gatishmëri gjatë cunameve, si për shembull aktivitete për evakuim lidhur me paralajmërimin e hershëm

- **Shoqëria civile, organizata joqeveritare dhe Kryqi i kuq/Gjysmë hëna e kuqe:** Ekzistojnë gjithnjë e më shumë organizata, në nivel lokal, të cilat kanë bërë progres interesant në fushën e zbatimit të aktiviteteve për paralajmërim të hershëm, si përkrahje për autoritetet nacionale dhe lokale në suazat e mundësive të tyre. Janë të vogla gjasat që Lëvizja ndërkombëtare e kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe apo ndonjë organizatë joqeveritare në mënyrë të pavarur të fillojë me formimin e sitemit për paralajmërim të hershëm. Edhe pse partneritetet mund ta ngadalësojnë procesin, ato megjithatë dukshëm forcojnë ndikimin e qëndrueshmërisë.
- **Qeveria:** Duke marrë parasysh mandatin e qeverive, në të gjitha nivelet ato janë partner primar për vendosjen e sistemit për paralajmërim të hershëm. Shoqatat nacionale të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, kanë obligim t'i përkrahin qeveritë aktuale në fushën e punës humanitare. Sektori joqeveritar, gjithashtu, kontribuon në qëndrueshmërinë e përpjekjeve për paralajmërim të hershëm, me sigurimin e përkrahjes së qeverive për mbrojtjen e njerëzve. Sistemi për paralajmërim të hershëm që nga niveli nacional e deri te ai lokal, është ngusht i lidhur me kapacitetet për përgjigje dhe partneritetet e përhershme për sigurimin e funksionalitetit dhe suksesit të tij. Qeveritë dhe pushtetet lokale dhe rajonale, janë bartësit e përgjegjësisë primare për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofat, së këtijmi duhet të jenë edhe partnerët e parë të cilëve mund t'ju drejtohen bashkësitë në procesin e përgatitjes së sistemeve për paralajmërim të hershëm. Me rëndësi thelbësore është promovimi i pushteteve lokale me aktivitetet për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofat- paralajmërim i hershëm, sepse ato janë institucionet më të afërta qeveritare në nivel bashkësie, të cilat zakonisht kanë obligime dhe detyra regullatore për uljen e rreziqeve nga katastrofat dhe mund të

llogariten se janë kanal i vërtetë për sigurimin e mjeteve shtetërore për sisteme për paralajmërim të hershëm.

- **Armata:** Në vendet, ku prezenca ushtarake është aktive dhe vizuale, armata gjithashtu mund të inkuadrohet në përcjelljen e porosive për paralajmërim deri te bashkësitë të ekspozuara në rreziqe. Armata ka burime njerëzore ose kanale komunikuese, të cilat mund të huazohen për qëllimet për paralajmërim, po që se autorizohen nga shteti. Ato, gjithashtu, mund të marrin pjesë në stërvitje për paralajmërim të hershëm, të cilët do të shfrytëzohen për aftësimin e kuadrove në vend.

Praktikë e mirë:

USAID, bashkë me Ministrinë e shëndetësisë së Pakistanit dhe Organizatën botërore të shëndetësisë, financuan sistem për vëzhgimin e situatës me sëmundjet ngjitëse përmes klinikave mobile shëndetësore dhe laboratorëve për përcjelljen e rasteve të caktuara, me qëllim të përgjigjes së shpejtë çfarëdo qoftë kërcënimi lidhur me mjekimin dhe izolimin e rasteve infektuese nga pjesa tjetër e popullatës. Nëse një banor nga rajoni Dau ka pasur barkëqitje akute, punëtorët shëndetësor kanë mundur menjëherë të konstatojnë se a është kolerë dhe ta izolojnë pacientin dhe familjen e tij, të shpërndajnë porosi përkatëse shëndetësore në bashkësi, dhe në mënyrë përkatëse t'i trajtojnë burimet e ujit në bashkësi. Paraqitja e një sëmundjeje në një fshat, në mënyrë të pashmangshme do të përhapej në fshatin tjetër, dhe atje ku ka më shumë raste, do të përqëndroheshin më shumë burime. Sistemi për paralajmërim të hershëm për sëmundjet ngjitëse, për herë të parë u vendos në 37 rajone, të ekspozuara në tërmete dhe vërshime, me qëllim që të zgjerohet edhe në rajone tjera me rrezik të lartë, me qëllim të përsosjes së kapaciteteve të punëtorëve shëndetësor në rajonet periferike për detektimin e hershëm të epidemive.

- **Mediat:** Kanalet mediale nacionale dhe lokale, dukshëm mund të ndihmojnë në sferën e paralajmërimit të hershëm. Biznesi i tyre janë komunikimet: transmetimi i fjalës deri në një grup sa më të madh dëgjuesish apo lexuesish. Mediat, gjithashtu kanë përgjegjësi të transmetojnë informata të sakta dhe me kohë atyreve të cilëve ju nevojiten. Të gjitha përpjekjet për paralajmërim të hershëm, sidomos sesionet për stërvitje, duhet të involvojnë përfaqësues medial, jo vetëm të jenë të informuar dhe t'i shpallin aktivitetet, por edhe të marrin pjesë dhe të kontribuojnë si anëtarë aktivë të bashkësisë. Duhet të shfrytëzohen anët e fuqishme të mediave, me qëllim të hulumtimit më të mirë të kanaleve komunikuese deri te bashkësitë më të largëta, me qëllim të përgatitjes më të mirë të porosive për paralajmërim dhe të lobohet për emitimin/botimin më të volitshëm të porosive, me qëllim të ndihmohet në dhënien e paralajmërimeve me kohë.

Praktikë e mirë:

Në rajonet Sanikeli dhe Tapita të Liberisë, Kryqi i kuq i Liberisë në bashkëpunim me Kryqin e kuq suedez punojnë në zhvillimin e sistemeve për paralajmërim të hershëm. Me këtë rast është siguruar përkrahje në relacion të rimodelimit të porosive për paralajmërim të hershëm dhe sigurimin e hapësirës për emitimin e porosive për paralajmërim të hershëm me çmime të volitshme.

Praktikë e mirë:

Kryqi i kuq i Vietnamit, me përkrahjen e Kryqit të kuq amerikan, realizuan projekt partneriteti për paralajmërim të hershëm në 4 vende (Indonezi, Filipine, Sri-Lankë dhe Vietnam)), ku për herë të parë u formua Forum sezonal për nxitjen e dialogut dhe shkëmbim të përvojave midis atyre që i sollën ligjet dhe shërbimeve tjera qeveritare dhe institucioneve që merren me paralajmërimin e hershëm (për shembull, shërbimin hidrometeorologjik) dhe mediat lidhur me përfaqësimin e bashkësive të cilët kanë për qëllim t'i shërbejnë në nivel më të lartë. Programi, gjithashtu, përmban komponente për stërvitje, ku të punësuarit dhe vullnetarët aftësohen për dërgimin e porosive dhe planifikimin e paralajmërimit të hershëm, me qëllim të marrjes me kohë të aksionit përkatës në rast katastrofe.

Praktikë e mirë:

Emitimi i radio operës sapunistike “Tiempos de Huracanes” (Kohëra uraganesh), shumë e popullarizuar në rajon, u inicua nga Federata ndërkombëtare e shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, Strategjisë për uljen e rreziqeve të Kombeve të Bashkuara dhe partnerëve tjerë nga Kombet e Bashkuara, në bashkëpunim me 74 radio stacione lokale në nga gjashtë vende të Amerikës Qendrore në fillim të sezonit me të reshura shiu. Qëllimi i fushatës ishte siguri i informatave alternative për rreziqet nga katastrofat për popullatë e kategorisë më të ndjeshme.

„Kohëra uraganesh”, përbëhet nga katër rrëfime në kontekst të vërshimeve, të shkaktuara nga të reshurat të mëdha të shiut dhe uragane. Këto ngjarje ndodhin në bashkësi me nivele të ndryshme të gatishmërisë dhe i përkasin gjërave që ndodhin para, gjatë dhe pas ndodhjes së katastrofës www.eird.org/esp/radionovela/radionovela.htm.

Në bazë të kësaj përvoje, Federata ndërkombëtare e shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, Strategjisë për uljen e rreziqeve të Kombeve të Bashkuara bashkë me partnerë tjerë më vitin 2001 filluan me emitimin e radio operës së re sapunistike “Vida que te queremos tanto”, kurse pjesa e parë i dedikohet sistemit për paralajmërim të hershëm “cuando el rio suena” www.eird.org/radionovela/index.html.

Praktika në bashkësi: Parime udhëheqëse për komponentët e sistemeve për paralajmërim të hershëm

Për çdonjërin nga katër komponentët e sistemit për paralajmërim të hershëm, të gjitha pesë zonat e Federatës ndërkombëtare u obliguan të identifikojnë dhe të tregojnë praktika të mira dhe leksione të mësuara, sidomos në nivel lokal, gjegjësisht në nivel të bashkësive lokale. Në tekstin e mëposhtëm diskutohen mjete dhe qasje të cilat janë testuar dhe zbatuar për çdo komponent përmes aktiviteteve në nivel lokal. Gjithashtu janë prezentuar parimet udhëheqëse, specifike për përpjekjet që bëhen në nivel lokal.

Komponenti 1 i sistemit për paralajmërim të hershëm

Dituri për rreziqe

- Dituritë për rreziqe mund të fitohen me hulumtimin sistemor të rreziqeve dhe situatave të ndjeshme në çdo nivel (global, rajonal, nacional dhe lokal). Edhe pse me ndihmën e teknologjisë bashkëkohore mund të përgatiten harta gjeoreferente për më shumë rreziqe dhe situata të ndjeshme të komponentëve të tëra, dituritë për rreziqet janë më të mira kur merren drejtpërdrejt nga individë dhe bashkësi, të cilat konsiderohen si të ekspozuara në rreziqe. Në nivel të bashkësisë, dituria për rreziqet shpeshherë zbatohet përmes vlerësimit të rreziqeve. Mirëpo, asnjë sistem i diturive nuk është ilaç për gjithçka, gjegjësisht nuk paraqet zgjidhje universale. Institucione të ndryshme kanë përgatitur numër të madh të udhëzimeve dhe doracakëve, me qëllim që të ndihmohet në ndërtimin e bazës së nevojshme të diturive për rreziqe.

- Duke e pranuar rëndësinë e verifikimit dhe përtëritjes së informatave themelore, subjektet të cilat janë të inkuadruar në paralajmërimin e hershëm, si për shembull zbatimin e vlerësimit të ndjeshmërisë dhe caktimin në hartë të Programit botëror të ushqimit (më së shpeshti në kuadër të Sistemit për paralajmërim të hershëm të FAO dhe USAID), rezultoi me vlerësimin e ndjeshmërisë të cilat zbatohen në shumë vende të botës qysh në vitin 1990. Këto janë në përgjithësi pasqyrime vjetore të ndjeshmërisë të rreziqeve më të shpeshta në nivel të vendit. Në këtë nivel gjithësesi primare ishte që të shfrytëzohen përparësitë e teknologjisë, për shembull prognozatat për sasi të reshurave nga xhirimet satelitore, të cilat ndihmojnë plotësimin e mungesës së stacioneve matëse për ndjekjen e të reshurave të shiut në vendet e mëdha. Të gjitha këto elemente paraqesin nivel të caktuar të rrezikut.

- Federata ndërkombëtare ka përgatitur më shumë mjete për zbatimin e vlerësimit të ndjeshmërisë dhe kapaciteteve. Vlerësimi i ndjeshmërisë dhe i kapaciteteve është mjet i testuar mirë dhe inkorporon strategji për formimin e diturive për rreziqe në nivel bashkësie. Vlerësimi i ndjeshmërisë dhe kapaciteteve paraqet teknikë participuese, e cila inkorporon teknika, siç është caktimi në hartë i rreziqeve, rangimi i rreziqeve, shëtitje me qëllim të konstatimit të situatës në bashkësi dhe kalendarë sezonal. Është lehtë të paramendohet se si çdo njëri nga këto katrorë të diturive për rreziqe mund ta forcojë zhvillim e sistemit për paralajmërim në nivel bashkësie, me çrast shfrytëzohen pjesmarës lokal duke u angazhuar në procesin e të mësuarit dhe përcjelljes së rreziqeve. Duke marrë parasysh se dituritë për rreziqe si komponent i sistemit për paralajmërim të hershëm ka të bëjë para së gjithash me hulumtimin e rreziqeve në një bashkësi të caktuar, ekziston mundësi e madhe për shrytëzimin e teknikave participuese në mjediset lokale. Përvoja në relacion të fasilitirimit të diskutimeve (për shembull me subjektet përgjegjëse për dhënien e paralajmërimeve formale), tregojnë se lojërat participuese gjithashtu paraqesin mjet të dobishëm për mësim në të gjitha nivelet-nga niveli i bashkësisë e deri te subjektet të cilat janë përgjegjës për vendimmarrje dhe politika si dhe donatorë.

Praktikë e mirë:

Në fillim të dhjetorit të vitit 2009, Kryqi i kuq i Senegalit dhe partnerët, në bashkëpunim me qendrën klimatike të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, mbajtën punëtori në Sent L Luis, njërin nga qytetet afrikane i cili është më i ekspozuari pasojave nga ndryshimet klimatike. Midis pjesëmarrësve pati shkencëtarë nga fusha e ndryshimeve klimatike, personel i Kryqit të kuq dhe anëtarë të bashkësive. Sfidë më e madhe ishte përkthimi i prognozave shpeshherë të pakuptueshme dhe të paqarta klimatike në rastin e vendimeve konkrete për menaxhim të katastrofave.

U organizua lojë me karta që të inicohet diskutim dhe debat, mirëkuptim dhe ide të reja. Në këtë lojë u përfshinë prognoza dhe aksione me karta. Pjesëmarrësit punuan rreth 300 karta aksionale, në të cilat u shfaqën ide të reja për përgjigje gjatë katastrofave. Me këtë rast, pjesëmarrësit e prezentuan lojën në bashkësinë e goditur, ku njerëzit vuajnë dhe vdesin nga stuhitë, të cilat pothuajse tërësisht mund të parashihen. Anëtarët e bashkësisë debatuan dhe votuan për marrjen e aksioneve, të cilat i konsideronin se janë më të mira dhe më të përshtatshme për ta në rast të vërshimeve. Loja nuk mund të shpëtojë jetë, por mund të ketë rol të rëndësishëm në gatishmërinë për ballafaqim me rreziqe dhe përgaditjen e përgjigjes përkatëse. Onlajn video : www.youtube.com/watch?v=Mpj_EbKdwEo

Praktikë e mirë:

Kryqi i kuq i Ishujve të Solomoneve përdori qasje krejtësisht inovative për vlerësimin participues për ballafaqim me rreziqe të reja dhe vijuese klimatike, e cila ishte kombinim i mjetit për vlerësim të ndjeshmërisë dhe kapaciteteve të Kryqit të kuq / Gjysmëhënës së kuqe dhe mjet i prognozës botërore të motit i përgatitur për rajonin e Pacifikut. Qëllimi i ushtrimit ishte që të identifikohet ndjeshmëria në bashkësi dhe ndikimi i ndryshimeve klimatike dhe katastrofave si dhe zhvillimi i aktiviteteve për mbulimin e nevojave prioritare dhe forcimin e mekanizmave për përballje.

Praktikë e mirë:

Në Amerikën Latine dhe Karaibe, është përgatitur lojë e quajtur Riesgoland (me përkrahjen e Strategjisë ndërkombëtare për ulien e rreziqeve të Kombeve të Bashkuara – UNICEF – TACRO) me tablo e cila ndihmon më lehtë të mësohen aspektet e ndyshme për katastrofat dhe çka duhet bërë për përgatitje më të mirë para dhe pas ndodhjes së katastrofës. Kjo lojë interaktive, fëmijëve të moshës 8-12 vjeçare ju mundëson të mësojnë për katastrofat natyrore dhe si mundet disa aktivitete të caktuara njerëzore ta zvogëlojnë ndikimin, dhe si mundet disa aktivitete të caktuara ta rrisin ndjeshmërinë.

Loja ishte lehtë e përshtatshme për situatat lokale në vende të caktuara të dhe jasht Amerikave. Në fillim e përgatitur në gjuhën angleze, spanjole dhe portugeze, ajo u përkthye edhe në më shumë gjuhë lokale, si për shembull në gjuhën bengale, kreole, majane, kakiçelo, nepalse dhe papiamento; loja momentalisht përkthehet edhe në disa gjuhë të tjera.

Praktikë e mirë:

Në kuadër të projektit të UNDP “Caktimi në hartë i rreziqeve dhe vlerësimi i menaxhimit efektiv të rreziqeve gjatë katastrofave”, u hartuan 8 harta të rreziqeve për provincat me rrezik të lartë në Laguna, Olongapo, Vigan, Ipokos, Kavite, Rizal, dhe Iloilo.

Elementet fascinuese të diturive lokale nënvizohen gjatë caktimit të rreziqeve kryesore. Dituritë lokale shpeshherë mund të shrytëzohen në kuadër të programeve , më të gjërësishme për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofat, ose sipas nevojës madje mundësojnë edhe rishqyrtimin e disa aspekteve.

Praktikë e mirë:

Koordinuar nga ADPC, u vërtetua se disa aksione të caktuara për gatishmëri janë të lidhura me bestytini në Filipine. Një besim i këtillë ka të bëjë me lidhjen e një sendi në çatinë e ndonjë objekti që të zbrapset era ose të dobësohet tajfuni. Besohet se objekti i ashpër e tërheq rrufenë. Njerëzit besojnë se kur të ndodh kjo, tajfuni dobësohet, kurse shiu pushon.

Elementet e më lartme sollën deri te parimet tejet themelore udhëheqëse, specifike për diturinë për rreziqe karshi paralajmërimit të hershëm.

Parimi udhëheqës për dituri për rrezikun 1:

Edhe pse ushtrimet për diturinë për rreziqe mund të mos rezultojnë me paralajmërim të hershëm, paralajmërimi i përgjithshëm i hershëm duhet të themelohet në dituritë për rreziqe

Pavarësisht se çka do të dalë në sipërfaqe nga dituria lidhur me rrezikun, kjo duhet të lidhet me lloj të caktuar të aksionit. Kjo është me rëndësi për faktin se është investuar në zbatimin e vlerësimit të ndjeshmërisë dhe kapaciteteve apo lloj tjetër i diturisë, në një bashkësi të caktuar, që do të thotë se bashkësia tanimë e ka shprehur nevojën apo dëshirën e fuqishme për një lloj të caktuar intervenimi i cili e ka tërhequr vëmendjen e Kryqit të kuq apo të ndonjë organizate tjetër joqeveritare.

Edhe pse të mësuarit për rreziqe është e vlefshme vetvetiu, për cdo rast ai siguron mundësi për aksione plotësuese në drejtim të zvogëlimit të rrezikut në bashkësi.

Ky aksion mund të jetë në formë të masave të thjeshta për zbutjen e rreziqeve, si për shembull formimi i ekipeve vullnetare për pastrimin e rregullt të kanaleve me qëllim të largimit të bërlllokut dhe gërmadhave për të mos shkaktuar vërshime. Aksioni mund të ndërlihet me zbatimin e stërvitjes së caktuar specifike ose me transferimin e tërë fshatit nga zona e cila në vazhdimësi është e goditur nga vërshimet, në një zonë e cila është e sigurt për jetesë.

Ka raste kur dituria për rreziqe ose ushtrimet për vlerësimin e ndjeshmërisë dhe kapacitetet janë të dokumentuara si diç që ka lidhëshmëri të drejtpërdrejtë dhe instrumentale me zhvillimin e sistemit për paralajmërim të hershëm në bashkësi.

Mund të ketë më tepër raste të padokumentuara të kësaj lidhje të rëndësishme, e cila e tregon lidhshmërinë reciproke me uljen e rreziqeve nga katastrofat.

Praktikë e mirë:

Në Nepal, pas zbatimit të procesit për vlerësimin e ndjeshmërisë dhe kapaciteteve, Shoqata nacionale punoi me fshatarët për hartimin e programeve lokale për ballafaqim me rreziqe lokale, si për shembull stërvitjet. Natyra participuese e procesit dhe dallimit të cilin mund ta bënin njerëzit përmes aktiviteteve të tyre, ju ndihmoi të kuptojnë se katastrofat mund të ndikojnë në katastrofa dhe kësaj mënyre ta zvogëlojnë fatalitetin nga rreziqet.

Parimi udhëheqës i diturisë për rrezikun 2:

Duhet pranuar se prioritetet e bashkësisë nuk do të thotë të jenë edhe prioritetet tuaja

Të kuptohet dhe të cakohet rreziku në nivel të bashkësisë, është mundësi që të depërtohet në perceptimet dhe pikëpamjet lokale. Nëse dikush nuk është anëtar i bashkësisë, këto perceptime shpeshherë vërtetohen si të pabaza ose në kundërshtim me realitetin. Për shembull, mund të ketë informatë se edhe pse qindra njerëz kanë humbur jetën para dy vjetësh në një katastrofë të madhe, po ajo katastrofë sot mund të ketë ndikim të vogël në një bashkësi të caktuar dhe më shumë t'i përkasë ekzistencës ditore të individëve të caktuar.

Nëse edhe krahas këtij dallimi në perceptim, vazhdojmë të punojmë në sferën e vendosjes së sistemit për paralajmërim të hershëm për të njëjtën katastrofë, atëherë kjo mund të mos jetë ushtrim i rëndësishëm apo i arsyeshëm. Mënyra e vetme për zbatimin e këtyre perceptimeve – ku te njëri perceptim prioritet është katastrofa, kurse te tjetri ekzistenca ditore – mbase duhet të jetë përgatitje e masave për përmbushjen e nevojave prioritare në bashkësi.

Aktivitete të cilat duhet të merren parasysh:

- Përkrahje e ushtrimit për fitimin e diturive për rreziqe në bashkësi, pa definimin paraprak të aksioneve të cilat duhet të rezultojnë me aktivitet.
- Ndihmë në hartimin e hartave në të cilat janë shfaqur të gjitha rreziqet e mundshme dhe situatat e ndjeshme si dhe rajonet / objektet të cilat mund të shërbejnë si strehimore, të locuara jashtë zonës së pritur të ndikimit.
- Identifikim në harta i shtëpive të personave apo familjeve veçmas të ndjeshëm.

- Insistim për shfrytëzimin e diturive lokale në vlerësimin e rreziqeve lokale.
- Orientim i bashkësive për përcjelljen e të gjitha rreziqeve dhe ndikimin e tyre (gjeografik, ekonomik etj.).
- Përshkrim i aksioneve të mundshme dhe në pajtim me dituritë individuale për caktimin në hartë të rreziqeve (paralajmërimi i hershëm në nivel lokal mund të jetë njëri prej tyre) dhe mundësimin e bashkësive që të deklarohen se cilin prej tyre e vlerësojnë.
- Integrimi i diturive për rreziqe në legjislativën lokale dhe politikën, po që se tashmë nuk janë të integruara.
- Përsosje e diturive pozitive të cilat janë të pranishme në bashkësi dhe fillim i aktiviteteve për paralajmërim të hershëm.

Komponenti 2 i sistemit për paralajmërim të hershëm

Monitorim

Monitorimi mbindërtohet drejtpërdrejtë në komponentin e parë të sistemit për paralajmërim të hershëm : diturisë për rreziqe. Rreziqet dhe situatat e ndjeshme të cilat janë dhëne si prioritet në ushtrimin për rangimin e rreziqeve në komponentin 1 janë rreziqe më të sigurta ndaj të cilëve bashkësia duhet ti kushtojë vëmendje të veçantë, gjegjësisht duhet ti përcjellë në vazhdimësi.

Monitorimi deri shpejtë konsiderohej si komponent kryesor, e ndoshta edhe i vetëm i sistemit për paralajmërim të hershëm. Nuk befason fakti se nga 4 komponentët, këtij i kushtohet vëmendje më e madhe dhe finansim në nivel global. Për këtë arsye, është bërë progres solid shkencor dhe shumë jetë janë shpëtuar falë monitorimit dhe prognozimit, në kombinim me aktivitetet për gatishmëri.

Praktikë e mirë:

Sukseset në fushën e paralajmërimit të hershëm në mbarë botën kanë të bëjnë falë progresit në fushën e monitorimit të aktiviteteve sizmike dhe monitorimit të aktiviteteve lidhur me stuhitë, që solli deri te dhënia e paralajmërimeve me kohë dhe evakuimeve të suksesshme (edhe pse jo gjithmonë të plota). Shembuj për këtë janë:

- Uragani Gustav më vitin 2008, Kubë
- Tajfuni Krosa më vitin 2007, Kinë
- Uragani Rita më vitin 2005, SHBA (evakuimi më i madh paqësor në historinë bashkëkohore)
- Mali Nuiragongo më vitin 2002, Kongo (erupcion vullkanik)

- Merepi më vitin 2001, Indonezi (erupcion vullkanik)
- Mali Usu dhe Ishulli Mikae më vitin 2000, Japoni (erupcion vullkanik)
- Vullkani në Tavurvur më vitin 1994 (erupcion vullkanik)
- Mali Pinatubo më vitin 1991, Filipine (erupcion vullkanik)
- Hajçeng, Kinë, më vitin 1975 (tërmet).

Praktikë e mirë:

Kryqi i kuq i Nikaraguas në koordinim me Institutin për studime territoriale të Nikaraguas dhe Agjencia zvicërene për zhvillim dhe bashkëpunim zbatojnë monitorimin e aktiviteteve lidhur me promovimin e masave për paralajmërim të hershëm, me qëllim të integritit në planet e bashkësive për përgjigje uraganave dhe vërshimeve. Bashkësitë të cilat janë më të ekspozuara ndaj rreziqeve përkrahen me instrumente matëse dhe mjete komunikimi.

Mirëpo, njëri nga leksionet e mësuara ishte mundësia për integrimin e paralajmërimit të hershëm në kuadër të punës të radiove komerciale. Radioja është mjet mjaft dominues për komunikim në mjediset rurale, dhe në numrin më të madh të rasteve radio është edhe mjeti i vetëm për komunikim. Radioja mund ti transmetojë porositë dhe instruksionet kyç për përgatitje dhe përgjigje si dhe informata bazë për evoluimin e ngjarjeve. Në rastin e alarmimit për uraganin beta në tetor të vitit 2005, roli i mediave ishte me rëndësi të jashtëzakonshme për transmetimin e porosive deri në bashkësitë. Paralelisht me këtë, ekziston mundësia edhe për integrimin e sistemit për paralajmërim të hershëm në radio rrjetet amatore, të cilat janë tejet aktive dhe e ndihmojnë në transmetimin e shumë informatave.

Njëra nga vështërsitë e detektuara është mungesa e protokolëve të standardizuar. Autoritetet nuk kanë informata se cilat bashkësi janë të mbuluara me radio stacione, e as kanë qasje në të gjitha frekuencat dhe radio valët, me qëllim të transmetojnë porosi gjatë situatave emergjente apo katastrofave, dhe gjuhët apo kodet të cilat nevoiten për këtë qëllim.

Monitorimi paraqet aktivitet primar për sigurimin e të dhënave, me qëllim të sigurimit të informatave dhe diturive përkatëse për rreziqet. Tre elementet më të rëndësishme të monitorimit janë: vëzhgimi, matja dhe parashikimi.

- Vëzhgimi paraqet shfrytëzim të syve për percjelljen e situatës në një rreth. Për shembull: mund të përcillet niveli i ujit të një lumi të caktuar.
- Matja paraqet aktivitet me të cilën përshkruhet dhe përcillet procesi i vëzhgimit (regjistrimi i numrave, fjalëve e madje edhe të vizatimeve tejet të thjeshta). Për shembull: mund të regjistrohet numri i matësit të nivelit të ujit në lum.

- Parashikimi, ose prognozimi është ajo që e pritni në të ardhmen, në bazë të trendeve të detektuara dhe të matura. Kjo nënkupton edhe analizë dhe marrëveshje për caktimin e pragjeve matëse, të cilat pasi të arrihen duhet të pasojë aksioni përkatës. Analiza mbështetet në mirëkuptimin lokal për faktorët kontekstual. Për shmebull: në bazë të rritjes së nivelit lumor gjatë periudhës së kaluar dhe të reshurave të kontinuara të shiut, pritet që situata të shkallëzohet për bashkësinë, ndoshta do të nevojitet aksion për mbrojtjen e jetës dhe pronës së njerëzve.

Kjo sërë e masave ndoshta duhet të mbahet mend sipas masave që ndërmerren në tre hapa "SH-R-A": shiko, regjistro, analizo. Të gjithë rreziqet dhe paralajmërimet mund të përcillen në një interval të caktuar kohor. për tërmetet, dhe gjatë rreziqeve të tjera, parashikimet ndonjëherë janë afatshkurta por mund të shpëtojnë jetën në situata tejet specifike, dhe përmirësim i dukshëm në vitet e ardhshme pritet të ketë në sferën e aktiviteteve seizmologjike. Më së shpeshti rreziqe të vëzhguara të cilat drejtpërdrejt përcillen nga bashkësitë janë vërshimet, thatësirat, rrëshqitja e tokës dhe më së shpeshti aspekti i konflikteve. Teknika të caktuara për monitorim janë të pasqyruara në tabelën e mëposhtme¹⁰, me shembuj të praktikës së mirë dhe leksione të mësuara nga gjithë bota.

Tabela 10: Monitorimi i drejtuar drejtpërdrejt nga bashkësitë

Instrumentet më të shpeshta për monitorim/ treguesit e rreziqeve:	Praktikë e mirë	Leksioni i mësuar
VËRSHIME <input type="checkbox"/> Matës të nivelit të shiut <input type="checkbox"/> Matës të nivelit të ujit të lumenjve	Kryqi i Kuq i Kamboxhias : Marker për matjen e vërshimeve-projekt për monitorim lokal të lumenjve përmes përdorimit të matësve.	Nepal: Vërshimet si rezultat i liqeneve glaciale janë rrezik për regjionin, dhe është shumë vështirë të parashikohen, mirëpo janë duke u bërë përpjekje për implementimin e sistemit për paralajmërim të hershëm.
THATËSIRA <input type="checkbox"/> Matës të nivelit të shiut <input type="checkbox"/> Gjendja e bagëtisë <input type="checkbox"/> Çmim <input type="checkbox"/> Niveli i ujit sipërfaqësor <input type="checkbox"/> Gjendja e të mbjellurave	Oksfam Vietnam hulumton mënyrat për bartjen e rezultateve të suksesshme nga ballafaqimi me vërshimet nëpër fusha si dhe me ballafaqimin me thatësi përmes emetimit të radio porosive.	Kamboxhia: pas 16 viteve me thatësi pas vitit 1982 në provincën Cvei Rieng, shoqatat nacionale u përkushtuan për masa me të cilat involvohen bashkësitë për sjelljen e vendimeve për përmirësimin e parashikimit të kushteve klimatike.
RRËSHQITJA E TOKËS <input type="checkbox"/> Matës të nivelit të të rreshurave <input type="checkbox"/> mbulueshmëria me	Nepal: Proekt i finansuar nga EHCO mundëson identifikimin e tre treguesve për matjen e rreziqeve. me instrument të thjeshtë ju ndihmon bashkësive të kuptojnë arsyet dhe rreziqet dhe të jenë të përgatitur. Indonezi: janë të siguruara sirena të	Sri- Lankë: rrëshqitja më e tmerrshme e tokës në 50 vitet e fundit ndodhi në vitin 2003, me çka goditi më shumë se gjysmë milion banorë. Nuk pati kurrfarë paralajmërimi për fatkeqësinë.

vegjetacion <input type="checkbox"/> Kullosat	thjeshta për përcjelljen dhe alarmimin në pesë provinca të vendit.	
KONFLIKTE • kriminal • çmime • shitja e bagëtisë	Sri -Lankë: janë të vendosura 30 lokacione për monitorim në nivel lokal për përcjelljen e situatës në zonat e konfliktit.	

Monitorimi është komponent i sistemit për paralajmërim të hershëm, i cili është ngusht i lidhur me shkencën. Të dhënat dhe informatat e dobishme për rreziqet e mundshme duhet të jenë fuqimisht të mbështetura me njohuri shkencore. Gjatë disenjimit të aktiviteteve për monitorim është e rëndësishme involvimi i subjekteve dhe autoriteteve të ndryshme nga bashkësia, të cilët kanë njohuri shkencore për rrezikun, rrethin lokal dhe mënyrën më të përshtatshme për monitorimin e drejtë të situatave në rajon.

Për vërshimet nevojitet dialog me ndonjë hidrolog lokal; për thatësit me meteorolog; për epidemi me mjek; për konflikte me nëpunës policor apo oficer ushtarak. Poashtu, është e rëndësishme që institucionet qeveritare që mbledhin të dhëna relevante të kenë mandat dhe kapacitet për këmbimin dhe pranimin e diturive për rreziqe, si pjesë e përgjegjësisë të tyre për monitorim. Kjo nuk do të thotë se vetëbashkësitë nuk kanë mundësi që aktivisht ta orientojnë dhe të marrin pjesë në procesin e monitorimit.

Me qëllim të sigurimit të ekzistencës së njerëzve, çdo njeri në bashkësi bën monitorim të vet spontan cilësor. Bujqit e dinë se kur keqësohet situata me të mbjellat; tregtarët e shohin kur zvogëlohet shitja e mallrave; peshkatarët e dinë kur zvogëlohet sasia ditore e të zënit peshq dhe të gjithë ata mendojnë se një pjesë e shkaqeve janë situatat në natyrë dhe rrethinë.

Gjithashtu, të gjithë ata që kanë përjetuar ndonjë katastrofë ose kanë humbur dikë apo diçka me rastin e katastrofës, automatikisht i përcjellin situatat të cilat mund të shkaktojnë katastrofë të ngjashme. Në vend që të bazohet në shkencë, kjo formë e monitorimit bazohet në përvojat e padokumentuara jetësore, shpeshherë nga përvojat e më tepër gjeneratave.

Është me rëndësi të madhe që këto përvoja dhe dituri të shfrytëzohen gjatë disenjimit të sistemit për paralajmërim të hershëm. Në kombinim, monitorimi i cili bazohet në përvoja dhe monitorimi shkencor duhet të paraqesin kombinim fitues.

Aktivite të cilat duhet hulumtuar

- Shqyrtimi i sistemit të njohurive të bashkësive të ekspozuara ndaj rrezikut me qëllim identifikimi të mënyrave përmes të cilave bëhet monitorimi me ndihmën e përvojave dhe treguesve të cilët bashkësia i përcjell në mënyrë spontane dhe vepron në bazë të tyre.
- Krahasimi dhe përshtatja e këtyre treguesve me treguesit shkencor.
- Përshtatja e monitorimit lokal në sistemin nacional për paralajmërim të hershëm si dhe përshtatja dhe inkorporimi në kornizën regulative ligjore, nëse kjo akoma nuk është bërë.

Leksion i mësuar:

Në rajonin jugperëndimor të brigjeve të Bangladeshit, pas sulmit të ciklonit Sidr më 15 nëntor të vitit 2007, u vërtetua se popullata e goditur nuk është përgjigjur si duhet në parashikimet për ciklonin, edhe përkundër faktit së janë dhënë sinjale të fuqishme. Kjo ka ndodhur si rezultat i asaj që popullata nuk është ballafaquar me ciklon të tillë që nga viti 1970 dhe nuk i ka besuar paralajmërimit. Gjatë ciklonit Sidr, pjesa më e madhe e familjeve të sulmuara i kanë braktisur vendbanimet e tyre, pasi kanë konstatuar se uji është duke ardhur.

Praktikë e mirë:

GOAL/Malavi (projekt i financuar nga ECHO dhe DIPECHO) kishte për qëllim t'i hulumtojë dhe dokumentojë sinjalet për paralajmërim të cilat i njohin dhe përdorin bashkësitë dhe u angazhuan shkencëtar për t'i shqyrtuar dhe arsyetuar ose hedhur poshtë, varësisht nga arsyetimi i tyre i bazuar shkencor.

Ky komponent zbatohet përmes katër parimeve udhëheqëse:

Parime udhëheqëse për monitorim 1:

Pranuesit pasiv të informatave nuk janë shpëtimtarë

Në shumë raste, thuajse çdoherë në vendet e zhvilluara, monitorimin e realizojnë teknikë apo shkencëtarë në nivel qendror (global, rajonal apo nacional). Më së shpeshti, subjekti i cili e zbaton monitorimin shkencor për rreziqe që mund ta sulmojnë ambientin jetësor, është Enti nacional meteorologjik. Në përgjithësi, shërbimet e "Entit nacional meteorologjik" , zbatohen me ndihmën e teknologjisë së lartë (si p.sh. fotografi satelitore) me matje nga lokacione të ndryshme (si p.sh. stacione bazë të automatizuara).

Informatat e mara analizohen, përpunohen dhe përcillen deri te njerëzit të cilët janë të ekspozuar ndaj rrezikut ose nga ndonjë katastrofë, dhe në rrethana ideale duhet t'ju ndihmojnë bashkësive të përgatiten në kohë për të marë aksione të duhura. Ky është një shembull tipik i paralajmërimit, më pak ose më shumë janë pranues pasiv të produkteve për monitorim.

Me qëllim që sistemi për paralajmërim të hershëm të llogaritet për lokal, nevojitet së paku një nga katër komponentët për paralajmërim të hershëm të jetë "aktive" brenda bashkësisë. Në bazë të definicionit, sistemi lokal për paralajmërim të hershëm (shih në kapitullin e parë), nëse bashkësia nuk i regjistron informatat, duhet së paku të ketë mundësi t'i analizojë informatat e marra nga jashtë. Nëse bashkësia është e varur nga monitorimi i informatave të marra nga jashtë, shumë është e rëndësishme që ata të cilët i pranojnë informatat të kenë ndjenjën se i posedojnë të njëjtat.

Analiza çon nga përkatësia e gjërave. Në tabelën 11 janë pasqyruar përpjekjet në gjithë botën, të cilat bëhen për t'u dëshmuar ekzistimi i monitorimit aktiv ose të paktën analiza aktive e monitorimit të informatave nga ana e atyre që janë pranues primar të informatave në nivel të bashkësisë.

Tabela 11: Subjekte aktive të cilët bëjnë monitorim dhe/ose pranues primar të informatave nga monitorimi i paralajmërimit të hershëm (praktikë e mirë)

Vendi	përgjegjës për vëzhgim ose për marrje initiale të informatave	rrezik dhe përshkrim	financues/OJQ
Sri -Lanka	Familje për vëzhgim	cunami	JICA
Kinë	vullnetarë për të përcjellje rreziqeve gjeologjike	Rrëshqitje e tokës	Qeveria
Indi	vëzhgues	Vërshime	Qeveria

Australi	lexues të matësve të burimeve	Vërshime	Qeveria
Nepal	lexues të matësve	Vërshime	Aksion praktik
SHBA	vëzhgues të parashikimit të motit	Stuhi dhe vërshime	NOAA/FEMA Qeveria
OK	përgjegjës për vëzhgimin e vërshimeve nga fqinjësia	Vërshime	Personale ose Qeveria

Aktivite të cilat duhet hulumtuar:

- Të vërtetohet se a janë duke u përcjellur informatat për rreziqet në rajonet e caktuara dhe a janë të identifikuar në mënyrë adekuate rreziqet nga ana e bashkësisë.
- Urë midis personave përgjegjës nacional dhe zyrtarë për paralajmërim të hershëm (teknikë që zbatojnë monitorim ose shkencëtarë) dhe bashkësisë:

- Dhënie e sqarimeve deri tek bashkësia për informatat nga monitorimi i siguruar në nivel lokal dhe çka bëhet me ato informata nga shkencëtarët.
- Nisja e dialogut me autoritetet dhe shkencëtarët lidhur me informatat që përcillen dhe përputhshmëria e tyre me rreziqet me të cilat ballafaqohen bashkësitë.

Kërkesa e bashkësive për të gjetur mënyra për përforcimin dhe avansimin e montorimit, në nivel të bashkësisë:

- Plotësimin e zbrazëtirave dhe mungesës përmes implementimit të stacioneve të reja bazë për matje të lidhura me sistemin për paralajmërim të hershëm, i menaxhuar nga ana e bashkësive.
- Identifikimi i pranuesve primar të informatave në nivel të bashkësive, roli i të cilëve është të pranojnë informata nga monitorimi i rrjedhës së lumit përgjatë fshatrave, ose pranimi nga autoritetet nacionale për të vepruar dhe analizuar në përputhshmëri me informatat e marrura para se të zyrtarizohet paralajmërimi.
- sigurimi i trajnimit të marrësve primar të informatave si dhe mënyra se si të analizohet monitorimi i informatave i marrë nga bashkësitë, në mënyrën më të mirë të mundshme.

Praktikë e mirë:

Kiogani është Organizatë joqeveritare nga Indonezia, e cila siguron informata shkencore për Qeverinë dhe ju ndihmon autoriteteve lokale në fushën e përcjelljes së informatave për gjendjet dhe identifikimin e rajoneve të rrezikut. Kjo organizatë, gjithashtu ka ndihmuar që informatat të mbërrijnë deri tek bashkësitë. Kjo u testua gjatë tërmetit që ndodhi në vitin 2010 kur popullata dinte si duhet të veprojnë dhe u evakuua në territoret ku u dha paralajmërimi.

Parime udhëheqëse për monitorim 2:

Disa bashkësi duhet të përgatisin sisteme personale për paralajmërim të hershëm

Disa bashkësi duhet të përgatisin sisteme personale për paralajmërim të hershëm. Edhe përkundër nivelit të lartë të përpjekjeve për ndërtim dhe mirëmbajtje të sistemit për paralajmërim të hershëm në bashkësi, ekzistojnë situata të shumta kur monitorimi është i pashmangshëm që të bëhet në bashkësi. Këtu hyjnë situatat në vijim:

- mosekzistimi i sistemit nacional për paralajmërim të hershëm dhe/ose i ndonjë subjekti tjetër siç është Enti meteorologjik.
- kur sistemi nacional për paralajmërim të hershëm apo institucioni përgjegjës për menaxhim nga rreziqet/katastrofat nuk është në gjendje të sigurojë paralajmërim të qarta dhe në kohë deri të bashkësitë e ekspozuara në rrezik.
- Kur rreziqet janë të lokalizuara dhe kur as sistemet nacionale për paralajmërim të hershëm nuk kanë mundësi të marrin sinjalin (p.sh. vërshim ku matësi më i afërt është në largësi prej 10 km; rrëshqitja e tokës pas aktivitetit sizmik; rrëshqitja e baltës si rezultat i degradimit të pyjeve; të rreshurat e fuqishme lokale).
- Kur sistemi për paralajmërim të hershëm apo subjektet kompetente të cilitdo nivel sigurojnë informata të nevojshme të cilave bashkësitë ju besojnë lehtë.
- kur aktivitetet për zbutje të katastrofave ose komunikimit janë të mjaftueshme për mbrojtje të bashkësive. Në disa situata, përforcimi i bashkësive si p.sh. për pastrim të rregullt të kanaleve nga mbeturinat është i mjaftueshëm për t'u parandaluar vërshimi i bashkësive. Në këtë rast inkorporimi i sistemit për paralajmërim të hershëm nuk do të jetë i dobishëm.

Pa marrë parasysh se çka u tha më lart, bashkësitë duhet të jenë të motivuara për mbrojtjen e jetës dhe pronës së njerëzve në bashkësitë nga rreziqet përmes inkorporimit të mjeteve dhe aktiviteteve për monitorim.

Për secilin nga rastet e përshkruara më lart, bashkësitë duhet të përkrahen jo vetëm ti marrin mesazhet dhe të veprojnë sipas tyre (kur ato ekzistojnë), por dhe të mundësojnë pjesëmarrje aktive për ti përcjellur situatat të cilat në afërsi të bashkësive. Vetëm në këtë rast do të kemi sistem të vërtetë për paralajmërim të hershëm i cili do të lëviz nga bashkësia kah niveli nacional.

Praktikë e mirë:

Në Karaibe dhe në Amerikën Qendrore, sistemet për paralajmërim të hershëm nga vërshimet sigurojnë matës të lirë për matjen e nivelit të ujit në disa bashkësi. Me këto mjete të thjeshta për monitorim mund të përcillet niveli i vërshimit pa qenë të informuar paraprakisht për rreshjet e mundshme. Kjo aparaturë ka disa përparësi, sepse është e lidhur automatikisht me llambat e shtëpive të njerëzve kompetent për lexim të inoformatave dhe përmes këtij sistemi mundësohet monitorimi 24 orësh i situatës. Kjo do të thotë se nuk ka nevojë personi të jetë në shtëpi që ta përcjellë situatën veçanërisht kur ka rreshje të mëdha. Një nga gjërat më të mira është që sistemi mundëson telefonim automatik dhe alarmim të lexuesit të matësit. Aktiviteti është i koordinuar nga Qendra për menaxhim me kriza të Karaibeve, me përkrahje të JICA dhe të Universitetit Indiano-Perëndimor në Trinidad dhe Tobago.

Aktivitete të cilat duhet hulumtuar:

Shqyrtimi i situatave me qëllim konstatimi se sistemi lokal për paralajmërim të hershëm është opcioni më adekuat për zvogëlimin e rreziqeve në bashkësi. Nëse ekziston enti meteorologjik ose sistemi nacional për paralajmërim të hershëm, duhet konsultuar dhe duhet kyçur në sistem.

Caktoni anëtarë të bashkësisë të cilët kanë marrë pjesë në stërvitjet për paralajmërim të hershëm dhe që mendojnë se është në dobi të ekzistojë sistemi lokal për paralajmërim të hershëm. bashkë përcaktoni nivelet e rreziqeve/frekuencës së rreziqeve dhe numrit të vullnetarëve të interesuar që do të marrin pjesë në këto aktivitete në nivel lokal.

Formoni komitete për paralajmërim të hershëm në nivel lokal, si p.sh. Komitet për zhvillim të bashkësisë ose Komitet të fshatit për gatishmëri gjatë katastrofave.

- Organizoni trajnime për paralajmërim të hershëm për vullnetarët, ku do të diskutohen treguesit të cilat do të përcillen nga ana e bashkësisë për identifikimin e ndonjë rreziku më të rëndësishëm. trajnimi duhet të inkorporojë module për komponentat e sistemit për paralajmërim të hershëm (shih kapitullin D).

Praktikë e mirë:

FARM Afrikë, është qasje që ka për detyrë identifikimin e grupeve në Etiopi, përgjegjëse për grumbullimin e informacioneve për paralajmërimin e hershëm dhe përgjigje në rast katastrofash. Asnjë nuk merret me bujqësi pa lejen e Gudas, i cili lutet për shi tek Zoti para të korrurave. Donzasi, nga ana tjetër, janë pleqtë të cilët japin këshilla në rast të katastrofave. Ata janë parashikues tradicional të cilët japin këshilla për bashkësinë (në bazë të lokacionit të yjeve etj.) Për shkak se bashkësia e Hamerëve fuqishëm beson në këto institucione tradicionale, ajo i përcjell vendimet e pleqve dhe ato bëhen pjesë e komiteteve për paralajmërim të hershëm.

Parime udhëheqëse për monitorim 3:

Aktivitetet publike për monitorim mund t'i motivojnë bashkësitë

Përcjellja e informacioneve për monitorim është me rëndësi, me qëllim të detektimit të trendeve. Analiza e rregullt e trendeve ndihmon në parashikimin, gjë që ndihmon në dhënien e paralajmërimeve të caktuara. Një nga mënyrat e shpalljes së trendeve të detektuara përmes sistemit për paralajmërim të hershëm është ato të shpallen publikisht.

Shpallja e informacioneve nuk do të thotë shpallje e paralajmërimit, por shërben si përkujtues ditor se informacionet mund të jenë ndryshim i madh. Bilbordet dhe posterët në lokacione publike të cilat përmbajnë informacione për paralajmërim të hershëm janë udhëzues për këto ndryshime. Anëtarët e bashkësisë të cilët asnjëherë nuk kanë qenë pjesë e trajnimeve për përvetësimin e aftësive lidhur me rreziqet dhe monitorimin e tyre, janë të interesuar për marrjen e këtij lloji informacionesh.

Këto bilborde mund të jenë të thjeshta, si p.sh., në formë të numrave të shkruara para ndërtesës së komunës. Nëse ka qasje në më tepër burime, përreth tregut mund të vendosen tabela ose shenja tjera në qytet për t'u shkëmbyer informacione të ndryshme lidhur me rreziqet e ndryshme.

Aktivite të cilat duhet hulumtuar:

- Duhet vendosur cilat indikatorë ose informacione të marra nga burime të jashtme duhet t'i përcjellë komitetit/ekipi, dhe ato është e nevojshme të përcillen në publik.
- Bisedoni çfarë ndikimi mund të arrihet përmes shfaqjes së këtyre informacioneve në bashkësi dhe përcaktoni mënyrën se si do të matet ndikimi i tyre.
- Përcaktoni cilat materiale janë me interes të madh lokal për përgatitjen e tabelave për shpallje dhe loboni ose siguroni mjete të nevojshme.
- Përcaktoni radhitjen e detyrave për vullnetarët dhe qeveritarët lokalë në lidhje me sigurimin dhe shpalljen e informacioneve.

Praktikë e mirë:

Kryqi i Kuq në Siera Leona, përmes sistemit për paralajmërim të hershëm përcolli dy rreziqe dhe situata të ndjeshme në flip chart tabela, të cilat ishin të vendosura në lokacionet qendrore nëpër fshatra.

Praktikë e mirë:

Kryqi i Kuq i Kamboxhias, implementoi projektin për radio komunikim të dyanshëm, me anë të st cilit vullnetarët e Kryqit të kuq dërgonin të dhëna për nivelin e lumit deri tek popullata. Ky projekt përfshiu 38 fshatra të selektuara në bazë të ndjeshmërisë së tyre nga vërshimet, afërsia e tyre deri tek stacionet matëse, prezenca e vullnetarëve dhe interesi që shfaqin qeveritarët lokalë dhe bashkësitë.

Nëpër fshatra vendosen bilborde me mbishkrim: “dje”, “sot”, “nesër”, “pasnesër”. Parashikimet i jep Enti i hidrologjisë. Bashkësitë alarmohen në rast të rritjes së nivelit të ujit të lumenjve. Ky sistem për paralajmërim të hershëm paraqet shembull pozitiv dhe si i tillë është inkorporuar në Startegjinë ç[r zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofat në Kryqin e Kuq të Kamboxhës.

Praktikë e mirë:

Në Mallagazi, Këshilli nacional dhe organizata KEAP, formuan sistem lokal për paralajmërim të hershëm në Madagaskar. Qeveritarët lokalë selektuan indikatorë lokal dhe përgatitën tabela ,të cilat u vendosën në lokalitete publike ku evidentoheshin indikatorët aktual.

Parime udhëheqëse për monitorim 4:

Kur rreziqet evoluojnë, nevojitet monitorim

Në erën e ndryshimeve të mëdha klimatike, ashtu siç ndryshojnë informacionet për rreziqet, ndryshojnë dhe informacionet lidhur me monitorimin e gjendjeve. Pas secilës sezon ose ndodhi të lidhur me ndonjë rrezik, e rëndësishme është që ekipi/komiteti përgjegjës për paralajmërim të hershëm t'ju rikthehet informacioneve të grumbulluara dhe të bëjë analizë të kaluarës.

Pyetje të cilat duhet parashtruar:

- A mund të sigurojnë aksion të menjëhershëm dhe në kohë indikatorët të cilët përcillen?
- A janë të instaluara në vende të duhura dhe a janë funksionale instrumentet për monitorim?
- Sa është e dobishme dhe adekuate analiza e bashkësisë, në drejtim të marrjes së mesazheve që vijnë nga jashtë?
- Sa janë adekuate pragjet e caktuara të cilat përdoren për inicimin e akcioneve ose dhënien e paralajmërimeve?
- Sa shpallja e informacioneve nga monitorimi në publik i ka arsyetuar qëllimet? Çka mund të bëhet në këtë plan për t'u përmirësuar rezultatet? Kush tjetër është i nevojshëm që ti marrë këto rezultate?

Leksion i mësuar:

Ndodhën vërshimet në Australi. Me rëndësi të veçantë është të bëhet evolimi i gjendjes dhe katastrofës. Në vitin 1970 u implementua norma për nivel të ulët të vërshimit, me çka u paraqit nevoja për mbylljen e urës që kalon mbi lum. Më vonë ura u zëvendësua me ndërtim më të lartë, por norma e implementuar për lartësinë e nevojshme të nivelit të lumit për t'u shpallur gjendje e vërshimit ngeli e njejtë deri në vitin 2000.

Kjo ishte rezultat i paralajmërimeve për rrezik nga vërshimet, i dhënë nga Agjencia për parashikim, të cilat nuk ishin në përputhshmëri me situatën reale, për çka dhe bashkësia nuk i ka marrë në konsideratë. Po të ndodhte vërshim i përmasave më të mëdha, bashkësia sërish nuk do t'i merrte në konsideratë paralajmërimet, duke i pasur parasysht normat standarde nga aspekti i vërshimit të zonave.

Në këtë doracak monitorimi është i veçuar nga komunikimi, sepse aftësitë dhe mjetet që ju duhen për të përcjellur rreziqet janë shumë të ndryshme nga aftësitë dhe mjetet e nevojshme për dhënien e paralajmërimit (komponenti 3). Një njeri i caktuar i cili është i aftë për vëzhgim, matje dhe analizë të informacioneve, mund të mos i ketë kapacitetet e nevojshme për komunikim të paralajmërimit, dhe anasjelltas. Në mënyrë paralele, instrumentet të cilat përdoren që përdoren për matje nga vërshimet gjatë monitorimit të aktiviteteve, nuk janë të njëjta me ato që përdoren për përcjelljen e mesazheve për paralajmërim.

Komponenti 3 i sistemit për paralajmërim të hershëm

Aftësi për t'u përgjigjur

Nëse sistemi për paralajmërim të hershëm është vendosur si duhet dhe në mënyrë figurative paraqet trupin e njeriut, aftësia për tu përgjigjur janë duart dhe këmbët: duart ndihmojnë që të përgatitet për rrezikun, ndërsa këmbët e çojnë trupin më larg katastrofës. Përmirësimi i gjendjes së trurit dhe sinjalet të cilat ai i dërgon (lidhur me rreziqet dhe monitorimin) pa qenë të përgatitur duart dhe këmbët, nuk është në dobi të bashkësisë. Në këtë kapitull bëhet fjalë si duhet përgatitur duart dhe këmbët e sistemit.

Pyetja e parë tek aftësia për t'u përgjigjur është: **“Për çka dhe në cilin drejtim është orientuar pyetja jonë?”**

Parime udhëheqëse për aftësinë për përgjigjen numër 1

Tek sistemet për paralajmërim të hershëm duhet siguruar përgjigje ndaj paralajmërimit të hershëm, e jo ndaj karastrofave

Bashkësitë duhet të jenë të gatshme të përgjigjen atëherë kur rreziku mund të shëndërohet në realitet. Këtu përgjigja ka të bëjë me paralajmërimin, e jo me katastrofën. Mbani mend që katastrofat mund të shmangen, ndërkaq sistemi për paralajmërim të hershëm është mjet i cili ndihmon në shmangien e tyre. Duhet të jemi të përgatitur të përgjigjemi që në momentin kur kuptojmë se kanoset rreziku ose përgatitet të ndodhë ndonjë ngjarje e rrezikshme. Paralajmërimi i hershëm shërben si alarm dhe na bën me dije të marrim parasysh disa opsione të cilat janë organizuar nga ana jonë.

Kapaciteti për t'ju përgjigjur, nënkupton aksionet të cilat kanë të bëjnë me përgatitjen ose me uljen e ndikimit të rrezikut ose katastrofës. Bashkësia llogaritet “ e përgatitur për përgjigje”, atëherë kur di, ka ushtruar dhe ka mjete për të organizuar aksione adekuate për përgjigje.

Para se të fillojë të përdoret termi ulje e rrezikut nga katastrofat, shumë praktikienë ishin të fokusuar në sigurimin e përgjigjeve në rast katastrofash. Ndiha gjatë katastrofave, rehabilitimi dhe rekonstruimi, përmbajnë aspekte të përgjigjeve gjatë katastrofave.

Ekzistojnë shumë mjete dhe mekanizma për përgjigje në rast të katastrofave. Ky doracak ka një qëllim tjetër: të parandalojë katastrofat përmes paralajmërimit të hershëm, me çka përgjigja në rast katastrofash bëhet më pak e nevojshme. Tek paralajmërimi i hershëm, përgjigjemi ndaj paralajmërimit për t'ju shmangur katastrofës.

Çështja e dytë kryesore për sa i përket aftësisë për përgjigje është "Cilat janë mundësitë standarde për përgjigje pasi të kemi marrë ose dëgjuar

paralajmërimin?" Përgjigja varet shumë nga rreziku dhe nga periudha në mes paralajmërimit nga rreziku, dhe momentit kur ndodh rreziku.

Mënyra më efektive për t'iu përgjigjur kësaj pyetje është të kryhet një stërvitje e tillë si ato të organizuara nga Federata Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe, në çfarëdo niveli (në bashkësi ndërmjet personelit përgjegjës për menaxhimin e rreziqeve /katastrofave, nivelin e zyrtarëve oficial që janë bartës të politikave dhe legjislacionin në nivel të donatorëve). Të ju përkujtojmë se, parimi udhëheqës numër 6 në Kapitullin 2 ka të bëjë me kohën e nevojshme në të cilën paralajmërim duhet të jepet për të siguruar një përgjigje. Qëllimi i këtij ushtrimi është të theksojë nevojën për të menduarit sistematik mbi atë që mund ju dhe njerëzit rreth jush të bëni brenda 6 muajsh, 10 ditëve ose 12 orëve. Çka mund të bëni ju dhe njerëzit rreth jush sot nëse kuptoni se do të ndodhë vërshim i shtratit të lumit për 1 vit, disa muaj, një javë, 8 orë ose brenda 15 minutash?

Tabela 12: Përgjigje në periudha të ndryshme kohore

<p>Të plotësohet nga bashkësitë</p> <p>Kohë e nevojshme për përgjigje si rezultat i porosisë</p>	<p><input type="checkbox"/> Porosia për paralajmërim të hershëm është</p>	<p><input type="checkbox"/> Aksione të hershme adekuate të cilat janë të realizueshme sot</p>	<p><input type="checkbox"/> Aksione të cilat janë të mundura me anë të përkrahjes</p>
<p>Vjet</p>			
<p>Muaj</p>			
<p>Javë</p>			
<p>Ditë</p>			
<p>Minuta (tash)</p>			

Kjo stërvitje rekomandon të përgatitet nga një tabelë për çdo lloj rreziku sipas shembullit të tabelës 12. Shembull për përpilimin e tabelave të tilla mund të gjenden në aneksin (për ciklone, vërshime të lumenjve, thatësira, cunami, vullkane si dhe vërshime nga të reshurat).

Të menduarit sistematik lidhur me aktivitetet për përgjigje ndaj rreziqeve potencial, në nivelin tuaj, pa burime plotësuese (kolona 2) është qëllimi kryesor i këtij komponenti. Kolona 3 jep udhëzime lidhur me programe në të ardhmen për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofat. Stërvitja mund t'ju ndihmojë praktikienëve çdo nivel lidhur me përgatitjen dhe lobimin për sigurimin e intervenimeve adekuate (për të cilat mund të nevojitet përkrahje) në periudha të ndryshme kohore me qëllim bashkësitë të jenë më të sigurta, si psh. implementimin e disa infrastrukturave të caktuara ose zgjidhjeve teknologjike në përputhshmëri me nevojat.

Meqë kjo stërvitje mund të jetë e dobishme për gjithë bashkësinë, zgjidhja më e mirë është që ato vetë t'i plotësojnë formularët, pa kurrfarë paragjykimi për përgjigjet që do t'i japin (ndoshta do të ishte mirë menaxhuesit për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofat të plotësojnë kolonën e cila ka të bëjë me paralajmërimin e hershëm). Sidoqoftë, paraqitet nevoja për dhënien e instruksioneve gjatë dhënies së përgjigjeve lidhur më rangimin ose përputhshmërinë, si dhe të ndihmohet gjatë kufizimit të parashikimit se gjëra të caktuara mund të ndodhin ose të realizohen.

Zbatimi i kësaj stërvitjeje me bashkësitë mund të ofrojë shumë zgjidhje inovative për t'u përballur si dhe përgjigje për zbutjen e dëmeve dhe humbjeve. Pasi të përcaktohen opsionet për përgjigje, aktivitetet për trajnim si dhe shfaqjen e informacioneve në publik, njerëzit do të mundën më mirë dhe më qartë t'i mendojnë rreziqet si dhe të ofrojnë kontribut adekuat për të gjetur zgjidhje të përshtatshme.

Pastaj mund të zbatohen aktivitete të thjeshta për zbutjen e gjendjes në nivel të bashkësive (me periudha të caktuara kohore për alarmim (në kohëzgjatje prej disa orëve ose edhe më gjatë), për përforcimin e brigjeve të lumenjve me rërë (gjatë vërshimeve), vënien e sendeve të rënda mbi çati (gjatë stuhive), adaptimin e materialit ndërtimor rezistentë ndaj ujit (gjatë rreshjeve të mëdha), si dhe pastrimin e mbeturinave nga kanalet nëpër vendbanime (për të kufizuar rreziqet nga vërshimet dhe zjarret). Vënia e rezervuarëve me ujë të pijshëm mbi nivelin e vërshuar, për të mos u kontaminuar, paraqet edhe një sfidë plus.

Praktikë e mirë:

Kryqi i kuq i Kamboxhias ka ndihmuar fshatarët në krahinat Kandal, Cartier dhe Prei Wong për të ngritur nivelet e shtëpive dhe mallrave dhe për t'i zhvendosur ato që të jenë më të sigurta dhe të mbrojtura nga përmbytjet që priteshin në vitin e ardhshëm. Fshatarët nuk mendonin për ngritjen e nivelit të tokës përgjatë brigjeve të lumenjve deri në fillim të projektit për shpërndarjen e metodave të thjeshta për t'u përgatitur për mbrojtjen nga përmbytjet.

Sistemi për paralajmërim të hershëm duhet të shërbejë si një mjet për të siguruar përgjigje kthyes nga banorët e komunitetit; varësisht nga konteksti kulturor kjo mund të jetë një kuti për propozime, kontakt formular i postuar në internet ose thjesht grumbullim i të dhënave nga programet shkollore të nxënësve (p.sh. vullnetarët mund të organizojnë aktivitete me nxënësit përmes të cilave mund të mblidhen informacione si detyrë shtëpie).

Aktivitete që duhet hulumtuar:

- Përgatisni formular- tabelë për secilin rrezik sipas shembullit nga tabela 12 (plotësoni kolonën nr.1 për paralajmërim të hershëm me mesazhe adekuate).
- Organizoni takim në nivelin tuaj (institucion apo komunitet) dhe punoni në grupe të vogla për t'i plotësuar formularët, një grup për çdo rrezik.
- Jepni kohë që të shqyrtohet secila ide; mos i hedhni poshtë idetë pa i diksutuar paraprakisht.
- Kyçni në dikskutim dhe fëmijët, të moshuarit si dhe studentët. Ky lloj aktiviteti mund të jetë interesant për secilin dhe ata mund të jenë më kreativ se të rriturit dhe janë burim i mirë i zgjidhjeve inovative. Nëse është e nevojshme, stërvitjen bëjeni veçmas për burra, veçmas për gra, nëse natyra e stërvitjes e imponon këtë.

Ndodh që kjo stërvitje të ofrojë më tepër aksione të ndryshme, dhe është vështirë për t'i ndarë të dobishmet nga më pak të dobishmet, ose për të vepruar sipas prioritetit.

Parime udhëheqëse për aftësinë për përgjigjen numër 2

Tendenca për të organizuar aktivitete robus për përgjigje

Termi robusten, në zhargonin e përditshmërisë dmth. i fuqishëm. mirëpo, në shkencë ka një përdorim dhe kuptim më të gjërë.aktivitetet për përgjigje të fortë ndaj paralajmërimit të hershëm, janë të dobishme, edhe nëse fatkeqësia nuk ndodh siç është planifikuar (për shembull paralajmërim i rremë). Investimi në aktivitete të tilla nuk përmban rreziqe, sepse veprimet e ndërmarra mund të shërbejë për një qëllim tjetër.

Fuqia gjithashtu dmth. më tepër veprime që janë të përbashkëta për t'u zbatuar (dhe të cilat mund të jenë të dobishme) gjatë rreziqeve të ndryshme. Përpjekjet për të ndërruar aktivitete rast të rreziqeve të veçanta janë të dobishme edhe gjatë një alarmi të rremë. Sigurisht, duhet dhënë përparësi aktiviteteve që mund të shërbejë për qëllime të shumta. kjo është dhënë në shembujt e dhënë më poshtë:

Praktikë e mirë:

Në Antigua dhe Barbuda, Plani nacional për gatishmëri gjatë katastrofave (www.oas.org/cdmp/schools/anbplan.htm) është pjesë e përpjekjeve të përgjithshme të kombit për të forcuar aftësinë për të reaguar në raste urgjente. Shkollat janë përdorur si strehimore gjatë fatkeqësive kështu që ato duhet përmbushur standardet minimale. Plani është përgatitur në kuadër të përpjekjeve për të përfshirë komunitetet në vlerësimin e ndjeshmërisë, implementimin e një kornizë të përshtatshme ligjore, dhe mirëmbajtjen e objekteve që përdoren nga fëmijët në përditshmëri si dhe në rast të fatkeqësive.

Praktikë e mirë:

ECHO dhe disa partnerë të tjerë në Madagaskar i organizojnë komunitetet për të ndërtuar strehimoret nga stuhitë që shërbejnë njëkohësisht si zyra administrative për përgatitjen e komiteteve gjatë katastrofave.

Praktikë e mirë:

Në Malavi u realizua një projekt për të ngritur nivelin e çezmave për ujë për të siguruar mbrojtjen e ujit nga ndotja gjatë përmbytjeve. Vendi gjithashtu bëri ndërtesat shtesë për të shërbyer si strehimore të cilat njëkohësisht përdoren edhe si shkollë për fëmijët.

Në mënyrë që përgjigja të jetë e plotë për një periudhë më të gjatë kohore, nevojitet të mbështetet në njohuritë dhe burimet që janë në dispozicion në nivel lokal. Mjetet e

jashtme financiare mund të sigurohet për një periudhë të caktuar kohe, por komunitetet nuk duhet të mbështeten mbi to dhe duhet në vazhdimësi të kërkojnë burime alternative për financimin e këtyre aktiviteteve. Pasi të keni përcaktuar prioritetet, aktivitetet për ndërtimin e zgjedhjes së përshtatshme duhet të gjejnë vendin e tyre në planet, dhe subjektet operative duhet të përfshijnë ato në strategjitë e e duhura operative.

Parime udhëheqëse për aftësinë për t'iu përgjigjur numrit 3:

Inkorporim i aktiviteteve për përgjigje ndaj katastrofave, në planet vjetore për gatishmëri gjatë situatave emergjente dhe sigurim i mjeteve financiare

Mekanizëm i rëndësishëm për menaxherët për t'u ballafaquar me rreziqet gjatë katastrofave janë planet gjatë situatave emergjente. Ato duhet rregullisht të ripërtihen në nivel lokal. Gjithashtu duhet të ketë procedura operative si dhe kush duhet të veprojë në raste emergjente. Në planet e veprimit gjatë situatave emergjente duhet patur një kapitull i veçantë për paralajmërim të hershëm. Në këtë kapitull duhet të shprehet qartë se kush është përgjegjës, për çka dhe si duhet përgjigjur në rast të paralajmërimit të parë, të dytë dhe të tretë gjatë rrezikut të pashmangshëm.

Proekcionet afatgjata për një rajon / vend, në përputhje me parashikimet për ndikimin e ndryshimeve klimatike, duhet të aplikohen për periudhën që pason. Planifikimi për menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë nga katastrofat nuk është i bazuar vetëm në përvojën paraprake, por në të "priturit e të paparashikuarës."

Parime udhëheqëse për aftësinë për t'ju përgjigjur numrit 4:

Përsosje përmes stërvitjes: testim i aktiviteteve për gatishmëri

Stërvitjet dhe simulimi duhet të bëhen që të testohet gatishmëria gjatë katastrofave dhe të përgatiten plane adekuate për raste urgjente si dhe të përgatitet komunitetet për veprim. Rezultatet e këtyre simulimeve apo aktiviteteve gjatë ndonjë emergjencë të caktuar, duhet me kujdes dhe rregullisht të analizohen me qëllim të përmirësimit të sistemit të përgjithshëm për paralajmërim të hershëm. Është e rëndësishme të mbahet mend se edhe pse ekziston frika gjatë situatës aktuale (sidomos gjatë kohës së jashtëzakonshme kur ka një periudhë të shkurtër për paralajmërim), me kohë njerëzit fillojnë të përballen me frikën e tyre dhe i përmirësojnë refleksat e tyre dhe mundësinë e shpëtimit e jetës.

Disa aktivitete nuk janë aspak kreative, por luajnë një rol të rëndësishëm dhe kyç në kuadër të pakos për paralajmërimin e hershëm. Evakuimi është një nga ato aktivitete. Është thënë se në qoftë se rreziku nuk mund të kontrollohet, njerëzit duhet përshtatur atij (duhet forcuar objekti i shtëpisë ose të ngritet

objekti mbi nivelin ekzistues) me çka forcohet qëndrueshmëria ndaj rreziqeve. Nëse nuk mund ti përshtateni rrezikut, opcioni i fundit është ikja nga ai.

Ka raste kur e vetmja përgjigje për paralajmërim nga rreziku është evakuimi i shpejtë apo strehimi në një vend të sigurt. Krijimi i rrugëve të evakuimit emergjent dhe sinjalet, krijimi dhe mirëmbajtja e strehimoreve si dhe bindja e njerëzve për t'u larguar nga zonat e rrezikshme janë aktivitete të rëndësishme gjatë kërcënimit nga rreziku. Ka një numër të madh dokumentesh dhe doracakësh të dedikuar për veprim dhe organizimin e evakuimit, prandaj dhe këtë çështje nuk do ta trajtojmë më në këtë doracak.

Praktikë e mirë:

Në Argjentinë u mbajt stërvitje e suksesshme në vitin 2010 si pjesë e përpjekjeve për të rritur kapacitetin për t'iu përgjigjur komuniteteve më të rrezikuara në rajonin e Embarcación, pas një seri përpjekjesh për të rritur ndërgjegjësimin për rreziqet nga fatkeqësitë. Më shumë subjekte kanë marrë pjesë në stërvitjen e organizuar për shpëtimin dhe evakuimin e 485 njerëzve, pas lëshimit të urdhrat të evakuohen, i dhënë nga Qendra lokale për menaxhim të krizës. Një tjetër element i rëndësishëm ishte se paralajmërimi i hershëm është dhënë nga një anëtar i komunitetit përgjegjës për "monitorimin" e përmbytjes së fushave. Ky projekt u realizua në bashkëpunim midis Kryqit të Kuq dhe DIPECHO Argjentina.

Praktikë e mirë:

Në Shangaj, shoqatat vendase aktivisht marrin pjesë në aksione për gatishmëri në raste katastrofash, si dhe gjatë stërvitjeve për ndërmarrje të masave për zbutje të pasojave nga katastrofat. Ushtrime për gatishmëri gjatë katastrofave u organizuan në vitin 2005, gjatë sezonit të tajfunëve. Më 23 mars të vitit 2005 ushtrimet kishin për qëllim të përvetësohet procedura për mbrojtje nga tajfunet. Sektori administrativ përgatiti plane për zbutjen e pasojave nga rreziqe të ndryshme. pasi u dha paralajmërimi, menaxherët e informuan popullatën përmes ekraneve elektronike dhe sirenave lokale. Pas dhënies së sinjalit u fillua me përgatitjen për mbrojtje dhe evakuim nga rreziku.

Praktikë e mirë:

Kryqi i Kuq i Indisë, organizon ushtrime për gatishmëri gjatë katastrofave në Orisa, në strehimore lokale për mbrojtje nga ciklonet, me qëllim të stërvitet popullata lokale se si të veprojnë në raste stuhish.

PARIME UDHËHEQËSE TË SHOQATËS NDËRKOMBËTARE TË KRYQIT TË KUQ DHE GJYSMËHËNËS SË KUQE

HUMANIZËM

Shoqata ndërkombëtare e Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe lindi si rezultat i dëshirës për t'ju ndihmuar të plagosurve në vendet e luftës si dhe për të parandaluar dhe lehtësuar vuajtjet e njeriut, kur kjo është e mundur. Qëllimi i lëvizjes është të mbrohet jeta dhe shëndeti i njeriut si dhe respekti për të. Promovon tolerancë të ndërsjellë, bashkëpunim, mirëqenie dhe paqe për të gjithë.

OBJEKTIVITET

Nuk bën diskriminim mbi baza nacionale, racore, fetare dhe klasore ose politike. Përpiqet që t'i lehtësojë vuajtjet e individëve i udhëhequr nga nevojat e tyre, duke u dhënë prioritet rasteve emergjente.

NEUTRALITET

Me qëllim që të gëzojë besim të gjithë, Lëvizja nuk guxon të marrë anë gjatë konflikteve ose të merr pjesë në situata kontraverze që kanë të bëjnë me natyrën politike, racore, fetare ose ideologjike.

PAVARËSI

Shoqata është e pavarur. Organizatat nacionale edhe pse veprojnë si plotësim i shërbimeve humanitare të qeverive dhe janë objekt i rregullimit në kuadër të legjislativës nacionale, e kanë të domosdoshme ta ruajnë autonominë dhe të mund të veprojnë në çdo kohë, në përputhshmëri me parimet e Shoqatës.

SHËRBIM VULLNETAR

Kjo është lëvizje për dhënien e ndihmës vullnetare dhe nuk është e inspiruar nga motivet për kompensim material.

UNITET

Në kuadër të një shteti, mund të ketë vetëm një organizatë nacionale e Kryqit të kuq ose të Gjysmëhënës së kuqe. Duhet të jetë e hapur për të gjithë dhe ta bëjë punën humanitare në territorin e gjithë vendit.

UNIVERSALITET

Shoqata ndërkombëtare e Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, ku të gjithë organizatat që e përbëjnë kanë status të barabartë si dhe obligime dhe përgjegjësi për ndihmë të ndërsjellë, vepron në mbarë botën.